



UDHËRRËFYES I DEMOKRACISË SOCIALE 1

Tobias Gombert (e të tjerë)
Bazat e Demokracisë Sociale

AKADEMIA
PËR
DEMOKRACI SOCIALE

**FRIEDRICH
EBERT**

STIFTUNG

UDHËRRËFYES I DEMOKRACISË SOCIALE 1

Tobias Gombert (e të tjerë)

Bazat e Demokracisë Sociale



AKADEMIA
PËR DEMOKRACI
SOCIALE

FRIEDRICH
EBERT 
STIFTUNG





Botuar nga Fondacioni Friedrich Ebert
Akademia për Demokraci Sociale
Bonn, dhjetor 2009/Tiranë, janar 2013

Redaksia: Julia Bläsius, Jochen Dahm, Tobias Gombert, Christian Krell,
Martin Timpe

Përgjegjës: Dr. Christian Krell
Drejtore projekti: Julia Bläsius (Jochen Dahm)
Shtypur në shtypshkronjën: KUMI

Përktheu nga gjermanishtja: Astrit Ibro
Redaktoi: Dr. Sonila Sadikaj

Për përmbajtjen e këtij botimi përgjegjësinë e mbajnë autoret dhe autorët
e kapitujve të veçantë. Mendimet e shprehura jo domosdoshmërisht
përputhen në të gjitha pjesët me pikëpamjet e Fondacionit Friedrich Ebert.

UDHËRRËFYES I DEMOKRACISË SOCIALE 1

Tobias Gombert (e të tjerë)

Bazat e Demokracisë Sociale

PËRMBAJTJA

<i>Parathënie</i>	6
1. Çfarë është <i>demokracia sociale</i>?	8
2. <i>Vlerat bazë</i>	11
2.1. <i>Liria</i>	13
2.2. <i>Barazia/Drejtësia</i>	21
2.3. <i>Solidariteti</i>	39
2.4. <i>Çfarë thonë të tjerët?</i>	42
2.5. <i>Vlerat bazë në praktikë</i>	45
3. <i>Modele shoqërore për krahasim</i>	61
3.1. <i>Kapitalizmi i tregut dhe demokracia</i>	64
3.2. <i>Pozicionet liberale</i>	69
3.3. <i>Pozicionet konservatore</i>	72
3.4. <i>Demokracia sociale dhe socializmi demokratik</i>	74
4. <i>Teoria e demokracisë sociale e Thomas Meyer-it</i>	88
4.1. <i>Pikënisja</i>	91
4.2. <i>Libertarianizmi vs. demokracia sociale</i>	95

4.3. Ekskurs: Trio e vlerave bazë, e të drejtave themelore dhe instrumenteve	99
4.4. Të drejtat pozitive dhe negative të lirisë	104
4.5. Detyrimet e shtetit për të vepruar	107
5. Modele vendesh	109
5.1. SHBA	110
5.2. Britania e Madhe	117
5.3. Gjermania	126
5.4. Japonia	133
5.5. Suedia	140
6. Një fillim në fund	149
Bibliografia	152
Rekomandime për literaturë	154
20 fjalët kyçe të rëndësishme	159
Opinione mbi këtë seri	160
Mbi autoret dhe autorët	162

PARATHËNIE

Politika kërkon orientim të qartë. Vetëm kush mund të shprehë qartë objektivat e veprimit të tij, ai do të arrijë qëllimet e tij dhe do të entuziazmojë të tjerët. Prandaj në këtë udhërrëfyes dëshirojmë të trajtojmë çështjen, se çfarë do të thotë demokraci sociale në shekullin e 21-të. Cilat vlera janë në themel të saj? Cilat objektiva ndjek ajo? Si mund të realizohet në praktikë?

Këtu është e qartë se demokracia sociale nuk është aspak një konstruksion i ngurtë dhe i çimentuar për të gjitha kohërat, përkundrazi, për të duhet diskutuar e debatuar vazhdimisht dhe duhet luftuar në mënyrë demokratike. Prandaj edhe ky libër nuk mund të japë asnjë përgjigje të mbyllur, përfundimtare, por është një ftesë për ta lexuar dhe për të menduar sërish.

Fillimisht ne u drejtohemi pjesëmarrëseve dhe pjesëmarrësve në kurset e kualifikimit të Akademisë për Demokraci Sociale. Ky libër shërben këtu si bazë e rëndësishme leximi. Përveç kësaj, ky libër leximi mund të lexohet dhe të përdoret edhe nga të gjithë ata që dëshirojnë të marrin pjesë aktivisht në realizimin e demokracisë sociale, apo që janë të interesuar për të.

Në faqet që vijojnë, ju mund të zbuloni rrugë-hyrje të ndryshme drejt demokracisë sociale. Liria, drejtësia dhe solidariteti – vlerat bazë të demokracisë sociale - përbëjnë pikënisjen drejt saj. Më tej shtjellohet se ku ndryshon demokracia sociale nga rrymat e tjera politike. Teoria e demokracisë sociale e Thomas Meyer-it përbën një bazë të rëndësishme për të diskutuar praktikën e demokracisë sociale në pesë vende.

Udhërrëfyesi „Bazat e Demokracisë Sociale“ është pjesa e parë e një serie. Edhe për modulet e tjera, për seminarët e Akademisë për Demokraci Sociale, do të dalin libra të tjerë leximi.

Dëshirojmë të falënderojmë përzemërsisht këtu Tobias Gombert dhe Martin Timpe. Tobias Gombert ka hartuar pjesën më të madhe të këtij libri, në disa kapituj i mbështetur edhe nga Martin Timpe. Të dy bashkë kanë bërë punën redaktuese të këtij vëllimi me një kompetencë të jashtëzakonshme dhe profesionalizëm të madh. Vetëm falë angazhimit dhe punës së tyre ky vëllim mundi të dilte në një kohë kaq të shkurtër. I falënderojmë ata ashtu si edhe të gjithë autorët dhe autorët pjesëmarrës për bashkëpunimin e shkëlqyer.

Simboli i Akademisë për Demokraci Sociale është një busull. Me ato çka ofron Akademia, fondacioni Friedrich Ebert dëshiron të ofrojë një kuadër për të qartësuar pikëpamjet dhe orientimet. Ne do të gëzoheshim, në qoftë se do të shfrytëzoni ofertën tonë për të përcaktuar rrugën tuaj politike. Demokracia sociale jeton nga fakti që qytetarët dhe qytetarët konfrontohen vazhdimisht me të dhe angazhohen për të.



Christian Krell
Drejtör

i Akademisë për Demokraci Sociale



Julia Bläsius
Drejtore projekti

Udhërrëfyes për Demokracinë Sociale

Bonn, mars 2008

1. ÇFARË ËSHTË DEMOKRACIA SOCIALE?

*Çfarë është
demokracia
sociale?*

Katër përgjigje

„Demokracia sociale - a nuk është ky një nocion që shpjegohet automatikisht? Një nocion, i cili përmban premtimin se pjesë e demokracisë është gjithmonë edhe ajo që në një shoqëri demokracia duhet shfrytëzuar nga të gjithë dhe duhet të jetë e ekuilibruar nga ana sociale? A nuk është kjo e vetëkuptueshme?“, thotë njëra palë.

„Demokracia sociale – këtë e kemi zbatuar tashmë në Gjermani me anë të ekonomisë sociale të tregut, në modelin Gjermania, apo jo?“, pyesin të tjerët.

„Demokracia sociale – e po kjo është pjesë e Partisë Socialdemokrate Gjermane, SPD, dhe për pasojë ajo ka të bëjë vetëm me socialdemokratet¹ dhe socialdemokratët, ajo është teoria e tyre“, mendojnë një grup i tretë.

„Demokraci sociale, pse jo socializëm demokratik? Ky është një nocion i përdorur qysh herët“, mendojnë përsëri të tjerët.

*Kush ka të
drejtë?*

Në këtë pikë, gjatë diskutimit në Gjermani, mund të krijohet lehtë një ngatërresë gjuhësore. Po kush ka të drejtë? Edhe një herë ndërtohet Kulla e Babelit – kjo është e mundimshme dhe ndihmon vetëm në mënyrë të kufizuar për të vazhduar më tej.

Pra, fillimisht duhet të bashkohemi e të biem dakord për përdorimin e një gjuhe të përbashkët, me anë të së cilës mund të kuptojmë dhe të shpjegojmë pikëpamjet e ndryshme – kush grindet për drejtimin, fillimisht duhet të gjejë pikënisjen e përbashkët.

Lidhur me katër pyetjet se çfarë quhet demokraci sociale, mund të thuhet: të gjitha, pra të katra pikëpamjet, kanë të bëjnë me diçka të rëndësishme për diskutimin mbi demokracinë sociale. Njëra palë flet për bazat dhe premisat e saj, flet për atë se çfarë pritet nga demokracia sociale apo se çfarë mund të pritet me të drejtë.

Të tjerët merren me pyetjen, se sa është zbatuar tashmë prej saj, kjo do të thotë se ata merren me kontrollin empirik të shoqërisë ekzistuese.

¹ Teksti përmban gjerësisht forma mashkullore dhe femërore. Aty ku, për arsye gjuhësore, hiqet dorë nga përdorimi i dy gjinive, prapëseprapë bëhet fjalë për të dy gjinitë.

Ndërsa të tretët pyesin se cilët mund të jenë bartësit e perceptimit shoqëror të një demokracie sociale. Edhe kjo pyetje është më tepër se e drejtë.

Pala e katërt pyet, se çfarë përparësie ka që të devijosh nga një koncept tjetër, i cili tashmë ka zënë vend. Pra, pyetja ka të bëjë me atë se çfarë përbën në thelb demokracia sociale dhe çfarë e dallon atë nga konceptet e tjera.

Pra, kush dëshiron të flasë vazhdimisht për demokracinë sociale, fillimisht duhet të bëjë të kuptueshme se përse e ka fjalën dhe kujt i adresohet me këtë. Demokracia sociale nuk është aspak një nocion i qartë, ai është i ngatërruar dhe njerëzit lidhin me të përfytyrimet e ndryshme që kanë për vlerat. Nocioni është i ngarkuar nga ana shoqërore, pasi ai ndikon në rrafshin shoqëror, duke u marrë në konsideratë, apo duke u hedhur poshtë nga grupe të ndryshme interesi.

Katër pyetjet qartësojnë se nocioni duhet shpjeguar qartë përpara se të përdoret, dhe se duhet ditur, se cilat objektiva shoqërore lidhen me të.

Koncepti i “demokracisë sociale” gjatë diskutimit teorik konceptohet dhe formulohet në mënyra shumë të ndryshme – nuk ka një përkufizim unik dhe detyrues.

Por cila është rrjedhoja e përcaktimeve të ndryshme? Kur bëhet fjalë për një diskutim shkencor, duhen krahasuar me njëra-tjetrën bazat konceptuale dhe shpjegimet respektive, duhen kontrolluar ato, për të parë se çfarë argumentimesh japin për përcaktimin e koncepteve të tyre dhe të krahasohen pastaj rezultatet empirike. Lipset të analizohet nëse përcaktimet janë apo nuk janë në kontradiktë, apo nëse ka të dhëna empirike kontradiktore dhe nëse burimet janë interpretuar drejtë apo jo.

Parë nga aspekti shkencor, këto janë pyetje të rëndësishme. Njerëzit që në jetën profesionale nuk punojnë në sektorë shkencorë, por që angazhohen (në kohën e lirë) në lëmin politiko-shoqëror, zakonisht nuk kanë kohë që të merren kaq intensivisht me qasje teorike. Pra, si mund të operojmë, në mënyrë që të mos humbasim plotësisht nga sytë përkufizimin dhe shpjegimin shkencor?

*Një përkufizim
është i
domosdoshëm*

*Përkufizimet
shkencore për
“demokracinë
sociale”*

*Si të
procedojmë në
praktikë*

Libri i paraqitur këtu nuk mund të ofrojë zgjidhje të problemit, por ai shërben për të hyrë në diskutim. Në mënyrë të ndërgjegjshme ai skicon dhe paraqet mënyra të ndryshme veprimi politik dhe shkencor. Sepse njeriu zgjedh vetë se nga do të orientohet - libri nuk mund ta zëvendësojë këtë aftësi, por ai mund ta nxitë atë.

Prandaj, më poshtë do të merremi me qasje të ndryshme. Secili mund të vendosë vetë se cilën do të pranojë apo do ta marrë personalisht si një çelës për të hapur dyert e tij të dijes. Nga çështjet e trajtuara në fillim rezultojnë qasjet e mëposhtme: qasja normative, e cila pyet për parimet bazë dhe vlerat themelore të demokracisë sociale, qasja teorike, e cila merret me teorinë e demokracisë sociale, dhe ajo empirike, e cila analizon me saktësi zbatimin e demokracisë sociale në vende të ndryshme.

Në kapitujt e ndryshëm do të trajtojmë më nga afër këto tri rrafshë.

Rrafshi normativ do të pasqyrohet para së gjithash në dy kapitujt që vijojnë (kapitulli 2 dhe 3), kur bëhet fjalë për të ndriçuar nga afër vlerat bazë të lirisë, barazisë dhe solidaritetit dhe ku shtrohet pyetja se si mund t'i përfytyrojmë modelet e ndryshme shoqërore (liberalizmin, konservatorizmin, socializmin/demokracinë sociale) në zbatimin e tyre.

Rrafshi teorik do të paraqitet në kapitullin etkatërt, mbështetur në teorinë e demokracisë sociale të Thomas Meyer-it, duke dhënë një tablo të tij. Ne kemi përzgjedhur teorinë e Meyer-it, pasi me të mund të pretendojmë që ajo është e përmbyllur në argumentim. Përveç kësaj, ajo përfshin rrafshë të ndryshme brenda vetes.

Edhe kapitulli i 5-të, i cili mbulon rrafshin empirik duke u mbështetur në shembujt e vendeve të ndryshme, orientohet sipas Thomas Meyer-it. Si në librin e tij "Praktika e Demokracisë Sociale" edhe këtu, me ndihmën e shembujve nga vende të ndryshme, tregohet se demokracia sociale mund të zbatohet me shumë instrumente të ndryshme, por edhe me shkallë të ndryshme suksesi.

2. VLERAT BAZË

Në këtë kapitull

- do të sqarohen liria, barazia/drejtësia dhe solidariteti si vlera bazë të demokracisë sociale;
- do të trajtohen vlerat bazë parë nga perspektiva historike dhe filozofike dhe sjellë në politikën e sotme;
- do të diskutohet të kuptuarit e vlerave bazë nga partitë e përfaqësuara në Bundestag (parlamentin gjerman);
- do të skicohet rëndësia praktike e vlerave bazë në fushat e arsimit, shëndetësisë, punës dhe arsimit të lartë.

“Liri! Barazi! Vëllazëri!” Kjo ishte thirrja e betejave në Revolucionin Francez. Dhe deri më sot partitë demokratike u përmbahen në masë të gjerë këtyre vlerave themelore. Formulimi i vlerave bazë nis me epokën borgjeze, ndërsa marshimi i tyre fitimtar nëpër botë ka filluar nga mesi i shekullit të 20-të – dhe si kërkesë ndaj shteteve dhe shoqërive ato janë kthyer në “common sense”.

Kjo pasqyrohet edhe në bazat juridike të Kombeve të Bashkuara: Me dy konventat e të drejtave të njeriut të Kombeve të Bashkuara të vitit 1966 të drejtat themelore qytetare, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore kanë arritur vlefshmërinë më të madhe të mundshme, pasi ato janë ratifikuar nga shumica e vendeve të botës. Ato përbëjnë pothuajse një bazë globale pretendimesh. Të drejtat themelore duhet të garantojnë që vlerat bazë formalisht të kthehen në një kërkesë juridike.

Njëkohësisht mund të konstatohet se të drejtat themelore, të përcaktuara dhe të vendosura bashkërisht, në shumë vende të botës nuk zbatohen dhe ka madje edhe shtete nënshkruese, që pjesërisht, madje fare dukshëm, veprojnë kundër të drejtave të njeriut.

Nëse të drejtat bazë funksionojnë realisht dhe vlerat bazë zbatohen vërtetë në shoqëri, për këtë mund të dyshohet në shumë raste. Kjo nuk është aspak një çështje teorike, por një çështje e veprimit shoqëror dhe e raportit të forcave të aktorëve shoqërorë në vende dhe rajone të veçanta.

“Liri!

Barazi!

Vëllazëri!”

*Konventat e
Kombeve të
Bashkuara
për të drejtat
e njeriut si
bazament*

*Vlera bazë
dhe të drejta
bazë*

Por vlerat bazë dhe transformimi i tyre në formën e të drejtave themelore përbëjnë jo vetëm një thumb kritik por edhe një vlerë orientuese për përcaktimin e kursit politik. Për pasojë ato gjenden që në fillim të përcaktimit të drejtimit politik.

Vlerat bazë dhe orientimi i përgjithshëm i politikës gjatë vitit 2007 janë diskutuar veçanërisht fort. Dy partitë e mëdha popullore, SPD dhe CDU (Unioni Kristian-Demokrat) kanë përpunuar dhe aprovuar programe të reja partiake, të cilave, ndër të tjera, u është dashur të përshkruajnë se si mund të përkufizohen dhe të realizohen vlerat politike bazë në kohën e sotme.

Edhe demokracia sociale në rrafshin normativ orientohet nga vlerat dhe të drejtat bazë. Ato, në pretendimin e tyre normativ dhe me pyetjen nëse vërtet munden të funksionojnë, formojnë elementin kyç për një busull politike.

Vlerat bazë në historinë e tyre që prej iluminizmit në shekullin e 18-të kanë ndryshuar në mënyrë të përsëritur në përkufizimin e tyre, por edhe në raportin e tyre me njëra tjetrën.

Sot mund të nisemi kryesisht nga tri vlera bazë. Liria, barazia/drejtësia dhe solidariteti.

2.1. Liria

Liria sigurisht është vlera bazë, të cilën e deklamojnë dhe mbrojnë shumë të gjithë aktorët politikë. Ata e lidhin atë me mendimin iluminist dhe me fillimin e epokës borgjeze. Filozofë si John Locke, Jean-Jacques Rousseau, Immanuel Kant, Karl Marx si dhe përfaqësueset dhe përfaqësuesit e “Teorisë Kritike” i kanë menduar dhe përshkruar në etapa të ndryshme historike mundësitë e realizimit të lirisë.

Diskutimi mbi lirinë – e thënë në vija të trasha – lidhet me tre çështje fundamentale:

- Si duhet përkufizuar liria?
- Si mund të realizohet dhe të garantohet liria në shoqëri?
- Çfarë kufijsh ka liria në shoqëri?

Lidhur me konceptin “liri” ka rezistuar dhe mbijetuar, para së gjithash, përcaktimi që i ka bërë atij filozofi anglez John Locke:

“Liria natyrore e njeriut qëndron në faktin që të jetë i lirë nga çdo fuqi madhore mbi tokë, të mos i jetë nënshtruar vullnetit apo pushtetit legjislativ të një njeriu, por që të ngrejë lart vetëm ligjin e natyrës si ligjin themeltar të së drejtës.

Liria e njeriut në shoqëri qëndron në faktin që të mos qëndrojë nën asnjë pushtet tjetër legjislativ, veç atij që është zbatuar me mirëkuptim për të mirën e përgjithshme, të mos qëndrojë nën sundimin e një vullneti apo të kufizimit të një ligji, por vetëm të atij që është vendosur nga legjislativi mbi bazën e besimit në të.”

(Locke 1977: f.213)

Në traditën e Locke-ut dallojmë këtu tri dimensione të ndryshme të lirisë: liria mbi personin e vet, liria për mendimin dhe ndjesinë e vet dhe liria për të disponuar gjëra që i takojnë personit me ligj. Këto tri dimensione të lirisë janë përfshirë në shumë kushtetuta dhe në përcaktimet e tyre për të drejtat themelore të njeriut. Shumë teori i janë referuar përkufizimit të John Locke-us dhe e kanë interpretuar atë.

*Rrënjët e
“lirisë”*

*Si duhet
përkufizuar
liria?*

Locke niset nga pikëpamja që këto liri për nga vetë natyra i takojnë çdo njeriu – ato nuk janë zhvilluar në shoqëri, por janë “të dhëna”.

Natyrisht këto „të drejta natyrore” mund “të ruhen” të transformuara në shoqëri. Ato transformohen pastaj në pretendime të çdo njeriu ndaj shoqërisë.

John Locke (1632-1704) ishte njëri nga përfaqësuesit e parë dhe më të rëndësishëm të liberalizmit.

Locke zhvilloi në mënyrë thelbësore të ashtuquajturin empirizëm, i cili analizonte se si mund të mësojnë njerëzit nëpërmjet përvojës. Krahësimi i përvojave, sipas tij, është pikënisja për mendimin teorik.

1690 John Locke botoi *Two Treatises of Government*, ku tronditi bazat teorike të monarkisë angleze dhe zhvilloi një koncept të shoqërisë që mbështetet mbi liritë.

Argumentimi i Locke-ut në thelb dhe me transformimet e ndryshme filozofike ka mbetur deri më sot ndikues dhe atij vazhdojnë t’i referohen vazhdimisht, kur duan të kuptojnë lirinë si vlerë bazë. Locke vlerësohet si njëri nga mendimtarët me peshë të liberalizmit.

Ky përkufizim, i cituar në mënyrë të përsëritur, natyrisht që nuk lejon të fshihet fakti se këtu kemi të bëjmë me një tekst historik, i cili nuk mund e nuk duhet kuptuar pa kushtet e lindjes së tij dhe se nuk mund të merret e të vendoset thjesht në ditët e sotme. Kjo duket edhe te çështja se si mund të garantohet dhe të realizohet liria në shoqëri.

Për diskutimin historik është vendimtar fakti se Locke (dhe pas tij edhe shumë filozofë të tjerë të iluminizmit) nuk e aprovon argumentimin, se një pabarazi natyrore mund të argumentojë mungesën e lirisë së një pjese të madhe të njerëzve. Barazia natyrore dhe bashkë me të edhe liria e barabartë në shoqërinë absolutiste ishin pretendime revolucionare, pra në një shoqëri të tillë, ku mbretërit pretendonin se këto u përkisnin atyre, duke legjitimuar sikur sundimi i tyre kishte ardhur nga Zoti.

Natyrisht Locke nuk mbetet tek liria e barabartë e dhënë nga natyra, por nëpërmjet një kontrate shoqërore ia kalon lirinë natyrore shoqërisë.

Në shoqëri – ky është thelbi i argumentimit të tij – liria e disponimit të personit kthehet në pronësi ndaj vetë personit, liria e mendimit dhe e ndjeshmërisë duhet garantuar nga shoqëria nëpërmjet pjesëmarrjes në vendimmarrje dhe në pushtetin politik, dhe liria për të poseduar sende të siguruara ka nevojë për një treg të lirë, të aksesueshëm për çdo njeri. *Pra liritë natyrore nuk mund të mbeten thjesht të ruajtura në shoqëri, përkundrazi ato duhen siguruar nëpërmjet rregullave shoqërore.*




Fig. 1: Nocioni i lirisë i John Locke-ut

Pikërisht lidhur me çështjen se si mund të realizohet liria, ka pasur kritika ndaj teorisë së John Locke-ut që në shekullin e 18-të. Por kritikuesi më i rëndësishëm ishte Jean-Jacques Rousseau (Zhan-Zhak Ruso), i cili e kundërshton apo e plotëson Locke-un në katër pika qendrore:

1. Një kontratë e mirë shoqërore mund të arrihet vetëm atëherë, kur të gjithë njerëzit në themelimin e shoqërisë i dorëzojnë të gjitha të drejtat e tyre natyrore, për t'i rimarrë pastaj ato si të drejta qytetare.
2. Kontrata shoqërore e shoqërisë kontemporane borgjezo-monarkiste nuk është aspak një kontratë e mirë shoqërore.
3. "Liria" mund të realizohet në vijueshmëri vetëm atëherë, kur të gjitha vendimet politike për ligjet merren nga të gjithë ata që preken prej tyre. Vetëm pas kësaj çdo njeri i nënshtrohet vullnetit të tij dhe kështu do të jetë i lirë.
4. "Liria" për Rousseau-në është e lidhur edhe me një mendim zhvillimi: ai sheh te çdo njeri "aftësinë për të zhvilluar aftësi të ndryshme" ("perfectibilite") (Benner/Brügge 1996: 24). "Aftësitë" nuk paracaktohen, por zhvillohen me mundësi, mësim dhe jetesë në shoqëri

Jean-Jacques Rousseau (1712-1778) me veprat e tij teorike ishte një nga ata që shtruan rrugën e Revolucionit Francez.

Rousseau hartoi një trajtesë bazë për zhvillimin e pabarazisë në shoqëri, të cilën ai e punoi si në mënyrë filozofike, ashtu edhe historiko-empirike.

Vepra të tjera kryesore merren me teorinë demokratike të shtetit nga njëra anë dhe edukimin nga ana tjetër.

Pikërisht pika e parë e kritikës është krejt e papritur. Pse duhet që njerëzit të dorëzojnë të gjitha të drejtat e tyre natyrore dhe t'i rimarrin pastaj ato nga shoqëria? A nuk i hap kjo tiranisë derë e dritare? Radikalizmi me të cilin Rousseau-ipërfaqëson këtë pikë, edhe mund të na çudisë. Ai zgjedh, ndër të tjera, formulimin radikal, pasi dëshiron të bëjë të qartë, se në shoqëri nuk duhet të depërtojnë prebendat, apo pasuritë dhe pronat dhe nëpërmjet tyre padrejtësitë shoqërore, kur liria, në aspektin shoqëror, duhet të arrihet për të gjithë. Si ideal ai përfiton një shoqëri të njerëzve të lirë dhe të barabartë.

Rousseau pyet në radhë të parë për ndikimin real të lirisë në shoqëri. Për shoqërinë kontemporane ai analizon këtu, se liria e shpallur do të realizohet në mënyrë të tillë, që u shërben vetëm të pasurve si siguri. Ai e ashpërsmon më tej këtë tezë, duke paraqitur fjalimin e një të pasuri, i cili bën reklamë tek të varfrit për kontratën e gabuar shoqërore dhe lirinë e tij të njëanshme:

“Le të bashkohemi – u thotë ai atyre [të varfërve, shënim i autorit], për të mbrojtur të dobët nga shtypja, për të mbajtur nën fre ambiciozët dhe për të siguruar pronën e gjithsecilit, pra, atë që u takon: Na lini në të paragesim direktivat e drejtësisë dhe të paqes, të cilat pastaj duhet të jenë të detyrueshme për të gjithë ata që nuk lejojnë të vlerësohet imazhi i personit dhe në një farë mënyre rikthen trillet e lumturisë, ku të fuqishmit dhe të dobët u nënshtrohen në të njëjtën masë obligimeve të ndërsjella. Me një fjalë: lërinë forcat tona, në vend që t’i drejtojmë ato kundër vetes, të bashkohen në një pushtet superior.” (Rousseau 1997: 215-217).

Liria – thotë Rusoi – mund të shfrytëzohet si “parullë për të mbajtur të tjerët në gjendje qetësie”. Prandaj duhet mbajtur parasysht para së gjithash fakti, nëse liria e siguruar për të gjithë funksionon në të vërtetë për të gjithë njerëzit në shoqëri.

Pika e tretë e kritikës së Rousseau-it ka të bëjë me një aspekt tjetër esencial të lirisë, pra me raportin e saj me sundimin. Ndërkohë që Locke (dhe para tij edhe më fuqishëm Thomas Hobbes) niset nga fakti se legjislati vërtet legjitimohet nga populli, por nuk është e thënë të ushtrohet vetë, Rousseau nga ana e tij është i orientuar nga kahu radikal-demokratik. Ai argumenton se njeriu mund të jetë i lirë (pra i nënshtuar vetëm prej vullnetit të vet politik) vetëm atëherë, kur është i lidhur me ligje të tilla, ku ka mundur të ushtrojë ndikimin e tij.

Me pikën e tij të katërt të kritikës Rousseau plotëson nocionin e lirisë së Locke-ut në një pozicion qendror: Ai përfaqëson pikëpamjen, se liria njerëzore rezulton nga fakti se njeriu nuk është i pajisur thjesht me “aftësitë” e natyrës, por me aftësinë, për të zhvilluar aftësi (krahaso: Benner/Brüggen 1996: 24). Zhvillimi i njeriut dhe mundësia për shpalljen e personalitetit të tij – kjo është një sfidë qendrore për shoqërinë demokratike.

*Liri vetëm për
të pasurit?*

*Raporti i lirisë
dhe sundimit*

*“Aftësia,
për të zhvilluar
aftësitë”*

Çfarë kufijsh
ka liria në
shoqëri?

Pyetja se deri ku shkon vërtet liria (e personit të veçantë në shoqëri, por edhe ndaj shtetit), deri më sot është e diskutueshme. Qoftë “sulmi i madh i përgjimit” apo pyetja, nëse ministri i mbrojtjes në një rast serioz mund të japë urdhër për të goditur avionët e pasagjerëve – në shumë raste bashkë me pyetje të tilla po diskutohen kufijtë e lirisë në aspektin shoqëror.

Dy përgjigje

Në përkufizimin e kufijve të lirisë vazhdimisht përmenden dy përgjigje filozofike:

“Në fakt duket se populli në demokraci bën atë që do. Por liria politike nuk qëndron në faktin të bësh çfarë të duash. Në një shtet, d.m.th. në shoqërinë ku ka ligje, liria konsiston vetëm në atë, që njeriu mund të bëjë atë çfarë i lejohet, dhe nuk mund të jetë i detyruar të bëjë atë që nuk i lejohet ta bëjë. Aktualisht duhet t’i përmbahemi asaj se çfarë është pavarësi dhe çfarë liri. Liria është e drejta për të bërë gjithçka që e lejojnë ligjet. Në qoftë se një qytetar do të mund të bënte atë që e ndalojnë ligjet, atëherë ai nuk do të kish pasur më asnjë liri, pasi edhe të tjerët do ta kishin pikërisht këtë pushtet”. (Montesquieu 1992: f. 212).

„Pra imperativi kategorik është vetëm një e pikërisht ky: vepro vetëm sipas asaj maksime të cilën ti do të mund ta duash që të bëhet ligj i përgjithshëm.” (Kant 1995: 51)

Montesquieu

Charles de Secondat Montesquieu

(1689-1755) ishte një dijetar i së drejtës dhe filozof moralist, i cili sot është i njohur në radhë të parë prej trajtesës ‘Mbi frymën e ligjeve’ (1748).

Ndër të tjera ai ka luftuar për një monarki konstitucionale dhe ndarjen e pushteteve (legjislativi, ekzekutivi dhe gjyqësori).

Kufiri i lirisë te Montesquieu konsiston te obligimi për të respektuar ligjet, obligim që me të drejtë kërkon që dhe të gjithë të tjerët t’u përmbahen ligjeve.

Formulimi i Kantit shkon shumë më tej dhe vendoset në një nivel tjetër, pasi ai e koncepton kufizimin e lirisë në mënyrë abstrakte. Për çdo veprim duhet pyetur nëse mund të jetë i praktikueshëm edhe si ligj i përgjithshëm apo jo. Ky zgjerim nuk ka të bëjë vetëm me atë që t'u përmbahemi ligjeve, por edhe me shfrytëzimin e lirisë brenda kuadrit ligjor. Kjo mund të ilustruhet me një shembull të thjeshtë: nuk është e ndaluar të udhëtosh me një xhip i cili harxhon shumë karburant dhe për pasojë dëmton mjedisin, por i formuluar si ligj i përgjithshëm, ky do të kish qenë një problem i madh për politikën mjedisore.

Immanuel Kant (1724-1804) është deri më sot një nga filozofët gjermanë më me influencë të iluminizmit. Vepra e tij përfshin pothuajse të gjitha fushat filozofike të asaj kohe.

Vepra të rëndësishme ndër të tjera: *Kritika e arsyes së pastër* (1781), *Kritika e arsyes praktike* (1788), *Kritika e forcës së gjykimit* (1790), *Mbi paqen e përjetshme* (1795), *Metafizika e zakoneve* (1796/97).

Kufijtë e lirisë te Kanti janë të moralshëm, dhe për çdo njeri janë të lidhur me të mirën e përgjithshme. Kjo perspektivë e pranuar nga individ i lidhur me kufijtë e lirisë, natyrisht që nuk mjafton për ta bërë lirinë të qëndrueshme për të gjithë në shoqëri.

Këtu nuk kemi të bëjmë

vetëm me atë që të pengohen cenimi apo ndërhyrja në lirinë e personit, përkundrazi kërkohet zgjerimi i kufijve të lirisë edhe për ata, liria e të cilëve është e kufizuar. Kjo në shoqëri mund të realizohet vetëm si liri e barabartë për të gjithë. Programi Themelor i Hamburgut i Partisë Socialdemokrate Gjermane e ka formuluar shkurt dhe me pak fjalë: “Çdo njeri është i prirur dhe i aftë për lirinë. Nëse ai mund ta jetojë respektivisht këtë prirje, kjo vendoset në shoqëri.”

Teoritë më të reja - si ato të indianit Amartya Sen, mbajtës të çmimit Nobel, flasin edhe për “shanset e realizimit”, të cilat përtej barazitizmit fiskal parashohin një pjesëmarrje gjithëpërfshirëse në jetën shoqërore²

Kufijtë e lirisë janë të moralshëm dhe të lidhur me të mirën e përgjithshme

2. Edhe dy raportet e para të qeverisë federale mbi varfërinë dhe pasurinë për të nxjerrë përfundime të drejta nuk punojnë më vetëm me një indikator vetëm material për matjen e varfërisë, por përfshijnë edhe inkluzionin dhe ekskluzionin shoqëror.

Po ta shohim diskutimin mbi lirinë nën këtë këndvështrim, atëherë themi se na lejohet të formulojmë pikat e mëposhtme si kërkesa ndaj Demokracisë Sociale.

**Kërkesat ndaj
Demokracisë Sociale që
rezultojnë nga diskutimi
mbi lirinë:**

- Liria e personit dhe liria për të marrë pjesë aktivisht në shoqëri dhe në vendimmarrjen e saj duhen siguruar dhe garantuar në themel.
- Liria presupozon që çdo njeri të mund ta jetojë lirinë edhe faktikisht. Për këtë duhen masa dhe institucione shoqërore, që e mundësojnë këtë. Vetëm ekzistenca formale e lirisë si e drejtë themelore nuk mjafton.
- Liria presupozon që vendimmarrja politike duhet të bëhet në mënyrë demokratike.
- Liria presupozon që njerëzit duhet të veprojnë me përgjegjësi dhe arsye. Kjo është një kërkesë për edukimin dhe shkollimin në një shoqëri demokratike.

“Liria” në programin e Hamburgut të SPD-së:

“Liri do të thotë mundësi, të jetosh duke vetëvendosur. Çdo njeri është i prirur dhe i aftë për lirinë. Nëse ai mund ta jetojë këtë prirje, për këtë vendos shoqëria. Ai duhet të jetë i lirë nga varësitë poshtëruese, nga mjerimi dhe frika, dhe ai duhet të ketë shansin të shpalosë aftësitë e tij dhe të mund të ndikojë me përgjegjësi në shoqëri dhe politikë. Vetëm ai që e di se nga ana sociale është i siguruar mjaftueshëm, ai mund ta shfrytëzojë lirinë e tij.”

(Programi i Hamburgut 2007: 15)

2.2. Barazia/Drejtësia

Shumë vetë hezitojnë kur duan të renditin të dytën e vlerave bazë: A është „barazia” vlera bazë, apo më parë duhet renditur „drejtësia”?

Kjo pasiguri shpjegohet lehtësisht nisur nga një perspektivë filozofike:




Fig. 2: Shoqëri e barabartë dhe vlerat bazë

Këto tri vlera bazë kanë qenë në histori që nga Revolucioni Francez: “Liri, barazi dhe solidaritet”. Nisur nga perspektiva filozofike mund të flasim për një shoqëri të barabartë kur realizohen këto tri vlera bazë.

Njëkohësisht gjatë diskutimit mbi vlerën bazë të “barazisë” shtrohet pyetja se si mund të jetë një shpërndarje e drejtë e pasurisë materiale dhe jo materiale. Dhe në këtë pikë, duke filluar nga vitet 1980-të ka zënë një vend të dukshëm “drejtësia” si një vlerë qendrore bazë, duke u diferencuar nga të tjerat, apo edhe në përdorimin për të precizuar konceptin e “barazisë”. Ndërkohë që në gjuhën e përditshme sot flitet për liri, drejtësi dhe solidaritet, nocione të cilat tashmë kanë zënë vendin e tyre në përdorimin gjuhësor. E megjithatë ia vlen t’i hedhim një vështrim diskutimit filozofik.

Ndryshe nga nocioni i „lirisë”, të cilin mund ta përvetësojë çdo individ, grua apo burrë, në rastin e “barazisë” dhe “të drejtësisë” kemi të bëjmë me nocione relative: ato e vënë njeriun dhe lirinë e tij individuale në marrëdhënie me anëtarët e tjerë të shoqërisë.

Barazia apo drejtësia?

Dallimi midis terminologjisë filozofike dhe përdorimit të gjuhës politike sot

Nocioni që nga ana filozofike është i mbirenditur, është ai i „drejtësisë”. Më poshtë do të gjeni një citat të gjatë që orvatet të përcaktojë më nga afër nocionin e “drejtësisë”:

“Çfarë është drejtësia? A mund të pyesim kështu? Pyetjet që fillojnë me fjalën “çfarë” kërkojnë të dinë se çfarë është një send. Drejtësia nuk është send. Drejtësia është një kategori marrëdhëniesh. Ajo ka të bëjë me marrëdhëniet e njerëzve me njëri-tjetrin. Marrëdhëniet e një lloji të caktuar cilësohen si të drejta. Prandaj edhe pyetja më tej nuk duhet të bëhet “çfarë është drejtësia?”, por “përse bëhet fjalë te termi drejtësi?” [...]. Tema e drejtësisë është pozicioni i individit në komunitetin e tij, në shoqëri, në raport me të tjerët, pra me ata që ka të bëjë në jetën e përditshme. [...]. Njerëzit kanë nevojë të përcaktojnë pozicionin e tyre në raport me të tjerët, pra me ata që kanë kontakte, të mësojnë se si perceptohen, si vlerësohen. [...]. Kur ndjesia e vetëvlerësimit të individit është e njëjtë me atë që i bëjnë atij të tjerët, atëherë ai ndihet i trajtuar drejt. Shprehjen e tij një gjykim i tillë e gjen në shpërndarjen, kundërshtimin apo heqjen e të mirave materiale dhe ideore.” (Heinrichs 2002: f. 207).

Pra drejtësia është qartësisht një nocion i pasur me parakushte: individualisht mund të ndihesh i trajtuar në mënyrë jo të drejtë, por përsëri para teje ka një shpërndarje objektivisht “të drejtë”. Çfarë është e drejtë dhe çfarë jo, kjo mund të përcaktohet nga kompromisi shoqëror.

Drejtësia presupozon

- që bëhet një shpërndarje shoqërore e të mirave (ideore dhe/ose materiale)
- dhe që shpërndarja e të mirave orientohet nga kritere shpërndarjeje të legjitimuara dhe të pranura nga të gjithë.

Vetëm kur të jenë plotësuar këto dy premisa, atëherë mund të flitet për „drejtësi”.

Ndërsa barazia është një formë e veçantë e shpërndarjes së të mirave materiale dhe shpirtërore:

„Pikënisja dhe jo rezultati i një rendi [social] [...] është barazia. Gjatë shqyrtimit të shpërndarjes nevojitet një normë bazë e shpërndarjes, që duke u nisur prej saj, një shpërndarje e devijuar bëhet pastaj shprehje e drejtësisë. Kjo normë primare e shpërndarjes është barazia numerike, pra ndarja e asaj që është për t’u ndarë nëpërmjet numrit të personave të marrë parasysht. Barazia, ndryshe nga drejtësia, nuk ka nevojë për asnjë kriter. [...] Në qoftë se për rastin konkret nuk ka asnjë kriter të shpërndarjes së të mirave, në qoftë se nuk ka asnjë arsye për këtë që mund të lejojë që njëri të marrë më shumë se tjetri, pra në qoftë se nuk duam të jemi arbitrare, duhet t’u japim të gjithëve pjesë të barabarta.” (Heinrichs 2002: f. 211)

Kërkesa për barazi presupozon që nuk ka asnjë argument të mbartur shoqërisht, që mund të legjitimonte një trajtim të pabarabartë gjatë shpërndarjes së të mirave.

Nocionet “barazi” dhe “drejtësi” na lejojnë t’i formulojmë në mënyrë përkufizuese, për aq kohë sa teoritë e ndryshme shkencore nuk kundërshtojnë njëra-tjetrën. Natyrisht është interesante, ashtu sikurse argumentohet në teori, se një “shpërndarje jo e barabartë” mund të gjykohej si e drejtë. Por një njeri i interesuar politikisht duhet të pyesë, se si mund të vlerësohet në praktikën politike, në “punët e përditshme”, një propozim politik si “(jo) i drejtë”.

Më poshtë do të paraqiten katër mënyra të ndryshme qasjeje ndaj konceptit “drejtësi”, të cilat duke filluar nga vitet 1980 apo 1990 janë diskutuar teorikisht dhe politikisht. Nga përkufizimet e ndryshme dhe mënyrat e qasjes bëhet e qartë se argumentimi i drejtësisë nuk është i qartë, përkundrazi kemi të bëjmë me një motiv të diskutueshëm politik. Mënyrat e qasjes janë:

- Teoria liberale e drejtësisë e John Rawls
- Kritika socialiste ndaj teorive liberale të drejtësisë
- Përkufizimi i Nancy Frasers midis njohjes dhe rishpërndarjes
- Dimensionet politike të drejtësisë

Crux: Si mund të argumentohet “trajtimi i pabarabartë i drejtë”?

Katër qasjet ndaj “drejtësisë”

2.2.1. Teoria e drejtësisë³ e John Rawls

John Rawls

Në kontekstet filozofike diskutohet dukshëm 'Teoria e drejtësisë' e John Rawls-it. Qysh në vitin 1971 ai ka botuar një teori në vazhden e traditës liberale. Një ndikim të veçantë politik ajo ka shpalosur në vitet 1980-të dhe 1990-të si kundërperspektivë ndaj radikalizmit të tregut të erës së Reganit dhe Theçerit dhe „kthesës shpirtërore, morale“, sikurse kërkonte qeveria e Helmut Kohl-it (krahaso: për kontekstin historik: Nida-Rümelin 1997: f. 15). Pikërisht në kontekstin socialdemokrat teoria e John Rawls-it është diskutuar fort.

Në teorinë e tij Rawls analizon rregullimin e konflikteve të interesit në shoqëri, anëtarët e së cilës nëpërmjet bashkëpunimit duhet të përpiqen t'i shpërndajnë drejt të mirat relativisht të pakta. Kundërvëniet e interesave lipset të sanksionohen në një „rendi bazë të drejtë“ me institucionet respektive specifike (kushtetuta, kuadri ekonomiko-politik etj.). Rawls në teorinë e tij dëshiron t'i kthejë në koncepte këto pranime implicite të rendit të drejtë dhe parimet respektive.

Ai mendon se:

- mund të formulohen idetë themelore dhe parimet e përgjithshme për drejtësinë, që mund t'i aprovojë çdo njeri;
- në demokracitë e sotme është pjesë e tyre, që qytetarët dhe qytetarët ta shohin njëri-tjetrin në mënyrë të ndërsjellë si të lirë dhe të barabartë;
- mbi këtë bazë mund të gjenden parimet e kooperimit social.

John Rawls (1921-2002) vlerësohet sot si një nga filozofët moralizues më të shquar në traditën liberale. Ai ishte profesor për filozofinë politike në Universitetin Harvard.

Më 1971 botoi veprën e tij më me influencë, „Teoria e drejtësisë“.

Teoria e drejtësisë – pikërisht në vitet 1980-të dhe 1990-të – është diskutuar edhe në gjirin e socialdemokracisë.

Vendosja e një
„rendi bazë të
drejtë“

3. Këtu nuk mund dhe nuk do të paraqitet teoria e gjerë e John Rawls-it. Këtu bëhet fjalë për problemet praktike në përkufizimin e drejtësisë, të cilët shfaqen vazhdimisht edhe në veprimtaritë politike dhe që lipset të diskutohen në mënyrë ekzemplare.

Njësoj si John Locke edhe Rawls pranon një pozicion pikënisje. Natyrisht nuk i referohemi një pozicioni të prezantuar realisht, por hipotetik, ku njerëz të lirë dhe të barabartë, që ndjekin vetëm interesin e tyre, vijnë për t'u bashkuar për parimet e drejtësisë.

Të drejta në argumentimin e Rawls-it janë rendi themelor dhe mënyrat e procedimit, të cilat vendosen me konsensus nga anëtarët e një komuniteti (ose shoqërie) në kondita të ndershme (drejta).

Në eksperimentin e mendimit natyrisht bën pjesë edhe fakti që pozicioni shoqëror i personit nuk është akoma i sqaruar. Për pasojë – kështu thotë pretendimi i Rawls-it – duhet të gjithë të kenë interes në atë që i pozicionuari më keq të mund të jetë pozicionuar mundësisht mirë (Rregulli "Maximin").

Eksperimenti i mendimit: "Pozicioni i pikënisjes" nga individët e lirë, të barabartë dhe të orientuar drejt qëllimit

"Rregulli Maximin"

Ushtrim për diskutim dhe punë plotësuese

John Rawls na fton në argumentimin e tij për një eksperiment të menduari.

E pranoni ftesën?

Atëherë përfytyroni sikur do të merrni pjesë vetë në këtë mbledhje të personave të lirë, të barabartë, që argumentojnë të orientuar sipas qëllimit:

- Për cilat parime mund të jeni të një mendjeje?
- Cilat parime janë të diskutueshme?
- Me çfarë argumentimi mund të sqarohen pikat e diskutueshme?
- Cilat nga parimet janë realizuar në situatën e sotme shoqërore në Republikën Federale dhe cilat jo?

Nga teoria e përhapur e Rawls-it duhet të mbahen parasysh këtu dy parimet esenciale, me anën e të cilëve duhet të jetë e kontrollueshme, nëse diçka mund të quhet e drejtë.

Dy parimet e drejtësisë

Ndër të tjera, një meritë e John Rawls-it është ajo që ai ka zhvilluar diskutimin klasik liberal mbi rishpërndarjen e të mirave shoqërore, duke e kthyer atë në një teori, e cila përkufizon sërish drejtësinë e shpërndarjes. Në këtë mënyrë Rawls e ka lidhur traditën liberale, pretendimin mbi sigurimin dhe garantimin e të drejtave të lirisë, me idetë socialdemokrate të barazisë/drejtësisë.

Një përkufizim i ri i drejtësisë së shpërndarjes

John Rawls në teorinë e tij të drejtësisë formulon dy parime:

Parimi 1

“Çdo njeri duhet të ketë të njëjtën të drejtë mbi sistemin gjithëpërfshirës të lirive të barabarta themelore, e cila me sistemin e njëjtë, të jetë e pranueshme për të gjithë të tjerët.” (Rawls 1979: 81)⁴

Parimi 2

„Pabarazitë sociale dhe ekonomike mund të jenë krijuar si më poshtë: a) nën kufizimin e parimit të drejtë të kursimit ato duhet t’u sjellin personave më pak të favorizuar avantazhin më të madh të mundshëm dhe b) ato mund të jenë të lidhura me postet dhe pozitën, të cilat në bazë të barazisë së pastër të shanseve duhet të jenë të hapura për të gjithë.” (Rawls 1979: 336)

Liritë bazë

Parimi i parë lidhet me një arsenal të lirive bazë, të cilat duhet të jepen për çdo person, në mënyrë që ai të shfrytëzojë liritë e tij. Referimi mbi “sistemin e njëjtë” e bën të qartë se çdo mënyrë veprimi duhet të jetë përgjithësuese dhe të heqë dorë nga personi konkret. Konkretisht mund të flasim për një “barazi para ligjit” dhe për të drejta të garantuara të personalitetit. Parimi i parë njihet pothuajse nga të gjithë autorët dhe autorët.

Rawls (në traditën liberale) presupozon se parimi i parë duhet të ketë përparësi absolute para të dytës⁵.

Parimi i diferencës

Ndryshe nga parimi i parë, i padiskutueshëm në qarqe të gjera, me parimin e dytë, të ashtuquajturin parim i diferencës kemi vështirësi. Këtu propozohet nga Rawls-i një normë abstrakte, sipas së cilës trajtimi i pabarabartë të mund të gjykohet si i drejtë. Me një shpërndarje jo të barabartë, e megjithatë të drejtë, lipset të jenë lidhur dy parakushte:

1. që ajo të jetë edhe në favorin e atij që është më pak i favorizuar
2. që postet dhe pozicionet e larta të jenë të hapura për çdo njeri

4. Një formulim që nga ana kuptimore është i përafërt me atë që ka formuluar Kanti: “ I drejtë është ai veprim, i cili, ose sipas maksimës së të cilit mund të jetojnë bashkë liria e arbitraritetit të çdo njeri me lirinë e secilit sipas një ligji të përgjithshëm” (Kant 1963: 33)

5. Kjo provohet natyrisht si një këndvështrim krejt problematik si në përmbajtje, ashtu edhe nga ana logjike, sikurse e ka bërë të qartë Meyer-i (krahaso: Faqe 93).

Premisën e parë për një “shpërndarje të pabarabartë të drejtë” Rawls e vazhdon me pasojat e pritshme të shpërndarjes së pabarabartë: Në qoftë se prej këtej do të përfitojnë të gjithë, pra edhe më të dobët e një shoqërie, atëherë shpërndarja e pabarabartë (në ndikimin e saj pasues) do të klasifikohet si e drejtë. Behet fjalë për një veprim të zhvendosur në kohë.

Premisa e dytë i takon “drejtësisë së aksesit”: Vetëm kur çdo person, burrë apo grua, parimisht ka mundësi të hapura në rrugën drejt posteve dhe pozitës, vetëm atëherë mund të justifikohet një shpërndarje e pabarabartë. E thënë shkoqur fare, kjo do të thotë: “Të gjithë kishin një shans të ndershëm.”

“Parimi i diferencës” është i diskutueshëm – jo vetëm shkencërisht, por edhe politikisht. Por përpara se mund të pyesësh nëse është një përcaktim i goditur i drejtësisë apo jo, duhet provuar argumentimi mbi bazën e shembujve praktikë. Në tablonë që po shihni, do të gjeni argumentime politike, të cilët mund të provohen, nëse janë “të drejtë” në kuptimin e dy “primeve” të Rawls-it⁶. Mendoni më mirë paraprakisht çfarë quani ju të drejtë, nisur “nga ndjesia juaj e brendshme”.

*Premisat
për një
“shpërndarje
të pabarabartë
të drejtë”*

Diskutimi: Taksë progresive e të ardhurave – po apo jo?

Edhe në qoftë se një shumicë e gjerë shoqërore është kundër argumentimit të Paul Kirchhof-it dhe ultraliberalëve, përsëri mendime të tilla duhen provuar me sy kritik.

Paul Kirchhof, si ministër i financave në hije i CDU-së, në fushatën zgjedhore për në Bundestag në vitin 2005 kishte kërkuar një normë të përgjithshme të tatimit të të ardhurave prej 25 % për të gjithë, ndërkohë që prej dekadash në Gjermani aplikohet një tatim progresiv. Sipas këtij tatimi kemi, së pari, për çdo person një shumë të patatueshme dhe së dyti, të ardhurat do të kalojnë nëpër një taksim progresiv në rritje. Kjo do të thotë: Secili do të kalojë me të ardhurat e veta nëpër progresionin e taksimit të të ardhurave nga 0 deri në të ardhurat e veta bruto me tarifat tatimore respektive.

Pyetje:

Sa të drejtë janë këto dy modele, po t’i shohim sipas John Rawls-it?

6. Rawls-i mund të interpretohet gabim nëqoftëse trajtimin e pabarazisë do ta provojmë vetëm në bazë të parimit të diferencës. Rawls presupozon se të dy parimet bashkë janë parakushte për drejtësi.

2.2.2. Kritika socialiste ndaj koncepteve liberale të drejtësisë

“Ajo çka sundon këtu, janë liria, barazia, prona [...]. Liria! Blerës dhe shitës të një malli, për shembull, të forcës së punës, janë të përcaktuar vetëm nga vullneti i lirë. Ata bashkëveprojnë si persona të lirë, juridikisht të njëjlershëm. [...] Barazia! Ata i referohen njëri-tjetrit vetëm si posedues malli dhe shkëmbejnë ekuivalent për ekuivalent. Prona! Secili disponon vetëm të tijën”. (Marks 1998: f. 189)

*Realiteti
shoqëror*

Drejtësia dhe barazia, nëpër kufizimet e prezantuara deri tani nga Heinrichs dhe Rawls, janë përkufizuar sipas përmbajtjes së tyre filozofike dhe dallohen⁷ prej saj. Ato u referohen koncepteve dhe jo realitetit shoqëror. Për përkufizimin nuk është e rëndësishme, nëse drejtësia në një shoqëri do të shihet si e realizuar apo jo.

Megjithatë funksionimi real i vlerave bazë në shoqëri natyrisht që është një pretendim esencial. Pikërisht për këtë pretendim flasin edhe konceptet socialiste të drejtësisë.

*Si mund të
shpjegohen
pabarazia dhe
padrejtësia
sunduese
në shoqëri?*

Konceptet socialiste nisen nga rregulli se pabarazia dhe padrejtësia sunduese duhet të mund të shpjegohen. Fakti që kushtetutat shoqërore qartësisht nuk të drejtojnë drejt barazisë ose shpërndarjes së drejtë, kjo mund të lexohet drejtpërsëdrejti në statistikën e varfërisë dhe pasurisë. Pra, pabarazia dhe padrejtësia nuk janë aspak thjesht një aksident ndërmarrjeje apo një reaksion ndaj një mosbalancimi të shfaqur një herë, përkundrazi ky është një problem sistematik shoqëror. Në radhë të parë (por le të mos mbetemi vetëm këtu) kushtet e prodhimit të ekonomive kapitaliste të tregut janë identifikuar si shkaktarë për pabarazinë dhe padrejtësinë.

Konceptet socialiste, në 150 vitet e fundit, e kanë ndërtuar argumentimin e tyre bazuar në dy shtylla: Nga njëra anë kërkojnë një rishpërndarje të pasurisë shoqërore dhe nga ana tjetër kërkojnë që mënyra se si prodhohen dhe konkurrojnë mallrat, duhet të ndryshojë me themel, me qëllim që të mund të realizohet liria për të gjithë njerëzit. Për të garantuar liri për të gjithë, duhet realizuar barazia, ky është edhe mendimi bazë.

7. Këtu Heinrichs me siguri nuk ka parasysh asnjë teori liberale, por në radhë të parë sfondin shoqëror-filozofik të filozofisë radikale.

Rawls, në konceptin e tij, e ka kundërshtuar këtë argumentim dhe pretendon se ekonomia sociale e tregut personat e pozicionuar më keq përgjithësisht i pozicionon krahasimisht më mirë.

Pozicionet socialiste i kundërshtojnë premisat e Rawls-it se pabarazia ekonomike mund të ndikojë në leverdinë e të gjithëve (dhe para së gjithash në favor të më të dobëtëve). Për më tepër pozicionet socialiste marrin një qëndrim më të ashpër ndaj pabarazisë dhe padrejtësisë. Të dhëna empirike nga studimet e viteve të fundit u japin të drejtë⁸ lidhur me sa thuhet më sipër.

Kjo çarje në të majtën politike ravijëzohet edhe në aspektin teorik. Gjatë diskutimit mbi drejtësinë vendosen përballë dy modele të ndryshme: nga njëra anë drejtësia e shpërndarjes së të mirave sociale dhe materiale, nga ana tjetër drejtësia për akses apo pyetja nëse njihen dhe si njihen grupet e njerëzve në shoqëri si edhe nëse ata marrin akses ndaj pozicioneve shoqërore (pra statusi social). Ky është një diskutim jo vetëm politik, por edhe teorik. Natyrisht, kjo kundërvënie e ashpër e drejtësisë së shpërndarjes nga njëra anë dhe e drejtësisë për akses nga ana tjetër, bazohet mbi paragjykimet e të dyja palëve.

Pikërisht teoricienët që vlerësojnë drejtësinë e aksesit, parimisht nuk e përjashtojnë rishpërndarjen. Për më tepër këtu, zakonisht, kemi të bëjmë me nocione komplekse të drejtësisë, të cilat pabarazinë ekonomike e llogarisin si një problem të barazisë.

Ballafaqimi është i rëndësishëm, në radhë të parë sepse mund të nënkuptojë një çarje në target-grupin veçanërisht të rëndësishëm për demokracinë sociale, në grupin e punëmarrësve dhe të të papunëve. Për momentin mund të vëzhgojmë se ky target-grup – ashtu sikurse edhe më parë në histori – nuk polarizon vetëm me këtë çështje të lirisë dhe barazisë.

Këtu është prezantuar shkurtimisht nocioni dydimensional i drejtësisë i Nancy Fraser, i cili kombinon në një masë të veçantë dy dimensionet e drejtësisë.

*A mund të çojë
pabarazia
drejt leverdisë
për të gjithë?*

*Drejtësia e
shpërndarjes
vs. drejtësia e
aksesit*

8. Si përfaqësues përmendim studimet me vlerë: Bourdieu 1997; Castel 2000; Schultheis/Schulz 2005.

2.2.3. Nocioni dydimensional i drejtësisë i Nancy Frasers

Një nocion dydimensional i drejtësisë

Nancy Fraser, në konceptimin e saj për drejtësinë, është përpjekur të zbutë betejën midis drejtësisë së shpërndarjes/rishpërndarjes dhe drejtësisë për akses/argumentimit liberal dhe më pas të propozojë një nocion dydimensional të drejtësisë:

“Në rrafshin teorik është e nevojshme të projektojmë një konceptim dydimensional të drejtësisë, i cili mund të harmonizojë pretendimet legjitime për barazi sociale me kërkesat legjitime për njohjen e dallimeve. Në rrafshin praktik bëhet fjalë për të projektuar një skemë orientimi programatike e politike, e cila na lejon të bashkohen favoret e politikës së rishpërndarjes dhe avantazhet e politikës së njohjes së saj.” (Fraser 2003: f. 17)

Teza e Fraser-it ka të bëjë me atë që çdo padrejtësi apo ngrënie haku përmban si dëmtim ekonomik ashtu edhe njohje të munguar, natyrisht në përqindjet respektive specifike.




Fig. 3: Nocioni i drejtësisë i Nancy Fraser-it

Shembuj nga praktika

Shpërfillja e homoseksualëve këtu duhet transferuar, para së gjithash, në fushën e statusit dhe të respektimit shoqëror. Njëkohësisht ajo është e lidhur pazgjidhshmërisht me pozicionin më të keq financiar në taksimin e partneriteteve të regjistruara të jetës. Pra, “drejtësia” këtu mund të

Nancy Fraser (lindur më 1947) është profesore për shkencën politike në New School for Social Research në Nju Jork.

Ajo cilësohet si një nga teoricienët më të njohura feministe

Ka një sërë botimesh mbi teorinë feministe, mbi teorinë e drejtësisë dhe Teorinë Kritike

arrihet, kur merret parasysh konstelacioni specifik i shpërfilljes në statusin e tyre shoqëror dhe dimensionin ekonomik.

Si shembull i dytë mund të përmenden stigmatizimi dhe përjashtimi i të papunëve në shoqërinë tonë. Vërtet që kufizimi i tyre

shoqëror, në pjesë të rëndësishme, varet nga siguri i tyre i keq material. E megjithatë studime empirike provojnë vazhdimisht e në mënyrë të përsëritur, se respektimi dhe njohja shoqërore, d.m.th. statusi shoqëror, për të prekurit në fjalë, paraqet gjithashtu një problem të dukshëm. Për të krijuar drejtësi dhe pjesëmarrje në shoqëri, kjo kërkon strategji që të mbajnë parasysh në mënyrë të mjaftueshme të dy dimensionet.

Pra Fraser përshkruan fillimisht një procedurë analitike për analizimin e trajtimit jo të barabartë dhe të padrejtësisë. Megjithatë ajo formulon edhe në mënyrë normative, se çfarë duhet të jetë drejtësia sipas mendimit të saj. Ajo e kupton drejtësinë si “paritet pjesëmarrje”:

“Thelbi normativ i konceptimit tim [konsiston] në përfytyrimin e një pariteti pjesëmarrës. Sipas kësaj norme shoqëria kërkon masa shoqërore, të cilat u lejojnë të gjithë anëtarëve (të rritur) të shoqërisë të komunikojnë me njëri-tjetrin si të barazvlefshëm. Që pariteti pjesëmarrës të mund të bëhet i mundur, duhet, sikurse pretendoj unë, të jenë plotësuar të paktën dy kushte. Nga njëra anë shpërndarja e resurseve materiale duhet të sigurojë pavarësinë dhe të “drejtën e votës” së pjesëmarrësve. Këtë dua ta quaj kusht objektiv. Format dhe fushat respektive të varësisë dhe pabarazisë ekonomike që vështirësojnë paritetin e pjesëmarrësve, ajo i përjashton që në fillim. [...] Ndërsa kushti i dytë kërkon që modelet e vlerave kulturore, të institucionalizuara, t’u shfaqin të gjithë pjesëmarrësve të njëjtin respekt dhe t’u garantojnë atyre shanse të barabarta gjatë fitimit të respektit shoqëror. Këtë dua ta quaj kusht intersubjektiv i paritetit pjesëmarrës.” (Fraser 2003: f. 54)

*Drejtësia
kërkon
një strategji
shumë-
dimensionale*

*Përfytyrimi
i një
„pariteti
pjesëmarrës”*

Fraser - ashtu sikurse ka bërë edhe Rawls - duhet të emërtojë se sipas cilave kriterë ajo do të konstatojë apo të përjashtojë një trajtim jo të njëjtë, të drejtë apo të padrejtë, në dy dimensionet. Për këtë ajo propozon kriterin e mëposhtëm:

“Për këtë shërben i njëjti kriter i përgjithshëm për të dy dimensionet, për të dalluar pretendimet e drejta nga ato të padrejta. Krejt njësoj, nëse problemin e paraqesin shpërndarja apo njohja, pretenduesit duhet të tregojnë në të dy rastet se masat ekzistuese i pengojnë që të marrin pjesë në jetën shoqërore si të barazvlefshëm.” (Fraser 2003: f. 57)

Hapat e kontrollit

1. Analiza: Cilin trajtim të pabarabartë keni përpara? Si paraqiten të dy dimensionet?
2. Zbatimi i kriterit: Si e pengojnë masat /rregullat e shoqërisë paritetin pjesëmarrës?
3. Alternativat: Nëpërmjet cilave ndryshime dhe strategji mund të vendoset pariteti pjesëmarrës?

Këto hapa kontrolli (analiza në bazë të dy dimensioneve në lidhje me padrejtësinë konkrete të pretenduar, zbatimin, alternativat) tek Fraser janë, në radhë të pare, një çështje e trajtimit dhe kompromiseve.

Edhe këtu, natyrisht, ka kuptim të bëhet një test praktik. Për shembull, këtu mund të nisët një diskutim mbi sigurimin e qytetarëve vs. kuotën e shëndetësisë (pagesa e një shume të përgjithshme për frymë) (krahaso faqe 47).

Për luftimin e padrejtësisë Fraser diskuton dy strategji të ndryshme shoqërore (Fraser 2003: f. 102): Afirmimi (përshtatja ndaj asaj çka ekziston) dhe transformimi (ndryshimi).

Kështu shteti liberal i mirëqenies paraqet një strategji afirmative për të zbutur disavantazhet ekonomike të ekonomisë së lirë të tregut. Vërtet që këtu nuk do të hiqet trajtimi jo i barabartë ekonomik i kapitalit dhe punës, por ai do të zbutet.

Një strategji transformuese mund të kishte qenë ajo e socialisteve dhe socialistëve, pra ajo e zëvendësimit të ekonomisë së lirë të tregut me një kushtetutë socialiste të ekonomisë.

Pikënisje e
"reformave
joreformatore"

Fraser i kundërshton të dy strategjitë. Ndryshe nga to ajo sjell një strategji të tretë, të cilën (sipas Andre Gorz) e quan "reforma joreformatore". Këtë nocion kaba dhe jo lehtësisht të kuptueshëm ajo e lidh me një projekt socialdemokrat:

"Në periudhën fordiste [kjo strategji] formuloi kuptimin e socialdemokracisë në pjesë të spektrit politikisht të majtë. Nga kjo perspektivë socialdemokracia u pa jo vetëm si një kompromis i thjeshtë midis një shteti afirmativ liberal të mirëqenies nga njëra anë dhe një tjetri transformativ socialist nga ana tjetër. Për më tepër ajo është kuptuar si një regjim dinamik, zhvillimi i të cilit, në aspektin afatgjatë, do të jetë transformues. Mendimi ishte që fillimisht të institucionalizoheshin një sërë reformash rishpërndarjeje qartësisht afirmative, midis të tjerash pretendimi i përgjithshëm për ndihmë sociale, një taksim fuqimisht progresiv, masa makro-ekonomike politike për krijimin e punësimit të plotë, një sektor publik i lirë nga tregu dhe i shtrirë gjerësisht dhe një pjesë e dukshme në pronën publike dhe/ose kolektive. Megjithëse asnjë nga këto masa politike nuk e ndryshoi strukturën e shoqërisë kapitaliste, përsëri pritej që ato në tërësinë e tyre të influenconin balancën e pushtetit midis kapitalit dhe punës në favor të kësaj të fundit dhe në plan afatgjatë të mund të favorizonte transformimin. Sigurisht kjo pritshmëri nuk është krejt e padrejtë. Në fund të fundit ajo nuk mundi të plotësohet kurrë, sepse neoliberalizmi shpejt përgatiti fundin e eksperimentit." (Fraser 2003: f. 110)

Kjo strategji e "reformës joreformiste" përpiket të ndërtojë një urë midis koncepteve social-liberale dhe socialiste të drejtësisë.

2.2.4. Dimensioni politik i drejtësisë midis “drejtësisë së rendimentit” dhe “drejtësisë së nevojave”

Diskutimi filozofik ka treguar se drejtësia nga ana filozofike mund të përcaktohet në mënyra të ndryshme, se deklaratat filozofike mund të ndihmojnë vetëm në mënyrë të kufizuar. Sepse këtu kemi të bëjmë me një përcaktim relativ të nocionit, i cili vepron shoqërisht dhe pranohet nga grupe të ndryshme shoqërore (si sindikatat, bashkimet e punëdhënësve ose partitë).

Në fund të fundit – kjo është treguar tashmë në diskutimin filozofik - në çështjet e drejtësisë kemi të bëjmë gjithnjë me shpërndarjen e të mirave materiale ose jo materiale (“drejtësia e shpërndarjes”), që gjykohen si të drejta ose jo të drejta.

Në diskutimin politik, natyrisht, kanë zënë vend, ndër të tjera, edhe dy koncepte të tjera të drejtësisë, të cilët përpiqen ta argumentojnë dhe ta legjitimojnë ndarjen e të mirave duke u nisur nga këndvështrime të ndryshme.

Drejtësia e rendimentit apo “arritjet/rendimenti duhet t’ia vlejë përsëri”? Në radhë të parë kampi borgjez i FDP dhe CDU/CSU përfaqëson rregullisht pikëpamjen, se rendimenti i punës legjitimon pozicionimin më të mirë gjatë shpërndarjes së të mirave. Drejtësia e rendimentit presupozon përfytyrimin se drejtësia e shpërndarjes mund të matet nga puna e secilit person.

Një shembull për këtë është kufiri i matjes së kontributit në sigurimin e të sëmurëve. Duke filluar nga një e ardhur e caktuar vjetore është e mundur që të zgjedhësh një kasë private për pacientët (dhe bashkë me të edhe një trajtim më të mirë në rast sëmundje). Pjesë të mëdha të së majtës politike mbajnë qëndrim skeptik deri kundërshtues ndaj argumenteve të tilla.

Por, nga ana tjetër, drejtësia e rendimentit/punës edhe për të majtën është një figurë argumentimi: “Shpatullat e forta duhet të mbajnë edhe më shumë”, kështu thotë një argument i përhapur gjerësisht, i cili i referohet drejtësisë ndaj punës. Kush ka më shumë, duhet të kontribuojë

edhe më tepër për të mirën e përgjithshme. Në siguracionet sociale (sigurimi i të papunëve dhe i pensionit) me këtë lidhet natyrisht edhe garancia e ruajtjes së statusit social: Kush më parë ka paguar shumë, në rast nevojë merr më shumë.

Një argument i njëjtë lejon të përdoret në mënyrë kritike edhe lidhur me strukturën e pagës në sipërmarrje; A ka kontribuar vërtet kryetari i kryesisë më shumë se punëtorja e konvejerit për suksesin e ndërmarrjes, a ka kontribuar më tepër analisti i bursës se infermierja e spitalit?

Pra shihet se: drejtësia e rendimentit pretendohet nga kampe të ndryshme politike. Drejtësia e rendimentit ka zënë vend si bazë politike e argumentimit për një ndarje jo të barabartë. E megjithatë ajo mbetet, në radhë të parë, një argumentim relativ dhe për pasojë një çështje e raporteve të forcave shoqërore dhe kompromiseve të tyre.

Drejtësia e nevojave: Drejtësia e nevojave pyet se çfarë shërbimesh duhet të marrin persona të ndryshëm, sepse këtë e kërkon situata e tyre sociale. Për shembull, një person që ka nevojë për ndihmë, duhet të marrë trajtim sipas një shkalle të caktuar kujdesi shëndetësor. Një që gëzon shëndet të plotë nuk mund ta pretendojë të marrë një shërbim të tillë, pasi ai nuk e ka këtë nevojë specifike, ose nevojat e tij nuk janë të njohura shoqërisht. Sipas drejtësisë së nevojës orientohen shumica e shërbimeve në transfertën sociale, sipas kodit social. Edhe drejtësia e nevojës gjendet si bazë legjitimimi në sistemin tonë shoqëror

Të dy argumentimet ndikojnë politikisht e janë vazhdimisht në diskutim.

*Drejtësia e
nevojave*

2.2.5. Ekskurs: Barazia dhe drejtësia si nocione socialdemokrate

Zhvendosja e theksit në diskutimin mbi drejtësinë

Përveç këtyre mënyrave filozofike të qasjes ndaj nocionit të “drejtësisë”, interesante është edhe renditja e nocioneve udhëheqëse politike brenda socialdemokracisë në historinë e Republikës Federale. Këtu konstatohet një zhvendosje politike e theksit gjatë diskutimit mbi drejtësinë, e cila ekziston pavarësisht diskutimit teorik, por që në vijim është influencuar kryekëput prej saj.

Këtu përzgjidhet vendosja politike e nocionit të socialdemokracisë, edhe për faktin se socialdemokracia në një masë të veçantë, në peizazhin partiak të Republikës Federale, mund të shihet si parti e drejtësisë sociale.

Në vendosjen e nocioneve është për t’u vënë re një renditje, e cila – për sa u përket fazave të qeverisjes socialdemokrate - si pikësynim ka transformimin, se si politika mund ta realizojë apo të mund ta zhvillojë drejtësinë me mjete shtetërore. Nocioni i „drejtësisë” është plotësuar më pas nga ai i barazisë së shanseve, dhe më vonë edhe nga ai i drejtësisë së shanseve.

„Barazia”

Veçanërisht deri në vitin 1959, kur socialdemokracia gjermane në kongresin e Bad Godesberg-ut përfshiu shtresa të reja zgjedhësish, nocioni i “barazisë” ishte krejtësisht pjesë e pretendimeve shoqërore të politikës së majtë. Ai përfshiu të gjitha fushat e jetës. E megjithatë në qendër qëndronte sfera shoqërore e punës. Barazia ishte e lidhur, në radhë të parë, me kapërcimin e mungesës së lirisë dhe kapërcimin e shfrytëzimit në marrëdhëniet e prodhimit. Që nga ligji i bashkëvendimmarrjes për ndërmarrjet e minierave dhe ato të prodhimit të hekurit e çelikut deri në valën e grevave të viteve 1950-të – ngjarje që sot përgjithësisht nuk përmenden - kishim të bënim me luftën për më shumë barazi, pra për më shumë bashkëvendosje lidhur me punën dhe jetën. Në rezultat kjo ishte kontradiktore, sepse me anë të bashkëvendosjes në ndërmarrje dhe sipërmarrje u arrit vërtet një sukses i pjesshëm, por në të njëjtën kohë nuk u plotësua në vazhdimësi kërkesa për barazi në sferën e punës.

„Barazia e shanseve”

Në epokën e Brandt-it dhe gjatë koalicionit social-liberal u krijua nocioni i „barazisë së shanseve”, që edhe sot ka akoma një forcë të madhe rrezatuese (jo vetëm në gjirin e socialdemokracisë) dhe që karakterizoi në mënyrë të veçantë politikën progresive të erës së Brandt-it. Koncepti i krijuar rishtas pranonte në mënyrë tendencioze pabarazinë shoqërore ekzistuese dhe vendoste në fokus sferën e politikës arsimore. Zgjerimi i institucioneve

arsimore dhe i sektorit shtetëror u bë një argumentim esencial për të bindur mjedise të reja dhe shtresa zgjedhësish dhe që pabarazinë të mos e kuptojnë vetëm në shpërndarjen materiale, por edhe me shpërndarjen e shanseve të shkollimit në shoqëri. Që shpërndarja jo e njëjtë e resurseve materiale dhe shpërndarja jo e barabartë e mundësive për arsimim plotësojnë njëra-tjetrën, kjo me siguri ishte e dukshme për socialdemokracinë. Ndërsa për liberalët theksi vendosej më pak në një kryqëzim të nocioneve „barazi“ dhe „barazi shansesh“, por më tepër në atë që barazia duhet të zëvendësohet nga barazia e shanseve. Për pasojë barazia e shanseve ishte e aftë të bashkohej me pozicionet liberale. Vetëm kështu, në fund të fundit, u bë e mundur një politikë social-liberale.

Fokusi i ri ishte shenjë e një konstelacioni të ri shoqëror dhe e një orientimi të ri të politikës. Në këtë pikëpamje nocioni „barazia e shanseve“ ishte karakteristik. Ai u fut në një moment, kur një kuptim pozitiv i shtetit social stabilizoi situatën ekonomike.

Në fazën e tretë të qeverisjes socialdemokrate nën drejtimin e kancelarit Gerhard Schröder nocioni i „barazisë së shanseve“ u zëvendësua nga nocioni i „drejtësisë së shanseve“. „Drejtësia e shanseve“ e vendos fokusin më fuqishëm mbi aspektin e shpërndarjes. Nocioni e bën të qartë, se shanset në shoqëri janë të lidhura me shpërndarjen e resurseve materiale dhe imateriale. Dhe këto resurse janë të kufizuara ekonomikisht – ky ishte një argument krijues i kësaj faze qeverisjeje.

Shanset e limituara duheshin ndarë „drejtë“. Për këtë, politika e Schröder-it huazoi përfytyrimin politik të „drejtësisë së rendimentit/arritjeve: Formula e „nxitjes dhe e kërkesës“ përmban garantimin e shanseve dhe ndarjes së resurseve materiale po ashtu si edhe shpërblimin e pritshëm.

Pikërisht përkufizimi i drejtësisë së shanseve përçan të majtën në diskutimin politik. Çështjet kritike të diskutuara ishin dhe janë para së gjithash këto

- A ka vërtet – dhe në qoftë se po, në çfarë mase – kufizime objektive të supozuara të resurseve? Apo bëhet fjalë për vendime politike, që mund të merreshin dhe ndryshe (për shembull, në fushën e financave shtetërore dhe sistemet e sigurimit social)?
- A duhet quajtur e drejtë shpërndarja shoqërore e rëndimit dhe lehtësimit të barrës në formën e zgjedhur (për shembull, nga njëra anë ulja e barrës së sipërmarrjeve, nga ana tjetër shkurtimet në rrjetin social)?

„Drejtësia e shanseve“

Përkufizimi i drejtësisë së shanseve përçan të majtën politike

Pavarësisht nga fakti se si u përgjigjemi këtyre pyetjeve, përsëri bëhet e qartë se nocioni i drejtësisë është i diskutueshëm si teorikisht, ashtu edhe politikisht.

Kërkesat ndaj demokracisë sociale që rezultojnë nga diskutimi mbi drejtësinë:

- Drejtësia është vlera themelore, kur kemi të bëjmë me shpërndarjen e të mirave materiale dhe jomateriale. Natyrisht që demokracia sociale nuk mund të bazohet në një koncept unik të drejtësisë. Si bazë legjitimiteti “drejtësia” shoqërisht është efektive si bazë argumentimi, ndërsa teorikisht është e diskutueshme.
- Me sa duket “Drejtësia” për fusha të ndryshme shoqërore duhet vrojtuar veçmas.
- Vetë barazia si një shpërndarje e barabartë e të mirave nuk ka nevojë argumentimi. Deviacionet duhen përkufizuar dhe trajtuar nën pikëpamjen e drejtësisë.
- Liria që funksionon realisht, nuk mund të mendohet pa barazinë.

“Barazia” në programin e SPD-së së Hamburgut

„Drejtësia bazohet mbi dinjitet të njëjtë të çdo njeriu. Ajo do të thotë liri e barabartë dhe shanse të barabarta jetese, pavarësisht prejardhjes dhe gjinisë. Pra, drejtësia kupton pjesëmarrje të njëjtë në arsimim, punë, siguri sociale, kulturë dhe demokraci, akses të barabartë për të gjitha të mirat publike. Aty ku shpërndarja e pabarabartë e të ardhurave dhe pasurisë ndan shoqërinë në të tillë njerëz që disponojnë të tjerët, dhe të tillë që disponohen prej të tjerëve, pikërisht këtu ajo bie ndesh me lirinë e barabartë dhe për pasojë është e padrejtë. Për këtë drejtësia kërkon më shumë barazi në shpërndarjen e të ardhurave, pasurive dhe pushtetit. [...] Kontributi dhe puna duhen njohur dhe respektuar. E drejtë është një shpërndarje e të ardhurave dhe pasurisë që matet me punën e kryer. Prona obligon: Kush fiton mbi mesataren, kush posedon më shumë pasuri se të tjerët, ai duhet të kontribuojë më shumë për të mirën e shoqërisë.”

(Programi i SPD-së së Hamburgut 2007: f. 15)

2.3. Solidariteti

Koncepti i diskutuar më pak është ai i “solidaritetit” (ose i ashtuquajtura “Vëllazëri” në Revolucionin Francez). Kjo me siguri edhe për shkak se te solidariteti kemi të bëjmë me një nocion, i cili i përket ndjenjës së përbashkët njerëzore dhe për pasojë është më e vështirë të integrohet në një ngrehinë teorike.

Solidariteti, duke u mbështetur tek autorë⁹ të ndryshëm, mund të përkufizohet afërsisht si:

- Një ndjenjë e bashkësisë dhe e përgjegjësisë së ndërsjellë që
- vjen nga një situatë e përbashkët interesash dhe
- që pasqyrohet në një sjellje shërbyese për komunitetin, madje edhe kundër leverdisë personale afatshkurtër,
- dhe që shkon përtej pretendimit formal për drejtësi reciproke.

Pra „solidariteti” është një çështje e „identitetit social” të përbashkët, i cili ushqehet nga një mënyrë e njëjtë jetese dhe vlera të përbashkëta.

Por sociologu dhe filozofi moralist amerikan, Walzer, thekson me një farë të drejte se solidariteti mund të jetë i rrezikshëm, „kur ai është vetëm një ndjenjë, një zëvendësim emocional për bashkëpunim në vend të pasqyrimit të kooperimit faktik, jetësor dhe të përditshëm” (Walzer 1997: 32)

Ky bashkëpunim i përditshëm lidhet me institucione dhe struktura shoqërore, ku mund të zhvillohet solidariteti dhe kontribuohet për sigurinë sociale.

Solidariteti mund të merret edhe i shfaqur ekskluzivisht apo në formë diskriminuese - fryma e bashkësisë e grupit ekstremist të dhathtë është një shembull. Për një shoqëri demokratike, e cila zhvillohet nga dhe me një shoqëri civile të hapur dhe pluraliste, kjo formë e gabuar e solidaritetit është një rrezik i pamasë dhe ende i nënvlerësuar. Kufiri quhet i kapërcyer, kur ruajtja e një komuniteti ushqehet me diskriminimin e të tjerëve.

9. Për shembull, Hondrich (e të tjerë) 1994, Carigiet 2003

Prandaj solidariteti nuk duhej diskutuar pa realizimin e lirisë dhe barazisë në një shoqëri demokratike.

Aq sa i vështirë është nocioni për t'u kuptuar, aq më i efektshëm ka qenë ai për t'u futur në shtratin shoqëror të historisë sociale. Kështu siguracionet e mëdha (sigurimi i të papunëve, të sëmurëve, pensioneve dhe sigurimi ndaj aksidenteve) janë institucione solidare të të punësuarve. Themelimi i tyre në vitet 1890-të dhe 1920-të ka ardhur, në radhë të parë, nga presioni në rritje i punëtoreve dhe punëtorëve, socialistëve/ socialdemokratëve – madje edhe nën qeverisjen konservatore të Bismarikut.

Edhe mënyra e ngritjes së shoqërive (kooperativave) karakterizohet si një bashkësi solidare, ku anëtarët, mbi bazën e një interesi të përbashkët, krijojnë një bashkësi, e cila shfuqizon shumë konkurrencën e zakonshme në treg.

Duke vazhduar më tej, mund të themi se solidariteti presupozon që balancimi i interesave është i domosdoshëm për funksionimin e tij. Kjo tregon se solidariteti lind vetëm atëherë, kur në argumentimet politike merren parasysh interesa të ndryshme, në radhë të parë të përbashkëta.

Kërkesa për demokracinë sociale, nisur nga diskutimi mbi solidaritetin:

- Solidariteti mund të nxitet si detyrim social brenda shoqërisë nga institucionet shoqërore, por nuk prodhohet.
- Në demokracinë sociale duhet kontrolluar se në çfarë mënyre veprojnë institucionet shtetërore dhe të shoqërisë civile mbi lidhjen solide.

„Solidariteti“ në programin e SPD-së së Hamburgut:

„Solidaritët do të thotë lidhje e ndërsjellë, bashkim dhe ndihmë. Ai është gatishmëria e njerëzve për t'i qëndruar pranë njëri-tjetrit dhe për të ndihmuar njëri-tjetrin. Ai gjendet midis të fuqishmëve dhe të dobëtëve, midis brezave dhe midis popujve. Solidariteti krijon fuqi për ndryshim, ai është përvoja e lëvizjes punëtore. Solidariteti është një forcë e fuqishme, e cila e mban të bashkuar shoqërinë tonë – me gatishmëri spontane dhe individuale për të ndihmuar, me rregulla dhe organizma të përbashkëta, në shtetin social si solidaritet politikisht i garantuar dhe i organizuar.“
(Programi i SPD-së së Hamburgut)

- Solidariteti duhet të diskutohet gjithmonë në raport me realizimin e lirisë dhe të barazisë.

2.4. Çfarë thonë në të vërtetë të tjerët?

Nga Martin Timpe

*“Krijimi hyjnor”
në fokus të
vëmendjes*

Në praktikën politike, të kuptuarit socialdemokrat për vlerat bazë nuk qëndroni vetëm. Edhe parti të tjera – në programet parimore apo në dokumente bazë të njëjta - kanë formuluar interpretimet e tyre mbi vlerat bazë. Ne dëshirojmë t’u hedhim një vështrim të shkurtër këtyre qasjeve. Me këtë nuk kemi asnjë pretendim të vlerësojmë se sa të plotë janë, përkundrazi do t’i kalojmë programet duke i shfletuar me shpejtësi, pa humbur në detaje semantike.

► “Krijimi hyjnor në fokus të vëmendjes: CDU – Unioni Kristian-Demokrat

Vlerat bazë të CDU-së janë liria, drejtësia dhe solidariteti. Në programin e saj parimor që u vendos në Kongresin e Hanoverit në dhjetor 2007, kjo parti formulon këto tri vlera bazë. Edhe pse vlerat bazë, në shikim të parë, janë identike me ato që ka formuluar Partia Socialdemokrate në programin e saj të Hamburgut, përsëri me një shikim më të saktë konstatohen dallime. Kështu te CDU të bie në sy theksimi i fortë i orientimit të saj drejt portretit kristian të njeriut dhe drejt krijimit hyjnor. Te CDU feja e krishterë është pika qendrore e referimit, tek interpretimi socialdemokrat i vlerave bazë, kjo paraqet vetëm një prej shumë burimeve të vlerave bazë. (Tek Partia e landit bavarez, CSU – Unioni Kristian Social, ky orientim bazë është akoma më i theksuar dhe plotësohet nga një orientim konservativ i djathtë ndaj kombit dhe patriotizmit.)

Në disa qasje vazhdon të jetë i njohur fakti që CDU-ja ka përdorur një nocion tjetër të lirisë nga ai i SPD-së. Fillimisht liria është formuluar te CDU-ja qartësisht më e plotë se sa dy vlerat e tjera bazë –ashtu si edhe i gjithë procesi i lindjes së këtij programi parimor nën titullin „Drejtësi e re nëpërmjet një lirie më të madhe“. Të dyja mund t’i japin prioritetit vlerës bazë liri, ndërsa SPD-ja insiston në barazvlefshmërinë e vlerave bazë. Përveç kësaj në programin e CDU-së janë theksuar më fort të drejtat e lirisë mbrojtëse, pra të drejtat negative të lirisë, se sa të drejtat mundësuese, pozitive, të lirisë.

► Tri vlerat bazë të Partisë së Lirë Demokrate. (FDP, Liri, Liri dhe Liri

Partia Liberale, FDP, nuk ka asnjë program parimor. Por, po të shohim dokumente të njëjta themelore si „Parimet e Wiesbaden-it“, që u

*Liri, Liri,
Liri*

aprovuan në Kongresin Federal të kësaj partie në vitin 1997, aty do të shohim qartë një orientim shumë të njëanshëm drejt vlerës bazë të lirisë. Mund të mendohet se kjo është e vetëkuptueshme për një parti që i sheh rrënjët e saj në liberalizmin politik. Si kundërgargument mund të thuhet, se këto janë shtjelluar shumë shkurt. Sepse me siguri që John Locke, një prej baballarëve të hershëm të liberalizmit politik, nuk do të ofendohej nëse pretendojmë se edhe aspektet e drejtësisë kanë luajtur një rol qendror në pikëpamjet e tij për shoqërinë. Ndërsa FDP-ja përpiket ta lidhë çdo aspekt të orientimit parimor me nocionin e lirisë. Formulime të tilla si “liria është përparim” ose “liria është në harmoni me të ardhmen” tregojnë se sa artificialisht përpiqen liberal-demokratët të krijojnë referencën e tyre mbi një vlerë bazë, e cila pa diskutim është e rëndësishme. Por e qartë është gjithashtu, se një shoqëri, e cila fokusohet në mënyrë të njëanshme tek liria dhe me këtë harron drejtësinë dhe bashkëveprimin solidar, shumë shpejt do të ketë probleme që e kërcënojnë ekzistencialisht kohezionin social.

*Në një buqetë
plot ngjyra
ka diçka për të
gjithë*

➤ **Në një buqetë plot ngjyra do të ketë diçka për të gjithë: Aleanca 90/ Të gjelbrit**

Të gjelbrit i atribuojnë vetëvendosjes së njeriut një rol qendror. Ata shpallsin një koncept të drejtësisë, i cili ka aq shumë faceta, sa që nuk mund të konceptohet. Drejtësisë së shpërndarjes, e cila duhet të ekzistojë edhe më tej, i vihen në krah drejtësia e pjesëmarrjes, drejtësia e gjeneratave, drejtësia e gjinive dhe drejtësia ndërkombëtare. Është e sigurt se asnjë nga këto kërkesa nuk është gabim. Por që t’i vendosësh të gjitha këto qasje në të njëjtin nivel, pa caktuar radhën e prioritetëve, edhe kjo nuk është formë që mund të ndihmojë lexuesin e interesuar apo lexuesin kritik për të pasur një përfytyrim të qartë se çfarë kuptohet me drejtësi.

Sikurse është pjesë e një partie ekologjike, vlerat bazë plotësohen vazhdimisht me kërkesa për qëndrueshmëri në të gjitha fushat e politikës. Por, natyrisht nuk është vërtet bindëse që detyrën e qëndrueshmërisë – që pa diskutim është e rëndësishme – ta vendosim në të njëjtin nivel krahas vlerave bazë si liria, drejtësia dhe solidariteti.

► Gjithçka ende në lëvizje: Partia “E majta”

Partia „E Majta”, e krijuar nga bashkimi i „Të Majtës. PDS” dhe “WASG”, ende nuk ka aprovuar ndonjë program parimor. Në „Piketat programatike”, që kanë qenë edhe baza e shkrirjes së dy partive, gjenden disa shpjegime të përcipta mbi vlerat bazë. Aty u referohen demokracisë, lirisë, barazisë, drejtësisë, internacionalizmit dhe solidaritetit si orientime vlerash themelore. Parë nga një perspektivë historike na qetëson njohja e qartë e lirisë individuale, por gjithnjë duke mos u shndërruar barazia në vënie nën tutelë dhe vendimmarrje të huaj. Gjithashtu është i qartë po-himi— dhe këtu edhe partizanët e demokracisë sociale sigurisht nuk do të kundërshtonin, edhe pse ata do ta kishin formuluar ndryshe – se liria pa barazi do të thotë vetëm liri për të pasurit. Pikërisht ky raport i lirisë dhe barazisë do të jetë ai, përkufizimin e të cilit në diskursin programatik të mëtejshëm të partisë „E Majta” duhet ta ndiqnim me vëmendje.

2.5. Vlerat bazë në praktikë

Pasi jemi marrë shumë me vlerat bazë në rrafshin teorik, tani dëshirojmë të hedhim një vështrim në praktikë. Çfarë roli luajnë vlerat bazë për një demokraci sociale në diskutimin politik të përditshëm? Një mori shembujsh nga fusha të ndryshme lipset të japin ide të reja dhe të na nxitin për të menduar më tej.

2.5.1. Politika e arsimit¹⁰

Masterplani „Shkolla krijon shanset e së ardhmes” – për zbatimin komunal të një politike arsimore progresiste¹¹

Nga Marc Herter

Që nga viti 2003, kur studimet e para PISA zbuluan mangësitë e sistemit arsimor gjerman, sistemi i duhur arsimor është bërë një temë shumë e diskutuar në nivel federate, landesh dhe komunash. Veçanërisht fakti që në Gjermani suksesi i arsimit – në radhë të parë në krahasim me vende të tjera – qëndron në lidhje relativisht të ngushtë me prejardhjen sociale të fëmijëve dhe të rinjve, pikërisht kjo është pjesë e debatit. Por si duhet të jetë një sistem shkollor nga ana sociale i drejtë dhe solidar, i cili në të njëjtën kohë u jep të gjithëve lirinë të vendosin vetë për shkollimin dhe profesionin?

SPD-ja në Hamm i ka kushtuar vëmendje kësaj çështjeje dhe ka zhvilluar një plan të integruar socialdemokrat në të ashtuquajturin masterplan „Shkolla krijon shanset e së ardhmes”. Si një qytet autonom Hammi është vetë përgjegjës për shkollat dhe për pasojë edhe për „zhvillimin e mëtejshëm të shkollave, të orientuara nga e ardhmja”.

► Pse një masterplan?

Deri tani politika e shkollimit në Hamm, ku qeveris një koalicion CDU/FDP, po zhvillohet „sipas rastit”. Kjo do të thotë: Kur numri i të regjistruarve në një shkollë është shumë i lartë apo tepër i ulët, këtu bëhen manovrimet, pra shtohen salla klasash, mbyllet shkolla ose dërgohen nxënës në shkolla të tjera, deri sa bëhet përshtatja e duhur. Pas kësaj pritet për rastin tjetër.

¹⁰ Krahaso për temën e arsimit edhe: Udhërrëfyes 3: Shteti social dhe demokracia sociale (2009), kapitulli 7.5 Arsi

¹¹ Shembulli bazohet në një plan zhvillimi të shkollës, të cilin, në fakt, e ka përpunuar SPD-ja në Hamm.

Kjo nuk është një bazë e mirë për një strukturë shkollore komunale të aftë për të ardhmen. Pikënisje për një koncept të ri shkolle ishte veçanërisht edhe të kuptuarit se jo vetëm sistemi shkollor është vendimtar, por edhe pikat e takimit me ndihmën e fëmijëve dhe të rinjve, me nxitjen e kualifikimit dhe të tregut të punës si edhe për nxitjen e integritetit, të gjitha këto janë vendimtare për suksesin e arsimit të fëmijëve dhe të rinjve. Masterplani formulon, nisur nga një analizë, qëllimet afatgjata dhe fushat e veprimtimit operativ, që i përshkon si një fill i kuq përmirësimi i pjesëmarrjes në fushën e arsimit.

Një masterplan socialdemokrat

Qëllimi ishte të paraqitej një alternativë socialdemokrate për administrimin e sistemit shkollor nëpërmjet shumicës qeverisëse në bashki. Se sa e domosdoshme është kjo, këtë e bëjnë të qartë, përveç studimeve aktuale të PISA-s, edhe dy indikatorë mbi mosesin e politikës së derisotme shkollore:

- Me një kuotë mature nën 30 për qind të vitit respektiv shkollor Hammi vazhdon mbetet prapa qyteteve të tjera autonome të NRW-së (Vestfalisë së Rinit Verior). Qyteti fqinj Münster ka një kuotë prej 50 %.
- Ndërsa lagjet e pasura të qytetit kanë shënuar një kalim drejt gjimnazit rreth 50 %, zona klasike e qytetit të punëtorëve Herringen, e ka këtë shifër vetëm 19, 5 % .

Në të njëjtën kohë e në radhë të parë është zhvillimi socialdemografik ai që kërkon një ndërhyrje të qartë. Numri i nxënësve dhe nxënësve në vitin e kalimit nga shkolla bazë drejt një niveli më të lartë shkolle në vitin 2015 në krahasim me vitin 2005 pritet të ulet me një të katërtën. Në vitin 2010, një ndër dy fëmijë të lindur në Hamm ka një prejardhje migracioni. Integriteti dhe ezaurimi i të gjitha rezervave të dhuntive nuk është vetëm një dëshirë politike që e kanë për zemër forcat politike progresiste, por edhe një kusht themelor për një zhvillim të suksesshëm të qytetit gjatë transformimit strukturor.

► Liria që mendojmë ne - kujdestari gjatë gjithë ditës, jo vetëm për pak vetë

Parimi i parë drejtues i masterplanit është zgjerimi i kujdesit ditor për gjatë gjithë zinxhirit të përkujdesjes. Kujdesi i mirë duke filluar nga një vjeç nis me një ofertë shumë cilësore dhe që plotëson nevojat në përkujdesjen e fëmijëve nën tre vjeç, vazhdon pastaj me një përkujdesje kohore të mjaftueshme dhe që nga ana pedagogjike të plotësojë kërkesat e shtruara për fëmijët nga tre deri gjashtë vjeç dhe gjen pastaj formën e tij shkollorë në kujdesin për gjithë ditën, i cili nuk ofrohet vetëm në shkollat

fillore, por që shkon deri në moshën 14 vjeç. Kështu lidhja e familjes me profesionin bëhet praktike. Pra, nuk është bashkia ajo që udhëzon apo dikton se si e qysh edukohen fëmijët, përkundrazi ajo krijon kushtet kuadër, ku bëhet e mundur vendimarrja e lirë për nënat dhe baballarët. Liria nuk është kështu vetëm liria e familjeve të kamura, të cilat e përballojnë dhe mund të marrin një dado për të mbajtur fëmijën e tyre, por për të gjitha familjet, në mënyrë që ato të mund të realizojnë projektet e jetës së tyre.

► Drejtësia sociale që vepron –

shkolla të përgjithshme të distrikteve të qytetit për shanse të reja

Një parim tjetër drejtues i masterplanit është që në çdo një nga shtatë njësitë vendore të qytetit të Hamm-it të lejohen më shumë nxënës dhe të ketë shanse për të shkuar më lart në sistemin shkollor. Në çdo distrikt të qytetit duhet të jetë e mundur çdo lloj diplome shkollore. Qëllimi është që ta ndajmë suksesin e shkollës nga prejardhja e nxënësve dhe nxënësve. Drejtësia sociale u krijon kështu mundësi të barabarta bashkëmoshatarëve në shanset për arsimimin e tyre dhe të ardhmen dhe krijon kudo mundësi të njëjta aksesit për të kaluar nga një shkollë e nivelit më të ulët drejt asaj të një niveli më të lartë. Integrimi dhe nxitja më e fuqishme individuale nuk qëndrojnë kundër njëra-tjetrës, por kushtëzojnë njëra-tjetrën. Kështu shkollat e përgjithshme të distrikteve të qytetit (Modeli i Partisë Socialdemokrate Gjermane në NRW) parashikojnë që pas një vazhdimi të përbashkët të mësimi në klasat e pesta dhe të gjashta të kenë mundësinë e zgjedhjes midis një mësimi tjetër integrativ deri në klasën e dhjetë dhe një ndarje degësh në shkollën bazë, shkollën reale dhe në gjimnaz – por të dyja variantet zhvillohen nën çatinë e një shkolle me kolegji. Edhe në lokalitete të ndryshme mund të kishte shumë ndryshime: Kështu shkolla e përgjithshme e distrikteve të qytetit mund të jepte për herë të parë një ofertë për gjimnaz dhe shkollë reale në distriktin e lartpërmendur Herringen, ku mbizotërojnë familjet e punëtorëve. Tre distrikte të tjera të qytetit mund të pajiseshin për herë të parë me një ofertë gjimnazi. Në përgjithësi, duke pasur parasysh zhvillimin demografik, në asnjë distrikt qytetas nuk mund të mbahet kurrsesi oferta ekzistuese pa një ofertë të përbashkët shkollimi.

Solidariteti përtej fjalëve boshe – buxheti përkrahës social

Një element i tretë, shtyllë e propozimeve të politikës shkollore është buxheti përkrahës social. Këtu duhet mbajtur parasysh fakti që nevojat dhe premiset e stimulimit janë të ndryshme në shkolla të ndryshme. Atje ku përqindja e nxënësve dhe nxënësve me sfond migracioni është më e madhe dhe situata problematike sociale më e fuqishme edhe në

jetën e përditshme shkollore, aty buxheti i shkollës, përgjithësisht, shkon për mbarrëvajtjen e rregullt të shkollës, për shembull, për libra mësimor, pjesëmarrje në udhëtime klasash, për kujdesin dhe ushqimin e drekës, ndërsa në shkolla të tjera ai mund të shkojë për rritjen e vlerave cilësore të mësimi dhe kujdesit për të gjithë ditën, për projekte dhe pajisje. Rezultat absurd: Atje ku nevojat e stimulimit janë më të larta, atje mundësitë reale janë më të pakta. Buxheti përkrahës social në mënyrë krahasuese mund të funksiononte pa burokraci. Për çdo nxënës që meriton përkrahje, çdo shkollë merr një buxhet shtesë, i cili në shifra të përgjithshme rritet me 10 % për rastet e vështira. Në këtë mënyrë ajo financon nevojat e veçanta dhe ka gjithashtu mundësinë të përdorë buxhetin e shkollës së vet në mënyrë të pavarur, ashtu si edhe shkollat e tjera. Ky konceptim devijon në mënyrë elementare nga buxhetimi i shkollave për frymë, i përdorur deri tani. Këtu kërkohet solidariteti i shkollave financiarisht të fuqishme ndaj shkollave financiarisht më të dobëta, për të krijuar mundësi stimulimi dhe për të mundësuar suksesin e arsimimit kudo në qytet dhe në masë të njëjtë.

► Në dialog

Pas zhvillimit të përbashkët të projektit nga njësi rajonale administrative dhe grupi i këshilltarëve ky projekt do të prezantohet dhe konsultohet bashkërisht në shtatë takime të distrikteve të qytetit me prindër, mësues, nxënës dhe nxënës, si edhe me qytetare dhe qytetarë të interesuar. Në epiqendër qëndron çështja e zbatimit në praktikë e këtyre përfytyrimeve në secilin nga distrikte të qytetit.

2.5.2. Shëndeti¹²

Sigurimi i qytetarëve vs. kuota e përgjithshme për frymë – një çështje e politikës së drejtë të shëndetit

Nga Martin Timpe dhe Christina Rentzsch

Tashmë shihet si një nga arritjet e mëdha sociale të shekullit të 20-të që kujdesi shëndetësor, parimisht, nuk është më një çështje e të ardhurave apo e shtresës sociale. Shëndeti është themeli për një jetë të denjë njerëzore dhe duhet të bëhet i mundur për të gjithë qytetarët në masë të njëjtë. Një pretendim që vjen direkt nga vlerat bazë të demokracisë sociale.

12. Krahazo mbi temën e shëndetit gjithashtu: Udhërrëfyes 3: Shteti social dhe demokracia sociale (2009), kapitulli 7.4 Shëndeti

Në Gjermani, vitet e fundit, problemi i financimit të shëndetësisë është në qendër të debatit publik. Veçanërisht për sa u përket të ardhurave, këtu janë vendosur përballë dy oferta politike shumë të ndryshme: modeli i “kuotës së përgjithshme për frymë”, përfaqësuar nga CDU-ja dhe ideja e “sigurimit të qytetarëve”, përfaqësuar nga SPD-ja.

Si duhen vlerësuar dy modelet “sigurimi i qytetarëve” dhe “kuota për frymë” në këndvështrimin e vlerave bazë të demokracisë sociale? Për të sqaruar këtë, fillimisht u duhet hedhur një vështrim më i hollësishëm të dy modeleve dhe veçorive të sigurimeve shëndetësore private (SSHP).

► Sigurimi i qytetarëve

Partia Socialdemokrate e Gjermanisë kërkon zhvillimin e mëtejshëm të instituteve të sigurimit shëndetësor shtetëror (SSSH) drejt një sigurimi të qytetarëve, për të cilin në perspektivë lipset të paguajnë të gjithë qytetarët dhe qytetarët sipas aftësisë së tyre financiare. Për llogaritjen e kontributeve nuk duhen parë më të ardhurat nga punësimi, pra në radhë të parë nga rrogat dhe pagat. Edhe llojet e tjera të të ardhurave, si të ardhurat e kapitalit, duhet të merren parasysh. Në një sigurim të qytetarëve SSSH përveç kontributeve të të siguruarve, në të ardhmen lipset të financohet edhe nga kontributet e punëdhënësve. Partneret dhe partnerët në çift pa të ardhura vetjake duhet të vazhdojnë të jenë të siguruar, për fëmijët sigurimi të jetë i çliruar nga kontributet.

► Kuota e përgjithshme për frymë

Modeli i cilësuar nga vetë CDU-ja si “kuota e shëndetit” parashikon një kuotë të përgjithshme unike mujore për të gjithë personat ligjërisht të siguruar. Të gjithë punëmarrësit, pavarësisht nga të ardhurat, duhet të paguajnë të njëjtin kontribut. Këtij i shtohet edhe kontributi i punëdhënësve, i cili, natyrisht, duhet fiksuar në 6,5 % të të ardhurave të detyrueshme për kontribute. Punëdhënësit do të ishin të përjashtuar kështu nga rritja e kostos në të ardhmen. Për ata që “kuota e shëndetit” i kalon 7% të të ardhurave bruto, duhet të ketë një kompensim. Kontributet e fëmijëve të personave ligjërisht të siguruar në rast sëmundje, në këtë model, duhet të financohen nga taksat.

► E ardhmja e sigurimit shëndetësor privat (SSHP)

Një karakteristikë qendrore e sistemit të sigurimeve shëndetësore gjermane është se një pjesë e qytetarëve dhe qytetarëve nuk do të marrin pjesë në financimin solidar. Nëpunëset dhe nëpunësit e lartë, në bazë të

sistemit të mbështetjes nëpërmjet financimit nga taksat, janë të përjashtuar që në fillim, të vetëpunësuarit, pavarësisht nga të ardhurat e tyre, nuk janë të detyruar të sigurohen me sigurim shtetëror.

Të punësuarit prej personave, institucioneve apo kompanive, duke nisur nga një vlerë e caktuar e të ardhurave (kufiri i detyrimit për sigurim), mund të vendosin vetë për sigurimin shëndetësor privat. E gjithë kjo çon në atë që kontributet e grupeve të tëra të popullsisë nuk janë në dispozicion për financimin solidar të kujdesit mjekësor. Sipas perspektivës dhe vlerësimit politik ky mund të shihet si problem, por edhe si një shprehje pozitive e konkurrencës në shëndetësi.

SSHP mund të prekej në mënyra të ndryshme nga implementimi i sigurimit të qytetarëve apo i pagesës për frymë. Ndërsa qëllimi i sigurimit të qytetarëve është përfshirja e SSHP-së në financimin solidar, nga kuota e përgjithshme për frymë nuk do të prekeshin privilegjet e SSHP-së. Madje çlirim i personave të siguruar privatisht nga pagesa e kontributeve për fëmijët do të bënte që kontributet për këta të fundit të financoheshin nga taksat.

► **Financimi solidar nga kontributet – pjesëmarrje e drejtë sipas aftësisë paguese**

Që solidariteti është një vlerë shtesë si karakteristikë kryesore e sigurimit të qytetarëve, kjo është e qartë: Të gjithë qytetaret dhe qytetarët marrin pjesë sipas aftësisë paguese në një sistem të përbashkët sigurimesh për financimin e shëndetësisë.

Edhe CDU-ja pretendon se modeli i saj është solidar. Ajo mund të tregojë se modeli i saj parashikon një “balancim taksimi”. Natyrisht ky është problematik në nivel të dyfishtë.

Nga njëra anë është e paqartë se sa lartë do të shkojë, në fakt, ky balancim taksimi, në qoftë se Unioni(CDU) dhe FDP-ja do ta dobësojnë më tej aftësinë vepruese shtetërore nëpërmjet uljes së taksave për ata që fitojnë më mirë.

Nga ana tjetër mundësia e një balancimi solidar mbi sistemin e taksimit parashikon gjithashtu edhe një sistem taksimi të organizuar në mënyrë solidarë. Planet e CDU-së dhe FDP-së janë kundër kësaj. Marrëveshja e koalicionit parashikon të heqë parimin, që shpatullat e forta të mbajnë më shumë se ato të dobëtat, sikurse është sanksionuar në progresionin e taksave.

Përveç kësaj nuk është solidare, që në modelin e pagesës së një kuote të përgjithshme për frymë nëpunëset dhe nëpunësit e lartë edhe në të ardhmen mbeten të përjashtuar dhe SSHP (të paktën formalisht) mbetet ashtu siç ka qenë në strukturat e tij të vjetra të konkurrencës.

Implementimi i sigurimit të qytetarëve natyrisht nuk do të thotë kurrsesi se do të ketë më pak liri zgjedhje. Vetëm se në këtë mënyrë do t'i jepet fund vetëm vendosjes pranë e pranë të koncepteve të ndryshme të përlogaritjes për secilin person të siguruar. Në vend të kësaj do të krijohen "kushte të ndershme të konkurrencës" nëpërmjet paracaktimeve të detyrueshme për kushte të unifikuara të sistemit.

Të siguruarit duhet të hyjnë në një konkurrencë për struktura të mira kujdesi, në vend të konkurrencës për "risk të mirë" (të siguruarit më të rinj në moshë dhe më të shëndetshëm). Në vend të lirisë së një grupi të vogël të të privilegjuarve për t'u përmirësuar në kurriz të shpenzimeve të komunitetit solidar, duhen krijuar shanse më të mëdha për të gjithë, që të marrin pjesë në përparimin mjekësor.

Një pyetje e drejtësisë është se cilat grupe të popullsisë do të ngarkohen apo çlirohen financiarisht. Edhe në këtë pikë të dy modelet ndryshojnë shumë: Ndërsa me modelin e sigurimit të qytetarëve do të çlirohen familjet me dy fëmijë, i njëjti grup, me futjen e kuotës totale për frymë, duhet të llogarisë humbje deri në 900 Euro çdo vit. Pikërisht e kundërta mund të shihet në situatën e atyre që jetojnë vetëm: Lehtësimi nëpërmjet një kuote totale për frymë mund të arrijë në vlerën e më tepër se 1300 Euro në vit, ndërkohë që personat që jetojnë vetëm do të çlirohen financiarisht edhe nëpërmjet sigurimit qytetar – edhe pse vetëm në masë të vogël.

Sikurse është shkruar më lart: shëndeti është baza për një jetë njerëzore dinjitoze dhe të gjithë qytetarët duhet të kenë akses të njëjtë në shëndetësi. Një sistem shëndetësor duhet të jetë i orientuar, përveç aftësisë së tij në ofrimin e shërbimeve, në radhë të parë drejt shanseve të barabarta (në aksesin tek shërbimet shëndetësore) dhe drejtësisë ndaj nevojave.

2.5.3. Politika e tregut të punës¹³

Pasiguri e vazhdueshme? Bota e re e punës dhe vlerat e demokracisë sociale

Nga Matthias Neis

Disa dekada pas fundit të Luftës së Dytë Botërore u duk sikur u arrit një kompromis i gjerë midis interesave të kapitalit dhe punës. Në një fazë jashtëzakonisht të gjatë të rritjes ekonomike mbas 1949-ës puna me rrogë u bë diçka normale. Nëpërmjet punës me rrogë u arritën njëkohësisht të drejtat e pjesëmarrjes në „pronën sociale“, në kërkesat e garantuara për pension, mbrojtjen nga pushimi nga puna dhe mbrojtja në punë, të drejtat për pjesëmarrje në vendimmarrje si edhe normat tarifore të detyrueshme (Dörre 2005).

Një punë e tillë me pagë – e siguruar nga shteti social – pra e ashtuquajtura marrëdhënie normale e punës(MNP)¹⁴ përveç sigurisë materiale solli edhe një masë minimale njohjeje në shoqëri. Kjo fazë, e cila në retrospektivë duket si harmonike, natyrisht që nuk ishte pa konflikte. Kompromisi u arrit vazhdimisht me luftë dhe „plagë të rënda“ dhe shpërndarja e pabarabartë e pasurisë shoqërore në rastin më të mirë zvogëlohej gradualisht. Pjesë të gjëra të popullsisë në përgjithësi kishin sigurinë se nëpërmjet punës së tyre dalëngadalë, e megjithatë në vazhdimësi, mund të përmirësonin standardin e tyre të jetesës.

Por duke filluar nga vitet 1980-të,MNP po e humbiste vazhdimisht forcën e saj rrezatuese. Vërtet që shumica e të punësuarve akoma vazhdojnë të punojnë në punë fikse, por numri i tyre ulej me shpejtësi. Rritja e punësimit mund të gjendet vetëm në fusha të tjera: në punën me orar të shkurtuar, punën e marrë me qira, në punësimin me afat të caktuar apo me pagesë të ulët¹⁵. Si punësimi për një kohë të gjatë dhe me orar të plotë edhe „prona sociale“ gjithashtu u vunë nën presion. Privatizimi i pjesshëm i kujdesit për të moshuarit, shtytjet për dobësimin e mbrojtjes nga pushimet nga puna dhe obligimi në rënie për lidhjen e kontratave të punës,veçanërisht në Gjermaninë Lindore, janë vetëm aspektet më të dukshme të këtij procesi.

Mund të përmenden disa shkaqe për këtë zhvillim. Për shembull, rritja e

13. Krahason për temën Politika e tregut të punës: Udhërrëfyes 3:Shteti social dhe demokracia sociale (2009), kapitulli 7.2. Puna.

14. E quajtur ndryshe dhe „punë fikse“ [shënim i përkthyesit]

15. Midis 1991 dhe 2003 numri i të punësuarve me kohë të pjesshme, për shembull, është rritur nga rreth pesë milionë në mbi nëntë milionë.

rëndësisë së punës në sektorin e shërbimeve dhe informacionit kërkon një organizim tjetër, më fleksibël të punës se mënyra e prodhimit e ditëve të shkuara. Në kushtet e konkurrencës, e cila tashmë nuk zhvillohet më vetëm midis sipërmarrjeve, por brenda sipërmarrjes, midis ekipeve dhe reparteve, „prona sociale“ po kthehet shpejt në një lloj „rezerve fleksibilizimi“. Sipërmarrjet që ia arrijnë t’i zhvidhosin të drejtat e mbrojtjes apo edhe t’i shpërbëjnë fare ato, arrijnë një avantazh konkurrence, edhe pse ai mund të jetë afatshkurtër.

Shumica e njerëzve reagojnë shumë të shqetësuar ndaj këtij zhvillimi. Në një studim të Fondacionit “Friedrich Ebert” në vitin 2007 63% e të pyeturve pranojnë se kanë frikë nga ndryshimet shoqërore (Neugebauer 2007). Këtë gjendje të një pasigurie të përgjithshme në pjesë të gjera të shoqërisë të shkaktuar nga ndryshimet në ekonomi dhe botën e punës, sociologu francez Pierre Bourdieu e ka përshkruar me nocionin „prekaritet“. Këtu nuk kemi të bëjmë vetëm me uljen e pagave apo me kontrata pune me afat të caktuar. E rëndësishme është gjithashtu se sa pasiguri përjetohej e përpunohet. Duke marrë parasysh këtë, duket se prekariteti (paqëndrueshmëria) nuk është vetëm aty ku janë të prekurit nga paqëndrueshmëria. Kjo paqëndrueshmëri delikate vepron deri në qendër të shoqërisë së punës. Shumë të punësuar afatgjatë i ndjejnë e shohin punëtorët dhe punëtorët e marrë me qira në ndërmarrjen e tyre si një pasiguri masive. Të frikësuar nga një alternativë e tillë që shfaqet para syve të tyre, i bën ata të gatshëm për lëshime në pagë dhe kushtet e punës, lëshime që në kushte të tjera nuk do t’i kishin pranuar. Midis punëtorëve dhe punëtorëve me kontratë fikse dhe atyre të varur plotësisht nga puna për bukën e gojës, vetë të punësuarit në kushtet e situatës së paqëndrueshme ndodhen në një gjendje pezull jo stabile. Frika e tyre është se mos rrëshqasin poshtë, kurse ëndrra e tyre është të punojnë në zonën e MNP-së. Por realiteti u ofron shpesh vetëm perspektivën e konfrontimit të vazhdueshëm me pasigurinë.

Çfarë ndikimesh ka ky zhvillim mbi projektin e një demokracie sociale? Rëndësia e punës fikse për demokracinë sociale, në të kaluarën, nuk është vlerësuar aspak mjaftueshëm. Gjatë formimit të shtratit të saj socialdemokrat, për një kohë të gjatë, ajo ishte një nga faktorët kryesorë për formësimin e tri vlerave bazë. Ajo krijoi siguri për shumë (jo për të gjithë) dhe bashkë me këtë edhe një parakusht të domosdoshëm për vlefshmërinë e lirive pozitive. Se çfarë u bë vërtet (për vlerën e drejtësisë) me rishpërndarjen relevante, kjo në esencë u organizua nëpërmjet sistemit të punësimit. Në fund „prona sociale“ ishte orientuar drejt amortizimit solidar të rreziqeve të jetës. Siguria

sociale, e krijuar me punë fikse, stimuloi identifikimin e pjesëve të gjera të popullsisë me tri vlerat bazë të demokracisë sociale. Veçanërisht SPD-ja, në programin e saj parimor, u është referuar shumë fort MNP-së dhe para së gjithash punësimit me kohë të plotë. Zgjerimi i punës fikse për të gjithë të aftët për punë ishte diçka e vetëkuptueshme për këtë parti si bartëse politike e demokracisë sociale.

Por me MNP-në u zgjidh edhe kjo lidhje e fortë. Reformat e politikës së tregut të punës dhe ato sociale, në dekadën e fundit, deri diku normalizimi i punës me qira dhe reforma e sigurimit të të papunëve, nën (bashkë)përgjegjësinë e SPD-së, ishin gjithashtu një përpjekje për t’u përgjigjur ndaj një ndryshimi radikal të shoqërisë së punës me anë të ndryshimit gjithashtu radikal të kursit. Vlerat e demokracisë sociale vazhdojnë të gjejnë akoma aprovim të fuqishëm në gjirin e popullatës. Por ato nuk janë më të lidhura në mënyrë të vetëkuptueshme me një bartës politik. Shkaku esencial për këtë qëndron në detyrën politike deri më tani të papërmbushur për të krijuar sërish sigurinë sociale nën simbolin e fleksibilizimit. Çfarë do të thotë kjo për një ideal të ri të demokracisë sociale në lidhje me vlerat themelore që bart?

► Liria

Bota e re e punës përmban gjithsesi premtime të reja për lirinë. Një grup i vogël, por jo për t’u lënë në harresë, i punonjësve në profesion të lirë apo që punojnë si “vetëmanaxhues”, mund të përfitojnë liri krijuese nga puna e tyre me projekte, e pavarur nga udhëzimet e ndryshme. Ata mund të kërkojnë një shpërblim të mirë për fleksibilitetin e tyre. Me resurse të mjaftueshme mund ta kthejnë papunësinë afatshkurtër në një rast të mirë për kualifikim të mëtejshëm. Për shumicën e të punësuarve me punë të paqëndrueshme pa mirëqenie materiale e njëjta situatë do të thotë një krizë e thellë, e cila shkurton masivisht të drejtat e lirisë si ato pozitive ashtu edhe ato negative.

E rëndësishme për demokracinë sociale është të zhvillohet një premtim pozitiv, realist dhe social i lirisë. Potenciali respektiv i lirisë së fleksibilizimit për shumicën dërrmuese të popullsisë aktive për punë do të realizohet vetëm atëherë, kur përballimi i risqeve dhe krizave të pashmangshme nuk do të bjerë vetëm në shpatullat e tyre.

► Drejtësia

Se çfarë është e drejtë, kush ka pretendimin legjitim për të, kjo është përcaktuar dhe përcaktohet në mënyrë vendimtare nga puna e paguar. Për një kohë të gjatë, nga gatishmëria për punë, është arritur pretendimi

për të qenë pjesëmarrës, e kjo është e dokumentuar nga puna. Qysh atëherë një gjë e tillë ishte një përfytyrim i drejtësisë që kishte vendosur kufij të ashpër, për shembull, midis sekseve dhe bartte tendencat e individualizimit të përgjegjëse.

Këto norma tregohen si shumë stabël, po zhvillohen në një shoqëri të re të punës drejt një tendence të dukshme të pabarazisë, ku ideja e rendimentit ndikon më tej, por që mundësia e aksesit drejt punës me shpërblim bëhet gjithnjë e më e komplikuar. Që të dalësh për një farë kohe, madje në mënyrë të përsëritur, nga sistemi i punësimit të qëndrueshëm, sot është një përvojë normale. Por kjo nuk do të thotë kurrësi se kjo mund të ishte edhe legjitime. Edhe shumë persona të prekur nga ky fenomen kanë pretendimin e tyre që gatishmëria e tyre për punë të dokumentohet. Në qoftë se kjo nuk arrihet, atëherë fundi është afër, prandaj edhe njerëzit thjesht duhet të përpiqen më shumë. Ky individualizim mbulon perceptimin e shpërndarjes së pabarabartë në shoqëri, e cila është në rritje. Kështu, pikërisht nga ky kuptim i drejtësisë mund të krijohet një nocion i kundërt ndaj barazisë.

Një kërkesë ndaj projektit të demokracisë sociale duhet të jetë që drejtësia dhe barazia t'i referohen në mënyrë pozitive njëra -tjetrës. Politikisht kjo do të thotë që të lejojmë të rritet presioni individual deri në atë masë sa çdo personi, burrë apo grua, t'i vihet në dispozicion mundësi faktike për t'u marrë me punë. Vetëm mbi këtë bazë ka kuptim të kërkojmë më tepër përgjegjësi nga vetja.

➤ Solidariteti

Ristrukturimi i sistemit të sigurimeve kolektive, i shprehjes institucionale të solidaritetit në sistemin e vjetër të punësimit mund të kuptohet si element i një krize të përgjithshme të veprimit solidar. Në situatën aktuale filli qendror i debateve shoqërore midis „lartë” dhe „poshtë”, për çka kanë luftuar edhe këto sisteme, po mbivendoset nga ndarja e atyre „brenda” dhe „jashtë”. Të dy dallimet nuk përjashtojnë njëri-tjetrin, por çojnë në debate shoqërore krejt të ndryshme.

Situatat e konkurrencës në sipërmarrje, të kombinuara me ndjenjën se i punësuari mund të zëvendësohet në çdo kohë nga një tjetër prapa derës, ofrojnë një rrugicë të keqe për veprimin solidar. Ata që janë „brenda” i perceptojnë ata që janë „jashtë” si një kërcënim në rritje. Nga ana tjetër, elementët ende të shëndoshë të sigurisë kolektive tek

personat në situatë të pasigurt dhe ata pa punë, shpesh krijojnë ndjesinë sikur janë bërë pengesë që duhet të mbeten akoma „jashtë“. Që ky perceptim nuk është pa bazë, kjo duket më se qartë në krizën aktuale. Pas prishjes së kontratave në pjesë të tëra të industrisë në dimrin e vitit 2008 ishin punëtorët me qira që pothuajse menjëherë u desh të lironin vendet e punës. Pothuajse brenda ditës u larguan qindra mijëra prej tyre nga fabrikat. Protesta nga ana e kolektiveve, por edhe nga sindikatat pati vetëm në raste shumë sporadike dhe të veçuara, por ato siguruan nëpërmjet këtyre pushimeve nga puna vendet e punës të kolektivave bazë dhe të masës së anëtarëve të sindikatave të tyre.

Zhvillimi aktual na lejon të bëjmë pyetjen se si duhet ta përfytyrojmë solidaritetin në botën e punës. Edhe nga pikëpamja e një solidariteti që duhet menduar rishtas, instrumentet vepruese të sigurisë sociale bëhen pikë esenciale referimi për një demokraci sociale të ardhshme. Ajo duhet ta bëjë përsëri të besueshme „pronën sociale“. Për këtë instrumentet duhet të interpretohen për më tepër në sajë të biografive të ndërprera të punësimit, sot tipike, për të ç'tensionuar kontradiktën midis atyre „brenda“ dhe atyre „jashtë“.

Në shoqërinë e sotme të punës vlerat bazë të demokracisë sociale pjesërisht nuk lidhen më në mënyrë të vetëkuptueshme me punën, si më parë, pjesërisht kjo lidhje mbahet akoma „tepër mirë“, sa që urgjenca e një debati të ri mbi përmbajtjen e tre koncepteve të lartpërmendura bëhet e dukshme.

Për të përcaktuar qartë lidhjen e lirisë, drejtësisë dhe solidaritetit me shoqërinë e re të punës, duhet të kemi një projekt kryesor për bartësit politikë të mendimit të demokracisë sociale. Asgjë nuk tregon se puna e paguar në të ardhmen do të humbasë vlerën e saj si motor i rëndësishëm i pjesëmarrjes dhe njohjes. Fytyra e demokracisë sociale do të vazhdojë të karakterizohet edhe më tej në mënyrë tepër esenciale nga fakti, se si do të punohet në shoqëri. Duke mbajtur parasysh përvojën e krizës në fund të kësaj dekade, kjo do të thotë më tepër se kurrë se në një demokraci sociale edhe ekonomia dhe puna duhen shpalosur e zhvilluar sipas parimeve demokratike.

2.5.4. Politika e arsimit të lartë

„Privati para shtetit“ apo pasuri publike? Dy modele të kundërta të financimit të studimeve

Nga Martin Timpe dhe Frederike Boll

► **Prejardhja sociale vendos mbi shanset e arsimimit**

Në asnjë vend tjetër industrial, i cili është anëtar i Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), prejardhja sociale nuk vendos kaq fort mbi rrugën e arsimimit sa në Gjermani. Nga 100 fëmijë nga familje akademikësh (d.m.th. të paktën njëri nga prindërit ka mbaruar shkollën e lartë) 83 nisin studimet. Ndërsa në familjet jo akademike (pra që nuk kanë studiuar në shkollat e larta apo universitete) janë vetëm 23 për 100 fëmijë, të cilët gjejnë rrugën drejt një universiteti ose shkolle të lartë profesionale (Krahaso: Isserstedt 2007: 11)

Përveç kësaj Republika Federale, në krahasim me shtetet e OECD, ka një kuotë shumë të ulët të atyre që studiojnë. Në vitin studimor 2009 – para së gjithash edhe për shkak të viteve dopio të maturës – kjo shifër ishte rreth 43% e moshatarëve të këtij viti akademik. Kush dëshiron të rrisë kuotën e studentëve dhe t'i afrohet qartësisht mesatares së OECD-së prej mbi 50%, ai duhet të vërë në lëvizje mekanizmat për të studiuar në radhë të parë fëmijët që vijnë nga familjet jo akademike, sepse pikërisht aty gjendet dukshëm potenciali më i madh, i pa shfrytëzuar. Kjo nuk është vetëm ekonomikisht e arsyeshme, por edhe një çështje e drejtësisë sociale.

► **Probleme të financimit të studimeve**

Një shtysë e rëndësishme për krijimin e një barazie më të madhe në dhënien e shanseve dhe për rritjen e kuotës së studimit gjendet në fushën e financimit të studimeve. Shumë persona në moshën për të studiuar, të ardhur nga familjet jo akademike e argumentojnë vendimin e tyre kundër studimit apo pro një kualifikimi profesional me shpërblimet monetare (edhe pse të ulëta) që përftohen nga kualifikimi profesional, çka qëndron përkundër varësisë financiare prej prindërve në rastin e vazhdimit të studimeve (Krahaso: Heine/Quast 2009: 16).

► **BAföG – Ligji federal për përkrahjen e arsimit**

Por tani kemi edhe BaföG-un – kështu do të thoshin njerëzit tani. Por

përkrahjen financiarët BaföG-ut e përftojnë rreth 18%, pra vetëm një pjesë e vogël, e studentëve në shkollat e larta. (Krahaso raportin e 17-të të BaföG 2007: 8)¹⁶

Përveç kësaj kontributi që parashikon BaföG për jetesën, sistematikisht nuk mban të njëjtin hap me shpenzimet faktike të jetesës, pasi këtu nuk është parashikuar një përshtatje automatike në ligj.

Ndikim trembës te shumë studentë potencialë ka edhe ajo që lidhet me 50% të pjesës së huasë së BaföG-ut. Në familjet jo akademike gatishmëria për të marrë borxhe është qartësisht më e vogël se në familjet akademike. Një rrethanë kjo që flet gjithashtu kundër propozimeve për financimin e shpenzimeve të jetesës dhe tarifave studimore nëpërmjet kredive.

Dhe në fund vlen të përmendet që kufijtë e të ardhurave në ligjin BaföG janë vendosur aq poshtë sa që shumë familje që nuk mund ta përballojnë dot financimin e studimeve të fëmijëve të tyre, prapëseprapë nuk përfitojnë asgjë nga BaföG. Një situatë që cilësohet si vrimë e shtresës së mesme.

► Tarifate studimit

Përveç kësaj, aktualisht gjashtë Landeve federale u shtohen tarifa për studim deri në 500 Euro për semestër. Pasi Gjykata Kushtetuese Federale në vitin 2005 kishte vendosur që vendimmarrja mbi lirinë e taksimit për studimin në shkollat e larta është çështje që e vendosin vetë landet federale, pikërisht nga ky moment shtatë qeveri landesh që drejtoheshin nga Unioni Kristian Demokrat futën taksimin e përgjithshëm për studime. Në Hessen kjo taksë ndërkohë është hequr përsëri nga shumica kuq-gjelbër-kuq në parlamentin e landit. Edhe qeveria e zezë-e verdhë-e gjelbër në Saarland ka vendosur për heqjen e taksave të studimit. Në landet federale Baden-Württemberg, Bayern, Hamburg, Niedersachsen dhe Nordrhein-Westfalen vazhdojnë të aplikohen taksat ekzistuese, nga ku janë të prekur më shumë se gjysma e rreth dy milionë studentëve në Gjermani.

Pra janë dy modele të financimit të studimeve: një model që mbështetet në forcimin e kontributeve private për financimin e studimit dhe prandaj edhe është për shembull pro taksave të studimit, dhe modeli i dytë që përkrah kërkesën për një studim pa taksa, nisur nga kuptimi i arsimimit si e drejtë njerëzore. Shkollimi në këtë vizion është një pasuri publike, e cila duhet t'u vihet në dispozicion të gjithëve në të njëjtën masë – pavarësisht nga të ardhurat, nga prejardhja apo gjendja ekonomike a sociale e tyre.

16. Këtu është dhënë përqindja e të gjithë të përkrahurve ndaj numrit të përgjithshëm të studentëve.

Financimi i studimeve dhe vlerat bazë të demokracisë sociale

► Liria

Liria, kështu argumenton demokracia sociale, ka gjithnjë edhe premisa materiale. Vetëm kush ka akses drejt arsimimit, ai mund të përdorë liritë e tij. E drejta për të studiuar në shkollën e lartë vlen pak, kur ti nuk mund të paguash dot qiranë për konviktin e studentëve. E drejta për të zgjedhur lirisht fushën e studimit mund të zhvlerësohet, kur financiarisht je i varur nga prindërit dhe për pasojë direkt apo indirekt je i detyruar t'u përshtatesh më shumë përfytyrimeve dhe koncepteve të tyre lidhur me profesionin e ardhshëm dhe fushën e duhur të studimeve, se sa të ndjekësh interesat e tua.

Një përkrahje e fuqishme nga BAFöG, që varet vetëm nga nevoja individuale e studentëve, do të ishte e aftë për ta realizuar edhe faktikisht lirinë formale (për të studiuar). Modelet e ndryshme të propozuara për kreditimin e studimit premtjnë vetëm liri në dukje. Ato krijojnë varësi të reja: në formën e borxheve dhe detyrimeve kontraktuale ndaj kredidhënësve.

► Drejtësia

Kur diskutojmë mbi taksimin e studimit dhe drejtësinë, përmendet vazhdimisht e në mënyrë të përsëritur i njëjti argument – i cili, natyrisht, nga përsëritja nuk bëhet më i drejtë. Sipas këtij argumenti nëpërmjet taksave të tij infermieri financon studimet e djalit të kryemjekut. Kryemjeku nuk jep asnjë kontribut për financimin e këtyre studimeve, por mund të paguante pa problem taksat e studimeve. Kjo situatë është thellësisht e padrejtë, prandaj familjet e pasura nëpërmjet taksave të studimit duhet të japin një kontribut direkt për financimin e shkollës së lartë.

Nëse situata do të ishte vërtet kështu siç paraqitet, atëherë në fakt ajo do të ishte situatë e padrejtë. Në të vërtetë këtu një padrejtësi po përdoret për të justifikuar të tjerat: mungesën e barazisë së shanseve në sistemin tonë të arsimit dhe shpërndarjen e pabarabartë të ngarkesës (së taksave) shoqërore.

Djali i kryemjekut me apo pa tarifat e studimit do të studiojë. Në qoftë se do të vileshte taksat e studimit, atëherë do të çimentohej pabarazia sociale për hyrjen në shkollën e lartë. Vajza e infermieres atëherë krahasuar me situatën sot do të vendoste më shumë kundër fillimit të studimeve. Por kush ankohet se kryemjeku kontribuon shumë pak për financimin e arsimit të lartë apo për detyra të tjera publike dhe se infermjerja

përkundrazi kontribuon më shumë seç duhet, ai duhet të shohë sistemin tonë të taksave, në vend që të kufizohet vetëm në aspektin e tarifave për studime. Ai do duhej të fliste në mënyrë konsekuente në favor të një ngarkese më të lartë të atyre me të ardhura të larta dhe për uljen e barrës së atyre që kanë të ardhura të ulëta dhe të mesme.

Drejhtësia do të thotë liri e njëjtë - kjo është teza e demokracisë sociale. Liria e njëjtë për marrjen e një të drejte studimi, të paktën, do të rrezikohet nga rritja e taksave të përgjithshme për të studiuar. Njëkohësisht edhe argumentimi i përshkruar më sipër nuk është bindës. Për më tepër duhej realizuar një pjesëmarrje e drejtë në financimin e detyrave shtetërore, e tillë, që secili, mbi bazën e aftësisë kontribuese nëpërmjet sistemit të taksave, të japë kontributin e tij të përshtatshëm.

➤ Solidariteti

Së fundmi ia vlen të mendojmë për një moment mbi ndikimet e tarifave të studimit në klimën sociale dhe shoqërore. Shkollat tona të larta japin një kontribut të rëndësishëm për zhvillimin demokratik dhe shoqëror. A nuk do të ishte me shumë kuptim që studentët dhe shkollarët të mësojnë të jetojnë në një bashkëveprim solidar dhe demokratik? Tarifat për studime dhe instrumente të tjerë të politikës së shkollave të larta, ndryshe nga sa më sipër, të çojnë në një dominancë të marrëdhënieve të tregut, klientëve dhe konkurrencës.

Tarifat për studime, përveç kësaj çojnë në thellimin gjithnjë e më të madh të hendekut midis të ardhurave të akademikëve dhe të ardhurave të jo akademikëve. Nëse ky zhvillim i bën mirë një shoqërie, ku të varfër dhe të pasur largohen gjithnjë e më shumë nga njëri-tjetri, gjykimin për këtë po ua lëmë juve.

3. MODELET SHOQËRORE PËR KRAHASIM

Në këtë kapitull

- Do të diskutohet raporti i kapitalizmit të tregut dhe demokracisë;
- Do të përpunohen dhe krahasohen me njëri-tjetrin modeli shoqëror liberal, konservativ dhe ai i demokracisë sociale;
- Do të skicohen zhvillimi dhe historia e ideve të lëvizjes punëtore në vija të trasha dhe do shpjegohet koncepti i socializmit demokratik;
- Do të trajtohet çështja e portretit njerëzor të demokracisë sociale në dallim me portrete tjera njerëzore.



Spiegel: Nr. 43/2007, burimi: www.spiegel-online.de, 22.10.2007

Në karikaturë janë paraqitur disa persona të udhëheqjes së SPD-së, të cilët duken që kanë rënë në gjendje të vështirë në det dhe janë shpëtuar nga një varkë shpëtimi – kapiteni Gerhard Schröder mbetet në varkën që po zhytet, Gregor Gysi dhe Oskar Lafontaine kanë marrë një varkë të tyren. Titulli „Kur notojmë krah për krah” luan me fjalën „notoj” – në këtë rast është një sinonim për „nuk dimë”, pra „nuk dimë” ku duhet të shkojmë. Akoma më e tmerrshme: Figura paraqet një shkatërrim dramatik të anijes, ku orientimi është hedhur në det të hapur.

*Çfarë paraqitet
në kopertinë?*

*Atë çka
kopertina
nuk e tregon –
disa komente
për t'u
interpretuar*

Çfarë mendoni për këtë kopertinë të “Spiegel”-it? Çfarë thotë ajo për mënyrën e të kuptuarit të një partie (në këtë rast të SPD-së)?

Interesant – përtej vlerësimit individual – është fakti se revista “Spiegel” përdor bukur një metaforë: Ajo aludon me frikën dhe përshtypjen, se në politikë mungon një orientim themelor – e kështu alarmi detar është i paraprogramuar. Ky pretendim që e hasim jo rrallë, njësoj si i gjithë arranzhimi, natyrisht është sensacional, pasi secili dhe secila ka “busullën e vetë politiko-shoqërore” dhe se në partitë demokratike (cilatdo qofshin ato), jo vetëm është e lejuar, por edhe e domosdoshme të debatohet për koordinimin dhe pastaj të merren vendime në mënyrë demokratike.

Këtu me siguri nuk flitet për një “mbytje” apo çarje të anijes së SPD-së: një përmbysje politike - sikurse është jo vetëm e zakonshme, por edhe e domosdoshme pas një ndërrimi të udhëheqjes dhe pas zgjedhjeve të humbura për në Bundestag – nuk është aspak çarje anije.

*Një debat
për koordinimin
është
i domosdoshëm*

Edhe një „vargur dhrash” bie ndesh me gjetjen demokratike të vendimmarrjes në një parti. Pasi këtu bëhet fjalë pikërisht për atë që, në rast nevojë duhet të debatohet për koordinimin dhe të bëhet krahasimi më pas me „busullën e vetë politiko-shoqërore”. Ndërsa fotoja e kopertinës na prezanton një mënyrë autoritare të të kuptuarit të politikës, e cila nuk përputhet me pretendimet e një demokracie.

*„Busulla
politiko-
shoqërore”*

„Busulla politiko-shoqërore” është ajo që nuk duket në foto – por ajo është premisa për të caktuar kursin politik. Le të qëndrojmë për një moment te „navigimi”.

Një „busull politiko-shoqërore” presupozon se kemi një përfytyrim të drejtimeve politike, me anë të të cilave përshkruajmë pozicionin tonë dhe në bazë të të cilave mund „të navigojmë”.

*Çështja e
koordinimit
dhe navigimit*

Ky „navigim” bëhet – e thënë në mënyrë të figurshme – jo rrallë në detin plot tallaz të vendimeve politike të përditshme: edhe kur nuk bëhet fjalë për asnjë vendimarrje parimore, përsëri në gjetjen e rrugëve të vendimmarrjes sillen bindjet personale bazë.

Avantazhi (dhe njëkohësisht vështirësia për përshkrimin) është se secili nga ne ka busullën e vetë. Kështu që këtu nuk bëhet fjalë

për të shpërndarë “një set busullash”. Për më tepër këtu thjesht mund të diskutohet bashkërisht për koordinatat. Se në çfarë mënyre mund të përdoret kjo pastaj për „navigimin” e secilit, kjo mbetet në dorën e secilit nga ne: Në partitë demokratike kjo është një çështje e bisedimeve dhe e kompromiseve.

Për navigim nevojiten dy premisa esenciale: Duhet të njohësh vendndodhjen tënde – pra, në kuptimtë figurshëm, duhet analizuar se ku gjendesh vetë dhe në çfarë situatë gjendet aktualisht shoqëria.

Premisa e dytë është e lidhur me nevojën për t’u bashkuar me një “kurs politik” që do të ndjekësh.

Të dyja – pika e startit dhe qëllimi (ose realiteti dhe pretendimi) – mbulohen nga pikëpamjet dhe përfytyrimet konkurruese politiko-shoqërore. Si argumentimet liberale, konservative, socialiste, ashtu edhe ato socialdemokrate përpiqen për të përcaktuar pikën e shartimit dhe qëllimin në mënyrë të tillë që “navigimi” të bëhet i mundur në drejtimin e tij.

Kur flasim për demokracinë sociale si një model shoqërie, si një sistem i mundur koordinimi, si një drejtim shoqëror, atëherë ajo duhet parë në kontekstin e modeleve të tjera të shoqërisë.

*Çfarë na duhet
për navigim?*

3.1. Kapitalizmi i tregut dhe demokracia

*Dy koncepte
paraprakisht:
“kapitalizmi
i tregut” dhe
“demokracia”*

Përpara se t’u hedhim një vështrim koordinatave të ndryshme, na nevojiten akoma edhe dy shpjegime për konceptet që karakterizojnë esencialisht pikëpamjen tonë për shoqërinë sot: kapitalizmi i tregut dhe demokracia.

Kapitalizmi i tregut kuptohet këtu si një sistem, ku

- mallrat në një treg mund të shkëmbehen lirisht;
- prodhimi i mallrave mbështetet në një sistem kapitalist, pra para së gjithash, bazohet në pushtetin disponues të ekonomisë private mbi mjetet e prodhimit;
- ka punë me rrogë nga njëra anë, dhe pronarë të kapitalit, nga ana tjetër;
- nuk ka asnjë institucion rregullues jashtë tregut, e shumta ka ndonjë institucion që krijon një kuadër të përgjithshëm.

Demokracia karakterizohet si arritje historike, e cila

- dëshiron të realizojë në shtet idenë e lirisë së barabartë për të gjithë njerëzit e një shoqërie;
- sjell autonominë politike nëpërmjet vendimmarrjes demokratike të shumicës;
- për realizimin e shanseve të barabarta ka nevojë për një shoqëri (shtet) të fuqishme kushtetuese.

*Kontradikta të
demokracisë
dhe kapitalizmit
të tregut*

Këto përkufizime minimale tregojnë tashmë se një shoqëri, e cila dëshiron të jetë e organizuar jo vetëm në aspektin kapitalist të tregut, por edhe në mënyrë demokratike, duhet të shmangë tensionet, pasi ndikimet e një kapitalizmi të pastër të tregut, ashtu sikurse edhe një shoqëri e konceptuar si demokratike e pastër, duhet të jenë në antagonizëm në konsekuencat e tyre.

Kapitalizmi i tregut i kundërvihet demokracisë, kur

- pushteti privat i disponimit të mjeteve të prodhimit nga disa çon në një shpërndarje të pabarabartë të pasurisë, e cila kundërshton “lirinë e njëjtë” të individit dhe pjesëmarrjen e të gjithëve në shoqëri;
- hendeuku i pushtetit midis punëdhënësve dhe punëmarrësve është


aq i thellë, sa kundërshton mënyrën e jetesës të përcaktuar nga vetë punëmarrësit dhe punëmarrëset në tërësinë e saj; Kapitalizmi i tregut, në përpjekjet për fitim të disave, i kundërvihet mirëqenies së përgjithshme të të gjithëve, të cilën mund ta garantonte fillimisht parimi demokratik;

- shteti ka vetëm funksionin e kujdestarit për qetësi dhe rend.

Demokracia i kundërvihet kapitalizmit të pastër të tregut, kur

- liria sipërmarrëse kufizohet esencialisht ose hiqet fare nëpërmjet vendimeve demokratike;
- ndërhyrjet shtetërore nëpërmjet vendimeve demokratike – për shembull, nëpërmjet shpronësimit të pronës private në favor të interesit të përgjithshëm – rrezikojnë shpalosjen e personalitetit dhe lirinë e individit, pra, kur kryhen ndërhyrje në sferën private të individit.

Demokracia dhe kapitalizmi i tregut paraqiten të konkretizuara në një fushë tensioni:



Fusha e tensionit midis formës ekonomike dhe formës shoqërore

Fig. 4: Sistemi i koordinatave për renditjen e modeleve shoqërore

Për formën e ekonomisë apo tregun mund të marrim polet i “koordinuar” dhe i “pakoordinuar”: pra nga njëra anë kemi një treg të pakoordinuar, ku veprimtaria i lihet në dorë vetë atij dhe nga ana tjetër, një treg i rregulluar dhe një ekonomi e koordinuar.

*Si renditen
modelet e
ndryshme
shoqërore?*

Në aksin tjetër është tensioni midis një rendi shtetëror autoritar nga njëra anë, dhe një rendi demokratik që mbështetet mbi të drejtat e lirisë për çdo person, nga ana tjetër.

Kapitalizmi i tregut dhe demokracia janë dy nocione esenciale që mund të përshkruajnë koordinatat aktuale të shoqërisë. Teoritë politike në përkufizimin e qëllimit të tyre orientohen drejt asaj, se si e interpretojnë këtë koordinim dhe në cilin drejtim do të lëvizin.

Pra këtu shtrohet pyetja, se si do të renditen përfytyrimet e ndryshme shoqërore apo modelet shoqërore në këtë sistem koordinatash:

- Pozicioni liberal
- Pozicioni konservativ
- Pozicioni socialist
- Pozicioni i demokracisë sociale

Për diskutim dhe punë plotësuese:

Renditni për veten tuaj modelet shoqërore të lartpërmendura, ashtu si do të dëshironit ju vetë. Grumbulloni arsye, por edhe kundërgjegje për renditjen tuaj. Shënoni “vendndodhjen” në sistemin e koordinatave përpara se të lexoni më tej.

Ndoshta gjatë renditjes edhe mund të jeni lëkundur disi? Apo ishit shumë shpejt të sigurt?

Në qoftë se do të jeni lëkundur, atëherë ky nuk është “gabim” nga ana juaj, por mund të ketë arsye të mira që ju të jeni të pasigurt. Do ta shohim menjëherë se këtu mund të kemi të bëjmë me një problem sistematik.

Ndoshta ju ndihmon më tej ky diferencim: Përpikuni që si hap të parë të plotësoni sistemin e koordinatave që ndoshta mund ta dispononin modelet shoqërore për vete. Mendoni në një hap të dytë se si do të dukej një “pozicionim realist” i modeleve, nisur nga kuptimi juaj politik.




Fig. 5: Pretendimi dhe pozicionimi realist

Tani vjen pyetja interesante: Në qoftë se renditjet e një „modeli shoqëror“ në „versionin e pretendimit“ dhe „versionin e realitetit“ janë kontradiktore, atëherë, pse ndodh kjo? (Për këtë, këtu do të përjashtojmë rastin e supozuar sikur perceptimi ynë nuk është në rregull.)

Më mirë mbani në mendje fillimisht të dy sistemet e koordinimit me renditjen e modeleve shoqërore, pastaj mund të provoni nëse shpjegimet pasuese do të mund t’ju ndihmojnë më tej.

Pyetjes mbi ndryshimin midis pretendimit dhe realitetit mund t’i përgjigjemi, vetëm kur nga njëra anë modelet shoqërore respektive teorikisht i kemi parë nga afër, kurse nga ana tjetër provojmë me anën e të dhënave empirike, se deri në ç’masë vendet që orientohen ose janë orientuar drejt modeleve të caktuara, vërtet i kanë përmbushur pretendimet/kërkesat e tyre. Në qoftë se midis pretendimit dhe realitetit hapet një hendek më i madh, atëherë kjo nga njëra anë mund të shpjegohet me një retorikë që të çon në qorrsohak (për shembull, për qëllime të mbajtjes së pushtetit), e cila nga ana e saj orvatet ta shesë diçka si një avantazh apo favor të përgjithshëm, i cili në të vërtetë u shërben vetëm interesave të individëve të veçantë.

Këtu duhet bërë një pyetje shumë vendimtare për të mos iu larguar çështjes: Pyetja është kjo: Cui bono? Kujt i vlen kjo? Kush ka favore nga një argumentim i tillë?

Ose mos kemi këtu një vakum teorik, ku gjetjet empirike dhe pretendimi teorik, në kushtet aktuale shoqërore, nuk përputhen.

Kur pretendimi dhe realiteti i një modeli shoqëror janë në pozicione kontradiktore, pse ndodh kjo?

Nga njëra anë: Cui bono? Kujt i vlen kjo?

*Nga ana tjetër:
Utopizmi si
diagnozë?*

Kjo do të thotë se bëhet fjalë për një model shoqëror shumë afatgjatë, të pa realizuar, pra që modeli shoqëror, i parë nga këndvështrimi i sotëm, është utopik. Kjo nuk do të thotë që pretendimi ishte për t'u kritikuar, ai duhet kritikuar atëherë, kur një utopizëm i tillë politik pengon për ta kthyer atë aktualisht në realitet. Lidhur me këtë mund të flasim për një obligim të rendit të dytë, pra, që një përfytyrim politik duhet të jetë realist, i realizueshëm edhe me mjete demokratike.

Utopizmi si luks

Utopizmi pa veprim shoqëror është thjesht luks, të cilin mund ta kenë vetëm ata që janë të siguruar në një farë mase. Nëse ekziston një utopizëm i tillë pa vullnet politik-shoqëror për ta zhvilluar, kësaj pyetjeje nuk mund t'i përgjigjemi kështu në mënyrë të përgjithshme. Vetëm duhet sqaruar, nëse strategjia politike e grupeve të veçanta politike kontrollohet në mënyrën e sjelljes konkrete të tyre.

Kaq si fillim lidhur me busullën tuaj dhe shpjegimet e mundshme, për rastin kur pozicionet e pretendimit dhe realitetit shkojnë në drejtime të kundërta. Gjatë leximit të teksteve të mëposhtme mbi rrymat politike dhe drejtimit e mendimit politik, më mirë, mbani mend "orientimin" tuaj të përfytyrimeve shoqërore.

*Katër
përfytyrime
shoqërore*

Më poshtë do të prezantohen shkurtimisht përfytyrimet e ndryshme shoqërore të liberalizmit, konservatorizmit, socializmit dhe demokracisë sociale. Edhe pse kjo paraqet një rrezik, pra që të paraqesim të përmbledhur shkurtimisht modelet shoqërore, përsëri këtu do të jepen figura të rëndësishme argumentimi të rrymave të veçanta. Lidhur me "versionin e realitetit" në fund të paraqitjes do të jepen disa udhëzime respektive.

Meqenëse këtu kemi të bëjmë me një kategorizim në vija të përgjithshme, përsëri në fund të çdo modeli të prezantuar, do të jepen edhe tekste plotësuese.

3.2. Pozicionet liberale

Pozicionet liberale në raportin e tregut me demokracinë theksojnë tregun e lirë dhe vendosin në qendër të rëndesës lirinë e sipërmarrjes. Vendimarrjet demokratike këtu janë të kufizuara shumë te shteti i rregulluar, në mënyrë të tillë që ai të jetë vetëm garant për ekzistencën e tregut të lirë. Disa pikëpamje bazë të argumentimeve liberale janë:

- Tregu, në esencë, rregullohet vetë, duke garantuar që oferta për të mira materiale dhe jomateriale drejtohet nga kërkesa shoqërore.
- Liria ka prioritet absolut ndaj barazisë dhe solidaritetit, individit ndaj shoqërisë.
- Liria realizohet drejtpërsëdrejti nëpërmjet tregut. Një kufizim (esencial) i lirisë së tregut do të ishte i barabartë me një kufizim të lirisë dhe prandaj duhej shmangur medoemos.
- Shteti ka për detyrë të krijojë kushtet e përgjithshme të sigurta për tregun dhe të garantojë mbrojtje minimale (por pa pretendimin e të drejtave bazë) ndaj risqeve sociale, prej të cilave njerëzit, edhe pse jo për faj të tyre, mund të bien në gjendje të vështirë. Kjo fushë politike e kufizuar ngushtë, rregullohet në mënyrë demokratike. Shteti është përgjegjës vetëm për “kuadrin e rendit” të shoqërisë.
- Portreti njerëzor orientohet nga liria e njerëzve, të cilët dallohen nga njëri-tjetri nga arritje të tyre dhe që jetojnë si “maksimalistët dhe maksimalistët e dobisë”. Liria në treg plotësohet prej lirisë nga shteti: shteti duhet të garantojë vetëm që shoqëria të mos ndërhyjë në autonominë e njerëzve. Vërtet që njerëzit në lirinë e tyre duhet të mbrohen nga shteti, por shteti nuk duhet të ndërhyjë vetë në lirinë e tyre.
- Konceptet liberale nisen nga një bankë qendrore e pavarur, e cila para së gjithash duhet të ndjekë stabilitetin e vlerës së parasë si qëllim kryesor (“monetarizmin”).

Historikisht liberalizmi ka nisur të zhvillohet relativisht herët me shoqërinë borgjeze. Njëri nga filozofët më me influencë dhe “bashkëthemelues” ishte John Locke (1632-1704) (krahaso, faqe 11).

*Pikëpamje
bazë të
argumentimeve
liberale*

*Njëri nga
neoliberalët
më të njohur:
F.A. von Hayek*

Forma klasike e liberalizmit për sa i përket formës shtetërore (por jo asaj ekonomike) ka edhe një influencë të madhe mbi argumentimet e sotme socialdemokrate (krahasomë poshtë, faqe 77).

Friedrich August von Hayek (1899-1992)

ishite një ekonomist austriak dhe njëri nga mendimtarët më të rëndësishëm të liberalizmit në shekullin e XX-të.

Ai ishte njëri nga luftëtarët kryesorë për një treg të lirë dhe kundërshtar i ndërhyrjeve shtetërore të çfarëdo lloji ndaj tij. Prandaj ai cilësohet edhe si një kritik i ashpër i socializmit.

Sidoqoftë në gjysmën e parë të shekullit të 20-të dolën neoliberalët¹⁷, të cilët – parë në kontekstin historik – e ashpërsuan më tej pozicionin e balancuar të Locke-ut.

Kështu Friedrich August Hayek¹⁸ përfaqëson pikëpamjen se liria dhe demokracia mund të realizohen vetëm në kuadrin e një

sistemi ekonomik, i cili mbështetet mbi pronën e pakufizuar private dhe konkurrencën. Shoqëria lind si “rend spontan”, ku subjektet ekonomike hyjnë lirisht në lidhje dhe konkurrencë me njëri-tjetrin nëpërmjet tregut. Shteti ka për detyrë të përcaktojë vetëm rregullat e përgjithshme për sjelljen e personave të veçantë me njerëzit e tjerë (krahaso: Conert 2002: 287). Problemi që liria dhe demokracia në realitet janë të aksesueshme vetëm për pak veta, mbetet pa rëndësi në “rendin spontan” të Hayek-ut. Edhe që liria ekonomike e personit në kapitalizmin e pa fre kushtëzohet varfërinë ekonomike dhe mungesën e lirisë së tjetrit, edhe kjo është e parëndësishme. Këtu nuk do t’i shkojmë më thellë argumentimit të Hayek-ut. Një përshkrim të mirë dhe të diferencuar e gjejmë te Conerti.

Që pretendimi dhe realiteti i argumentimit neoliberal janë shumë larg nga njëri-tjetri, këtë e konstatojmë edhe në argumentimin e Wilhelm Röpke-s. Wilhelm Röpke përfaqëson idenë se liberalizmi na qenka alternativa

17. Në tekstin e mëposhtëm ne përdorim nocionin „neoliberal” për pozicionet teorike që janë zhvilluar të bazuar në liberalizmin klasik në gjysmën e parë të shekullit të 20-të dhe që janë bashkuar me të që nga vitet 1980-të. Natyrisht gjatë viteve të fundit në gjirin e të majtëve politikë nocioni „neoliberal” është zhvleftësuar si diçka e përgjithshme, duke u pozicionuar si një lloj „nocioni i përgjithshëm lufte”. Nuk ka rëndësi se si pozicionohemi ndaj koncepteve neoliberale, përsëri ekziston rreziku që të cilësohen si „neoliberale” të gjitha shfaqjet negative të shoqërisë së sotme. Për të shmangur këtë mënyrë analitike të papastër argumentimi, ne po përdorim këtu nocionin „neoliberal”.

18. Këtu natyrisht duam të theksojmë që argumentimi i von Hayek-ut dallohet qartësisht nga disa pozicione qendrore të koncepteve të tjera neoliberale (për shembull, në konstituimin e shoqërisë dhe paraqitjen e historisë). Vërtet që von Hayek është një teoricien me influencë të veçantë, por edhe nga vetë neoliberalët nuk është i padebatueshëm.

e vetme ndaj formës tiranike të shoqërisë së socializmit: Kush nuk e do “kolektivizmin”, shkruan ai, duhet të dojë “ekonominë e tregut [...]”. Por ekonomia e tregut do të thotë liri e tregut, çmime të lira dhe kosto elastike, do të thotë aftësi përshtatjeje dhe nënshtrim i prodhuesve ndaj sundimit të kërkesës. Negativisht do të thotë pikërisht të kundërtën e monopolit dhe përqendrimit të asaj anarkie të grupeve të interesit, të cilët përhapen në të gjitha vendet si kandidatët e Penelopës. Ekonomia e tregut do të thotë, që në vend të parimit kolektivist ne të zgjedhim parimin e vetëm rregullues që na vihet në dispozicion për një shoqëri tepër të diferencuar dhe shumë të teknizuar; por që vërtet të sigurohet rregullimi i procesit ekonomik, për këtë ai nuk duhet të falsifikohet dhe nuk [duhet] të jetë i korruptuar nga monopolet” (Röpke 1946: 74).

Këtu bëhet e qartë një kontradiktë që shfaqet në shumë pozicione liberale: nga njëra anë propagandohet një treg që (në masë të gjerë) rregullohet vetë, i çliruar nga zinxhirët e një politike rregulluese. Por nga ana tjetër, kritikohet ashpër krijimi i monopoleve dhe nga ana e shtetit kërkohet një kontroll, në mënyrë që konkurrenca të mos katapultohet nga krijimi i monopoleve. Kjo kundërshton tablonë e një „tregu të lirë“. Tregu të shpie hapur drejt fërkimeve, të cilat ai vetë nuk mund t'i rregullojë dot. Pra nevojitet një shtet që të drejtojë.

Përveç kësaj, pozicioni neoliberal pranon se me lirinë e tregut tashmë qenka e rregulluar mjaftueshëm edhe liria e personave të veçantë, një pikëpamje, e cila nuk mund të qëndrojë aspak në lidhje me ndikimet reale të ekskluzionit të kapitalizmit të tregut.

Së paku që nga vitet 1960-të është krijuar një rrjeti gjerë i rrjeteve neoliberale të kërkimit shkencor, i konsulencave politike, instituteve të ekonomisë dhe lobistëve. Ky rrjet ka kontribuar jo pak për “kthesën neoliberale” të viteve 1980-të, për shembull, nën qeverisjen e Theçerit dhe Reganit.¹⁹

Pozicionet neoliberale gjejnë zakonisht mbështetjen e atyre që posedojnë kapital dhe kanë një jetë të sigurt (pra në mënyrë klasike është shtresa e qytetarëve, e borgjezisë të arsimuar dhe me aktivitet ekonomik). Pra, neoliberalizmi në mënyrë të dyfishtë është një model elitari i shoqërisë. Ai është formuar në qarqe goxha të pasura dhe përfaqëson edhe interesat e tyre.

19. Një artikull që ia vlen të lexohet për lindjen e „rrjetit neoliberal“, gjendet te Plehwe/Walpen 2001.

Literaturë plotësuese e neoliberalëve dhe kritikëve të tyre

*Friedrich August
von Hayek
(1946),
Der Weg in die
Knechtschaft,
Zyrih*

*Wilhelm Röpke
(1942),
Die Gesellschafts-
tskrisis der
Gegenwart,
Zyrih*

*Wilhelm Röpke
(1946),
Civitas Humana.
Grundfragen der
Gesellschafts-
und Wirtschafts-
reform,
Zyrih.*

*Hansgeorg
Conert (2002),
Zur Ideologie des
Neoliberalismus
– am Beispiel der
Lehre
F. A. von
Hayeks, në:
Conert, faqe
275-296.*

*David Harvey
(2007), Kleine
Geschichte des
Neoliberalismus,
Zyrih*

3.3. Pozicionet konservative

Pozicioni më i vështirë për t'u konceptuar është ai konservativ. Kjo ka si arsye historike, ashtu edhe sistematike.

*Konservatorizmi:
i orientuar
nga ajo çka
ekziston*

Parë nga ana historike, pozicionet konservative – sikurse e thotë edhe vetë emri - orientohen në boshtin qendror nga ajo që ekziston dhe respektivisht nga ruajtja e saj. Prej saj kurrësi nuk mund të konstatohet një ide historike në vazhdimësi dhe e mëvetësishme. Shkurt: Konservatorë ka pasur gjithmonë, ndërsa një konceptim të përgjithshëm të konservatorizmit jo.

Gjatë Revolucionit Francez dhe në kohën e restaurimit në tridhjetë vitet e para të shekullit të 19-të konservatorët përfaqësonin privilegjet e trashëguara bashkë me lindjen dhe interesat e aristokracisë. Në Rajhun Perandorak Gjerman të sapo lindur ata u angazhuan pro shteteve të vogla gjermane, pastaj në fund për Rajhun Perandorak, në Republikën e Vajmarit (Weimarer Republik) u angazhuan gjerësisht për restaurimin e Rajhut Perandorak dhe kundër demokracisë. Në vitet 1980-të konservatorët rekrutuan vlerat klasike të neoliberalëve dhe ngulmonin për një shkëputje nga reformat e viteve 1970-të. Pra, nuk mund të përkufizohet një linjë konsekuente.

E megjithatë – kryesisht për kohën e sotme – mund të përmbledhim disa baza esenciale të mendimit konservativ:

- Konservatorët zakonisht orientohen nga vlerat bazë të familjes, vetëpërgjegjësisë dhe mendimit për të dhënë rezultate. Traditat zënë një vend shumë të rëndësishëm.
- Shteti zakonisht vjen nga një „rend më i lartë“ i vlerave, të cilat pasqyrohen te kombi. Ky „rend më i lartë“ zakonisht argumenton edhe një mendim të orientuar fuqishëm nga hierarkia dhe në një lidhje pozitive me elitën (e arritjeve) në shoqëri. Pabarazia shoqërore në këtë mënyrë bëhet e argumentueshme.
- Në Gjermani - por edhe në shumë vende të tjera – mendimi konservativ orientohet drejt një modeli njerëzor kristian. Përcaktimet esenciale të doktrinës sociale katolike (karitas, parimi i subsidiaritetit) pranohen si vlera.
- Prej disa vitesh nocioni i „qytetarisë së re“ (krahaso: Buchstein/Hein/Jörke 2007: 201) përdoret nga ana e konservatorëve.

*Bazat e
mendimit
konservator*

„Qytetaria e re“

Ai përshkruan një qytetar, i cili në jetën e tij u referohet vlerave si familja, edukata, besnikëria dhe mirësjellja dhe i sjell ato në shoqërinë civile dhe në profesion si përgjegjësi të veta. Udo di Fabio e formulon kështu: „Të jesh qytetar sot do të thotë të lidhësh njëra me tjetrën ngarkesën me qejfin, dashurinë me grindjen, skamjen me mirëqenien, lirinë ta kuptosh në radhë të parë edhe si liri për t’u lidhur në detyrime dhe suksesin si rezultat i një pune tënden, duke i shijuar me masë, pa i parë si absolute detyrimin dhe rezultatin. Të jesh qytetar do të thotë që në të gjitha veprimet individuale gjithmonë të mbash parasysh komunitetin, problemet e të gjithëve dhe ato të të dobëtëve e të atyre që kanë nevojë për ndihmë, pra përveç lirisë dhe barazisë të kujdesesh edhe për vëllazërimin” (di Fabio 2005: 138). Në nocionin e vëllazërimit të ri pasqyrohet pra një koncept i lirisë individuale, i cili kryesisht apelon moralin e secilit person, burrë apo grua. Ky dallon qartësisht nga modeli i njeriut socialist, socialdemokrat, por edhe nga ai liberal.

- Që nga vitet 1980-të dhe me “kthesën shpirtërore-morale” të përfaqësuar nga qeveria federale e Helmut Kohlit për konservatorizmin u krijua një amalgamë e përbërë nga modeli i njeriut kristian-konservator nga njëra anë, dhe liberalizmi ekonomik nga ana tjetër. Ndërsa që nga qeveria federale e Angela Merkel-it konceptet e tyre janë plotësuar me elemente socialdemokrate dhe mënyrën e mendimit socialdemokrat (edhe pse në një formë të dobët dhe paksa të ndryshuar). Kjo pjesërisht – e pikërisht në politikën e familjes – ka çuar në një potencial të lartë konfliktesh midis „të moderuarve” dhe „konservatorëve” në gjirin e CDU-së.

Pikërisht për konservatorizmin mund të nënvizohet se përkatësia e dukshme drejt një partie dhe konstantet historike në pozicionime janë të vështira për tu dalluar.

I qartë për t’u skicuar është target-grupi i pozicioneve konservatore: Këtu futen para së gjithash qytetare dhe qytetarë në gjendje të mirë që vijnë nga shtresa e borgjezisë nga fusha e ekonomisë dhe arsimit si dhe nga mjedisi fetar (kryesisht ai katolik).

Literaturë plotësuese për konservatorizmin

*Udo di Fabio
(2005),
Die Kultur der
Freiheit,
Mynih.*

*Edgar Jung
(1932),
Deutschland
und die kon-
servative Revo-
lution, Mynih.*

*Martin Greif-
enhagen
(1971),
Das Dilemma
des
Konserva-
tivismus in
Deutschland,
Mynih.*

3.4. Demokracia sociale dhe socializmi demokratik

*Zhvillimi
historik në
model*

Socializmi demokratik si model mendimi dhe socialdemokracia si forcë politike kanë një traditë të gjatë (mendimi), e cila është e lidhur ngushtë me lindjen e lëvizjes punëtore. Ndryshe nga konceptet konservative dhe liberale, ky model i mendimit politik është provuar si shumë i aftë për të bërë transformime. Kemi të bëjmë me një model mendimi, për të cilin është regjistruar gjithnjë ndërgjegjja e historikut të tij. Prandaj, ia vlen të hedhim një vështrim në historinë e ideve të kësaj rryme shoqërore.

3.4.1. Mendimtarët e parë të lëvizjes punëtore

*Kur ka
funksionuar
„socializmi“
si ide
në mënyrë
vendimtare?*

„Kur ka lindur socializmi demokratik si ide? Një pyetje, e cila është e vështirë për t’iu përgjigjur. Hermann Duncker konstaton: „Historia e socializmit nis me historinë e njerëzimit“ (Duncker 1931: 9). Të tjerë e lidhin idenë socialiste me krishterimin e lashtë fillestar. Por disa të tjerë i gjejnë socialistët e hershëm në Francë e Angli.

Pra mund të lundrosh nëpër histori dhe gjithnjë gjen përsëri një datë të re të lindjes. Të gjithë pozicionet, sigurisht, kanë argumentimet e tyre dhe të drejtën e tyre. E përsëri kemi të bëjmë me një pyetje që të çon në qorrsoak, sepse shumë më e rëndësishme nga pyetja se kur ka lindur një ide, është pyetja tjetër, që thotë se kur ka filluar të ndikojë në mënyrë vendimtare dhe pse?

Kësaj pyetjeje mund t’i përgjigjemi thjesht: ideja e socializmit ka marrë fuqi vepruese bashkë me lëvizjen punëtore – në Gjermani me industrializimin në shekullin e 19-të.

Këtu nuk mund të bëhet fjalë për të paraqitur një histori gjithëpërfshirëse idesh, por ne duam të prezantojmë shkurtimisht pikat esenciale të transformimit/përmbysjes dhe riorganizimit.

1848 deri në fund të shekullit të 19-të: lindja e rrymës politike

Në vitin 1848 nuk u zhvillua vetëm revolucioni borgjez në Gjermani; ai ishte edhe viti i lindjes së “Manifestit të Partisë Komuniste”, i një pune misionare që e hartuan bashkërisht Karl Marksi dhe Frederik Engelsi.

Karl Marksi (1818-1883) ishte një ekspert i shkëlqyer i ekonomisë sociale dhe një nga filozofët më të rëndësishëm të shekullit të 19-të.

Me rëndësi të veçantë kanë mbetur deri më sot analizat e tij ekonomike për kapitalizmin, që shkojnë përtej paraqitjeve të thjeshtëzuara të kritikëve të tij, por edhe të shumë simpatizantëve të tij.

Kështu për herë të parë u formulua me një gjuhë tKarl Marksi e një program i lëvizjes punëtore.

Baza teorike e këtij programi politik ishte çimentuar, në radhë të parë, nga Karl Marksi në vepra të tjera. Nga kjo dalin pikëpamjet themelore të socializmit si model mendimi i kësaj kohe:

- Marksi niset nga fakti se kapitalizmi (i tregut) çon në pabarazi dhe në mungesën e lirisë për shumë njerëz përkundrejt disa „të lirëve“. Nga njëra anë qëndrojnë pronarët e kapitalit, nga ana tjetër ata që nuk posedojnë asnjë kapital dhe prandaj u duhet të shesin fuqinë e tyre të punës në punën me pagesë. Kapitalizmi i tregut ndërtohet mbi atë që punëtorët dhe punëtorët me pagesë në pagën e tyre nuk marrin atë që prodhojnë në vlerat e prodhimit. Pronarët dhe pronarët e kapitalit mund të grumbullojnë („akumulojnë“) kështu gjithnjë e më tepër kapital. Këtu nuk është e rëndësishme nëse pronarët e kapitalit janë persona realë, shoqëri të mëdha kapitali apo financues të mëdhenj parash.
- Nëpërmjet konkurrencës së pronarëve të kapitalit dhe presionit të vazhdueshëm për të akumuluar më tepër kapital, me qëllim që të investojnë sërish në prodhim dhe pastaj të mund të prodhojnë përsëri më me leverdi se të tjerët, pra nga ky „ingranazh matrapazësh“ kushtet e punës së punëtorëve dhe punëtorëve vihen nën një presion të vazhdueshëm dhe – veç varfërisë - ka edhe një mbikapacitet të mundësive të prodhimit. Më pas mallrat nuk mund të kthehen më nëpara dhe kapitali nuk investohet më ose në krizat e mbiprodhimit, nga mungesa e tregjeve të shitjes, ai asgjësohet. Kjo është – në vija të trasha – arsyeja, pse Marksi niset nga ideja që krizat ekonomike janë një komponent esencial (dhe i domosdoshëm) i sistemit kapitalist (të tregut).
- Pabarazia dhe mungesa e lirisë që shihen si pasoja sistematike të kapitalizmit (të tregut) kundërshtojnë pikërisht pretendimin për liri të barabartë të të gjithë njerëzve.

*Pabarazia
dhe
mungesa
e lirisë
si karakteristika*

*Konkurrenca
dhe presioni
mbi punëtorët
dhe punëtorët*

- Sipas kësaj demokracia mund të realizohet vetëm si pretendim, kur prona e mjeteve të prodhimit shoqërizohet dhe kur vendimet për përdorimin e kapitalit merren nga struktura demokratike. Por, prona private – ndryshe nga sa është pranuar shpesh – përjashtohet nga shoqërizimi.
- Modeli marksist i njeriut ndërtohet, zakonisht, mbi një diferencë: Parimisht njerëzit e lirë, të barabartë dhe solidarë jetojnë në një sistem jo të barabartë, jo të lirë dhe të orientuar nga maksimizimi i pastër i leverdisë. Kështu, modeli i njeriut përmban një pretendim të fortë normativ.

Teoritë e Marksit dhe Engelsit krijojnë kështu - përveç teorive dhe doktrinave të tjera të ndryshme - një pikënisje të rëndësishme për lëvizjen punëtore.

*Lassalle
dhe themelimi
i ADAV*

E megjithatë, veprimi i këtij programi politik mbeti shprehimisht i kufizuar, edhe për faktin se Marksit dhe Engelsi, në analizën e tyre, nuk kishin marrë apo nuk mund të merrnin parasysh disa faktorë qendrorë. Midis tyre përmendet para së gjithash pyetja se çfarë raporti mund të ketë socializmi me shtetin.

Ferdinand Lassalle (1825-1864) ka marrë pjesë në masë të konsiderueshme në themelimin e "Bashkimit të Përgjithshëm të Punëtorëve Gjermanë" (ADAV) në vitin 1863 në Leipzig.

Në veprën e tij "Sistemi i të drejtave të fituara" ai luftonte për një kuptim demokratik të shtetit.

*Pikëpamjet
e Lassall-it*

Pikërisht këto pyetje ishin një pikënisje esenciale për Ferdinand Lassalle. Pikënisje të rëndësishme për mendimet e tij, ndër të tjera, ishin:

Lassalle fillimisht niset nga fakti se çdo sistem shtetëror dhe i së drejtës duhet të niset nga liria e njeriut. Prej kësaj rezultojnë se ligji bazë duhet të jetë shprehje e ndërgjegjësisë së gjithë popullit mbi të drejtën.

Nën këtë kuptim të shtetit, shteti përfytyrohet parimisht si bashkim i njerëzve të lirë; një provokim, mendohet, që shteti prusian dhe Rajhu Perandorak Gjerman që u ngrit disa vjet më pas, ishin karakterizuar nga një strukturë monarkiste-hierarkike.

“Shteti është ai që ka funksionin të çojë deri në fund këtë zhvillim të lirisë, këtë zhvillim të gjinisë njerëzore drejt lirisë. Pra, qëllimi i shtetit nuk është që të mbrojë vetëm lirinë personale dhe pronën e individit të veçantë, me të cilën ai sipas idesë së borgjezisë gjoja hyn në shtet; qëllimi i shtetit është shumë më tepër, pra është ai, që nëpërmjet këtij bashkimi, të sjellë personat e veçantë në atë nivel, sa që ata të arrijnë qëllime të tilla, një shkallë të tillë të ekzistencës, të cilën si individ më vete nuk mund ta arrijnë kurrë, pra t’i aftësojë ata të arrijnë një shumatore të arsimi, pushtetit dhe lirisë, të cilat, atyre të gjithëve si individë zor se do t’u krijoheshin”. (Lassalle 1987: 222).

Qëllimi i shtetit sipas tij është “edukimi dhe zhvillimi i gjinisë njerëzore drejt lirisë”. Rëndësia e shtresës së katërt, ose e shtresës së punëtorëve, për Lassalle ishte të përcillte pikërisht këtë përfytyrim të shtetit. Prandaj kërkesa themelore ishin e drejta e përgjithshme dhe direkte e zgjedhjes dhe emancipimi nëpërmjet krijimit të shoqatave të punëtorëve. Këto – sipas pikëpamjes së Lassalle - duhej të krijoheshin me ndihmën e shtetit.

Wilhelm Liebknecht (1826-1900) dhe **August Bebel** (1840-1913) në vitin 1869 ishin themeluesit më të rëndësishëm të Partisë Socialdemokrate Punëtore në Eisenach. Përveç kësaj ata ishin deputetët e parë socialdemokratë të Reichstag-ut (Gjermanoverior) (1867-1870). Duke filluar nga viti 1890 Liebknecht ishte edhe kryeredaktor i gazetës „Vorwärts”.²⁰

Kështu Lassalle ka sjellë dy pika qendrore reference për diskutimin mbi demokracinë sociale dhe socializmin demokratik: nga njëra anë ishte pyetja për një shtet demokratik dhe kushtet e tija paraprake sociale dhe nga ana tjetër pyetja, se me çfarë strategjie do të mund

të realizoheshin më mirë interesat e punëtorëve dhe punëtoreve.

Kritika ndaj përfytyrimit të shtetit të Lassall-it u përfaqësua në mënyrë të shquar nga Wilhelm Liebknecht dhe August Bebel. Pika e kritikës ishte, para së gjithash, se programi i Lassall-it kish hedhur rrënjë shumë të shkurtra: pa liri shtypi, liri mbledhjeje dhe bashkimi, pa një përmbysje me themel të shtetit nuk qenkëshin të realizuara interesat e punëtorëve dhe punëtorëve dhe as nuk mund të realizoheshin në dhe nga shteti.

Kërkesat bazë të Lassalle

August Bebel dhe Wilhelm Liebknecht

Kongresi i bashkimit në Gotha më 1875

20. Vorwärts = Përpara! (shën. i përkthyesit)

Në vitin 1875 u bashkuan në Gotha Bashkimi i Përgjithshëm i Punëtorëve Gjermanë dhe Partia Socialdemokrate e Punës, duke krijuar kështu Partinë Socialiste të Punës të Gjermanisë. Në Rajhun Perandorak Gjerman u vendos kështu guri i themelit për një zgjerim tjetër të socialdemokracisë – edhe kundër ligjeve antisocialiste të Bismarkut. Por pikat esenciale të konfliktit vazhdonin të mbijetonin edhe në këtë kohë, edhe pse në plan të dytë, duke marrë flakë më pas sërish e duke çuar pastaj në përçarjen e lëvizjes punëtore.

3.4.2. Përçarja e lëvizjes punëtore

*Thelbi teorik i
debatit
dhe tre kampe
të rëndësishme*

Qysh në vitet 1890-të në gjirin e socialdemokracisë u zhvillua një konflikt, i cili rrotullohej rreth një çështje teorike: A mund të bjerë kapitalizmi në një krizë (finale), ku lëvizja punëtore me luftën proletare të klasave të mposhtë kapitalizmin dhe të mund të arrijë socializmin? Dhe çfarë do të thotë kjo për strategjinë e socialdemokracisë?

Në këtë “debat të revizionizmit”, thënë trashë, dallohen tre kampe të rëndësishme (krahaso këtu Eucher/Grebing etj. 2005: 168; Grebing 2007: 66-94).

*Grupi rreth
Karl Kautsky-t
dhe August
Bebel-it*

Një grup rreth Karl Kautsky-t dhe August Bebelit, edhe pse shpresonte se nëpërmjet shumicës parlamentare dhe një punëtorie të organizuar mirë mund të arrihej kalimi në socializëm, konstatoi se politika e radikalizuar e Rajhut Perandorak dhe orientimi i saj drejt një lufte imperialiste mund të kërkonin një rezistencë dhe një politikë jashtëparlamentare me greva masive. Forca luftarake e lëvizjes punëtore mund ta detyronte kalimin drejt socializmit.

Përveç kësaj pikëpamjeje shoqërore u zhvillua i ashtuquajti revizionizëm, i cili u karakterizua në një masë të konsiderueshme nga Eduard Bernstein-i dhe që u orvat t'i

Karl Kautsky (1854-1938) ishte themelues dhe botues i gazetës teorike, të orientuar nga SPD-ja “Die neue Zeit” – Koha e re). Kautsky ishte angazhuar esencialisht që analiza marksiste e shoqërisë të sanksionohej në gjirin e SPD-së. Bashkë me Eduard Bernstein-in ishte përpiluesi kryesor i programit të Erfurtit.

Eduard Bernstein-i (1850-1932) ishte një nga përfaqësuesit më me influencë të „revizionistëve” në gjirin e socialdemokracisë. Në veprën e tij të botuar në vitin 1899 „Premisat e socializmit dhe detyrat e socialdemokracisë” ai debaton në mënyrë kritike me marksizmin. Bashkë me Karl Kautsky-n, Bernstein-i ishte njëri nga autorët e qenësishëm të Programit të Erfurtit në vitin 1891.

*Revizionistët,
p.sh. Eduard
Bernstein-i*

bënte një verifikim(revizionim) doktrinë së Marksit në bazë të të dhënave statistikore. Në përfundim ky interpretim çoi në atë që reformat janë të mundura brenda shoqërisë dhe shtetit kapitalist. E megjithatë nuk do të ketë asnjë përmbysje automatike të kapitalizmit; për më tepër krizat brenda kapitalizmit do të zbuten dhe jo ashpërsohen. Me fuqizimin e sindikatave dhe shoqatave mund të arrihen reforma në shoqëri për të zhvilluar kështu një socializëm. Sindikalisti Adolf von Elm e solli programin revizionist në këtë pikë:

„Nga evolucioni drejt revolucionit – nga demokratizimi i vazhdueshëm dhe socializimi i trupit shoqëror drejt transformimit të plotë të shoqërisë kapitaliste drejt asaj socialiste: Ky është – i skicuar me pak fjalë – pozicioni i revizionistëve në parti.” (Cit. sipas Euchner/Grebing etj. 2005: 171).

Roza Luksemburgu (1871-1919) ishte bashkëthemeluese e Partisë Socialdemokrate të Mbretërisë së Polonisë dhe Lituanisë. Në vitin 1899 erdhi në Berlin. Ajo ishte një teoriciene udhëheqëse e të majtëve në Partinë Socialdemokrate të Gjermanisë, ndër të tjera edhe e teorisë së imperializmit. Në vitin 1918 ishte bashkëthemeluese e Partisë Komuniste të Gjermanisë. Më 1919 u vra nga oficerët e Korpusit të Lirë.

Roza Luksemburgu kundërshtoi pozicionin e Bernstein-it me mendimin se kapitalizmi nga struktura e tij e brendshme i nënshtrohet konkurrencës së vazhdueshme të pronareve dhe pronarëve të kapitalit.

Mënyra kapitaliste e prodhimit ka nevojë për një ekspansion të përhershëm

dhe marrje teritorësh në sektorët më parë jo kapitalist. Ajo kundërshton gjithashtu edhe dallimin e revolucionit nga reforma:

“Për socialdemokracinë lufta e përditshme praktike bëhet duke punuar për reforma sociale, për përmirësimin e gjendjes së popullit punëtor mbi truallin e ekzistencës, për institucionet demokratike drejt rrugës së vetme për të drejtuar luftën proletare të klasave dhe për të arritur në qëllimin final, pra marrjen e pushtetit politik dhe heqjen e sistemit të pagës. Për socialdemokracinë, mes reformës sociale dhe revolucionit social ekziston një lidhje e pazgjidhshme, ku për të lufta për reformën sociale është mjeti, ndërsa transformimi social qëllimi.” (Luksemburg 1899: 369)

*Roza
Luksemburgu*

Edhe Roza Luksemburgu nuk iu kundërvu punës parlamentare, por e quante atë të pamjaftueshme që të mund të arrihet një socializëm. Prandaj, ajo mbështetej edhe në lëvizjen punëtore jashtë parlamentare.

Këto tre rryma në lëvizjen punëtore dhe në gjirin e SPD-së mundën të bëheshin të njohura, në radhë të parë, edhe nën presionin e jashtëm të Rajhut Perandorak. Me votimin e shumicës së SPD-së për kreditë e luftës dhe ndarjen midis USPD dhe SPD dhe së fundi me fundin e Luftës së Parë Botërore dhe pas pyetjes se si duhej të formësohej shoqëria demokratike, lëvizja punëtore u përça.

1919 dhe formimi i Republikës së Vajmarit

Më 1919 SPD-ja formoi qeverinë e parë në Republikën e Vajmarit – kundër rezistencës së forcave konservatore, nacionaliste dhe reaksionare, por edhe kundër kundërshtimit të komunistëve. Ky shans historik i së majtës shoqërore që kishte mundësi të realizohej për herë të parë politikisht, la të shfaqeshin edhe një herë qartësisht në diskutimin socialist pjesët e plasaritura.

Ndërsa komunistet dhe komunistët dhe një pjesë e socialisteve dhe socialistëve ishin për theelimin e një shteti të këshillave të punëtorëve dhe ushtarëve, socialdemokratët kishin punuar esencialisht për theelimin e një demokracie përfaqësuese dhe i dhanë formë kësaj deri në vitet 1920-të.

Për argumentimin socialdemokrat Fric Naftali e ka formuluar këtë në mënyrë të gjetur:

„Në periudhën kur kapitalizmi ishte akoma plotësisht i lirë, nuk duhej të ishte e mendueshme asnjë alternativë tjetër ndaj kapitalizmit të paorganizuar përveç organizimit socialist të ekonomisë në përgjithësi. [...] Më pas u konstatua dallëngadalë se struktura e vetë kapitalizmit është e ndryshueshme dhe se kapitalizmi, para se të thyhet edhe mund të përkulet.“ (Naftali 1929; këtu cituar sipas Euchner/Grebing etj. 2005: 305).

E thënë shkurtimisht, thelbi i debatit qëndronte në diferencën midis revolucionit dhe reformës. Tek njëra anë („ajo revolucionare“) sundonte vlerësimi, se përmbysja e marrëdhënieve të deritanishme të pronësisë dhe e formës shtetërore janë të nevojshme për të arritur një shoqëri të re, ndërsa pozicioni reformist pretendonte se shoqëria kontemporane,

me formën e saj shtetërore nëpërmjet reformave të vazhdueshme, duhet të zhvillohet drejt një socializmi demokratik.

Pikëpamjet e ndryshme u pasqyruan edhe në modelet e ndryshme për shtetin:




Fig. 6: Sistemi i këshillave dhe “kapitalizmi i organizuar”

“Socializmi demokratik”, ashtu si e solli SPD-ja si ide, u vendos mbi një demokraci parlamentare dhe një ndarje të sferës politike dhe ekonomike. Në të dyja sferat – politike dhe ekonomike - duhet të arrihej një demokratizim në kuptimin e punëtorëve dhe të mirëqenies së përgjithshme. “Socializmi demokratik” në këtë korrelacion nënkuptonte një plotësim kompleks dhe veprim të ndërsjellë midis ekonomisë socialiste me aktorë të fortë të punëtorëve dhe punëtorëve (sindikatat, vendimarrja në ndërmarrje dhe sipërmarrje) dhe demokracisë parlamentare.

*Socializmi
demokratik si
ide*

Në vitin 1959 në Gjermani programi i Godesbergut i SPD-së kishte gjetur formulën esenciale socialdemokrate për "tregun e lirë": "Konkurrencë sa të jetë e mundur – planifikim sa të jetë i nevojshëm!" (Dowe/Klotzbach 2004: 332). Këtu formulohet një pozicion, i cili vërtetë që i përmbahet më tepër një "socializmi demokratik" se sa një "rendi të ri ekonomik dhe social", por që njëkohësisht pranon kapitalizmin e tregut në një formë të rregulluar gjerësisht nën primatin e politikës. Njëkohësisht socialdemokracia me këtë version u tërhoq drejt një ekonomie të planifikuar, sikurse u realizua kjo në Bashkimin Sovjetik.

3.4.3. Socializmi demokratik vs. socializmi shtetëror

Pas Luftës së Dytë Botërore dallimi midis një SPD-je të orientuar drejt socializmit demokratik dhe pikëpamjeve socialisto-shtetërore doli më qartë në pah. Me Programin e Godesbergut të vitit 1959 SPD-ja u nda zyrtarisht nga marksizmi si botëkuptim, edhe pse jo nga të gjitha analizat e tij, e bashkë me të edhe nga përfytyrimi i një zhvillimi "të domosdoshëm nga natyra" drejt socializmit. Për më tepër, socializmi është përshkruar si një "detyrë e vazhdueshme", e cila mund të argumentohet me motive të ndryshme religjioze dhe filozofike. Qendrore për përcaktimin e socializmit demokratik ishin tashmë tri vlerat bazë "liria, drejtësia dhe solidariteti". Nga këto vlera themelore rridhnin kërkesat bazë socialdemokrate, si një njohje e qartë për lirinë dhe demokracinë:

"Nuk ka socializëm pa liri. Socializmi mund të realizohet vetëm nga demokracia; demokracia mund të jetë e përsosur vetëm nëpërmjet socializmit." (Deklarata e parimeve të Internacionales Socialiste, Frankfurt mbi Main 1951, cit. sipas Dowe/Klotzbach 2004: 269).

Përtej këtij kuptimi të lirisë socializmi demokratik distancohet gjithnjë qartësisht nga regjimet totalitare – dhe veçanërisht – nga të ashtuquajturat demokraci popullore të Bllokut të Lindjes.

3.5.4. SPD sot – sfidat e reja, përgjigje të reja

Një vështrim mbi historinë e lëvizjes punëtore paraqet betejat strategjike mbi funksionin e shtetit dhe të shoqërisë. Akoma edhe sot „socializmi demokratik” është një vizion vendimtar për SPD-në, realizimi i të cilit për të është bërë detyrë. Ai duhet parë si i njëjtë me një shoqëri, në të cilën sundojnë vërtet liria, barazia dhe solidariteti. Parim i veprimit të SPD-së – kështu thotë Programi i Hamburgut - do të jetë “demokracia sociale”. Pra, këtu ai i referohet arritjes së një socializmi demokratik nëpërmjet vendimmarrjes demokratike si edhe realizimit të të drejtave themelore politike, ekonomike dhe kulturore.

“Shoqëria jonë është e karakterizuar nga ideja e socializmit demokratik, e një shoqërie të njerëzve të lirë dhe të barabartë, ku janë realizuar të drejtat tona bazë. Ajo kërkon një rend ekonomik, shtetëror dhe shoqëror, në të cilin janë të garantuara të drejtat bazë qytetare, politike, sociale dhe ekonomike për të gjithë njerëzit, ku të gjithë njerëzit të bëjnë një jetë pa shfrytëzim, shtypje dhe dhunë, pra, në një siguri sociale dhe njerëzore. Socializmi demokratik mbetet për ne një vizion i një shoqërie të lirë, të drejtë dhe solidare, realizimi i së cilës për ne është një detyrë e vazhdueshme. Parimi i veprimit tonë është demokracia sociale.” (Programi i Hamburgut 2007: 16)

Tani socialdemokracia është vënë para sfidës, që në kontekstin e globalizimit të mëtejshëm të tregjeve të reja ndaj influencës së tregjeve financiare dhe ndaj transformimeve në tregun e punës dhe të vendosë se si e përfytyron ajo ekuilibrin e ri midis kapitalizmit të tregut dhe demokracisë. Me fjalë të tjera: këtu bëhet fjalë se si do të realizohet një “socializëm demokratik” në këto kushte. Që këtu nuk dalin vetëm pyetje të reja, por edhe përgjigjet e para, këtë e bën të qartë Programi i Hamburgut i Partisë Socialdemokrate të Gjermanisë (Krahaso edhe kapitullin 6).

Plotësimi i ekonomisë së koordinuar dhe demokracisë përfaqësuese nëpërmjet primatit të politikës vazhdohet edhe në Programin e Hamburgut të SPD-së, por si kërkesë për të ardhmen edhe në rrafsh evropian dhe botëror:

*Socializmi
demokratik si
vizion –
Demokracia
sociale si parim
veprimi*

Sfida sot

“Tregjet kanë nevojë për formatim politik – në kohën e globalizimit edhe përtej kufijve kombëtarë. Për ne vlen: sa më shumë konkurrencë që të jetë e mundur, sa më shumë shtet i rregulluar që të jetë i nevojshëm”.
(Programi i Hamburgut 2007: 43)

Një vështrim i hollësishëm mbi modelet e mendimit të socialdemokracisë, modelet liberale dhe konservatore tregon se kemi të bëjmë me modele alternative që e dënojnë si gënjeshtër pretendimin se partitë ngjakan me njëra-tjetrën aq shumë, sa vështirë se shoh dallime në programet e tyre.

3.5.5. Ekskurs: Partia “E Majta” dhe kontradiktat e saj

„E majta”

Me transformimet e vitit 1990 në Gjermani, fillimisht në lindje, u krijua një parti tjetër e majtë si organizatë pasuese e SED-së (Partisë Socialiste të Unifikuar të Gjermanisë): PDS, Partia e Socializmit Demokratik. Ndërkohë, kjo parti është bashkuar me WASG, duke krijuar kështu partinë „E Majta”, e cila është shtrirë edhe në disa lande federale në pjesën perëndimore.

Një renditje e pozicionit të partisë „E Majta” bëhet shumë e vështirë – pasi ajo është akoma në lëvizje. Kështu, partia në vitin 2007 vendosi vetëm „Piketat programatike”, por akoma nuk ka një program partiak në kuptimin klasik.

*Piketat
programatike*

Në piketat e saj partia “E Majta” përqafon pikëpamjet e socializmit demokratik:

„Demokracia, liria, barazia, drejtësia, internacionalizmi dhe solidariteti janë orientimet e vlerave tona themelore. Ato janë të lidhura pazgjidhshmërisht me paqen, mbrojtjen e natyrës dhe emancipimin. Idetë e socializmit demokratik paraqesin përfytyrime qendrore drejtuese për zhvillimin e objektivave politike të së majtës.

E MAJTA e drejton veprimin e saj politik lidhur me qëllimin, rrugën dhe orientimet e vlerave bazë. Liria dhe drejtësia sociale, demokracia dhe socializmi kushtëzojnë njëra-tjetrën. Barazia pa liri individuale përfundon në tutori dhe vendimmarrjen e të huajve. Liria pa barazi është vetëm liri

për të pasurit. Edhe njeriu nuk është i lirë, kur ai shtyp dhe shfrytëzon njerëzit e tjerë. Qëllimi i socializmit demokratik, i cili do të kapërcejë kapitalizmin në një proces transformator, është një shoqëri, në të cilën liria e tjetrit nuk përbën kufirin, por kushtin për lirinë tënde.” (Piketat e partisë “E Majta” 2007: 2)

Po t'i hedhim një sy formulimit të piketave, mund të shohim edhe disa pika të tjera, të cilat përpiqen të përshkruajnë “Të Majtën” dhe programatikën e saj:

- E Majta është një lëvizje politike, e cila lidh ish kuadro të SED-së, socialdemokrate dhe socialdemokratë të dikurshëm të zhgënjyer, pjesë të lëvizjeve të reja sociale, sindikaliste dhe sindikalistë, zgjedhëse dhe zgjedhës protestues, politikane dhe politikanë lokalë me orientim pragmatik, komuniste dhe komunistë etj. Të gjitha këto grupe sjellin në parti pikëpamje shumë të ndryshme shoqërore – (ende) nuk dallohet ndonjë model mendimi apo koncepti unifikuar.
- Shpesh partia „E Majta” në publik cilësohet si parti e protestës. Ky cilësim nuk është fare i saktë, pasi ai lidh me njëri-tjetrin dy aspekte në mënyrë të shkurtuar. Fillimisht kemi të bëjmë me pyetjen se cilët janë zgjedhësit dhe zgjedhëset e partisë „E Majta”. Kjo tablo vazhdon të jetë shumë e ndryshme për Gjermaninë Lindore dhe Perëndimore. Aspekti i dytë ka të bëjë me strategjinë politike apo me vullnetin politik të formatimit – edhe këtu rezultati është shumë i diferencuar në landet federale dhe në Federatë.
- Në literaturën shkencore “E Majta” përshkruhet, në tekstet e pakta që janë marrë deri tani me të, jo vetëm si qartësisht heterogjene, por edhe si shumë kontradiktore. Kështu, nga njëra anë ajo tregohet e matur në aspektin pragmatik dhe moderne, por nga ana tjetër mbështetet në një ideologji ortodokse me tipare thuajse ekstremiste (krahaso: Decker etj. 2007: 327). Diskrepanca e madhe midis deklaratave shumë parimore të qëllimeve nga njëra anë dhe një politike qeverisëse pragmatiste në parlamentet e ndryshme të landeve nga ana tjetër, e cila kundërshton këto deklarime të qëllimeve, duket se vërteton këto përshtypje.

Lidhur me fenomenin „E Majta” me siguri që duhet pritur në se ajo do të pozicionohet në vazhdimësi dhe me çfarë përmbajtje do ta bëjë këtë. Në çdo rast është i nevojshëm një ballafaqim politik me idetë e saja politike.

*Karakteristika të
partisë
“E Majta”*

3.4.6. Portreti njerëzor i demokracisë sociale

Një model specifik njerëzor të demokracisë sociale është e vështirë ta gjes. Modeli njerëzor i demokracisë sociale karakterizohet nga shumë burime dhe një pluralizëm argumentimesh.

Ka disa pika takimi me traditën e lëvizjes punëtore, teorinë liberale, doktrinën kristiane dhe çifute, si edhe me influencat humaniste dhe marksiste. Ky model lidhet gjithashtu me lirinë e çdo njeriu, ashtu sikurse liberalizmi, por analizon – njësoj si konceptet marksiste – edhe pengesat shoqërore për realizimin e të drejtave bazë.

Meyer dhe Breyer, në librin "E ardhmja e demokracisë sociale" janë përpjekur të perceptojnë në formë tabelare dallimin e modelit njerëzor liberal ("neoliberal") nga modeli njerëzor i demokracisë sociale. Si orientim në një kolonë të veçantë kemi futur një model të njeriut socialist:

	"Demokracia liberale"	"Demokracia socialiste"	"Demokracia sociale"
Antropologjia	Antropologjia skeptike	Antropologjia realiste	Antropologjia normative, utopike
Nocioni i lirisë	Nocioni negativ i lirisë	Nocioni pozitiv i lirisë	Nocioni pozitiv i lirisë
Motivi i sjelljes	Interesat e veta	Interesat e veta dhe të komunitetit	Interesat e komunitetit dhe ato të vetat
Modeli njerëzor	Egoist racional kalkulues	Person i orientuar nga mirëkuptimi	Person luftarak dhe i orientuar nga "njeriu i ri" i së ardhmes

Burimi: Meyer/Breyer 2005: 33 – kolona e fundit e plotësuar nga T. Gombert

Edhe pse paraqitje të tilla tabelare janë thjeshtuar shumë, përsëri ato tregojnë një tendencë:

- Teoritë liberale – zakonisht – mbështeten në pretendimin se “leverdia vetjake” është forca lëvizëse e njerëzve. Kjo leverdi vetjake mund të jetohet, kur ajo mbrohet ndaj tjetrës/tjetrit (dhe prej shtetit), për t’i lënë çdo personi, burrë apo grua “lirinë për maksimalizimin e leverdisë”.
- Teoritë socialiste kanë një traditë të gjatë në dëshirën për të realizuar një shoqëri të denjë njerëzore nëpërmjet “njeriut të ri” (krahaso: këtu Adler 1926 dhe Heinrichs 2002: 308-314). Sipas kësaj teorie njerëzit historikisht qenkan aq të korrumpuar nga shoqëria kapitaliste dhe pabarazia sociale, sa që aftësia e tyre për të njohur interesat e komunitetit si mirëqenien e tyre vetjake dhe për t’i përfaqësuar ato në mënyrë solidare, është tronditur. Për pasojë, detyrë e edukimit dhe arsimimit duhet të jetë kapërcimi (bashkërisht) i diferencave midis raporteve sociale të jetesës dhe pretendimit për njerëz të lirë dhe solidarë.
- Një model njerëzor i demokracisë sociale – kështu e paraqesin të paktën Meyer/Breyer – kërkon të arrijë një kompensim, ku do të harmonizohen interesat vetjake me ato të mirëqenies së përgjithshme. Pra, këtu bëhet fjalë për një përfytyrim të balancimit të “interesave të ligjshme”.

Literaturë plotësuese:

Walter Euchner,
Helga Grebing
etj. (2005),
*Geschichte der
sozialen Ideen
in Deutschland.
Sozialismus
–Katholische
Soziallehre–
Protestantische
Sozialethik.
Ein Hand-
buch, 2. Aufl.,
Wiesbaden, f.
13–595.*

Thomas Meyer
dhe Nicole
Breyer
(2005), *Die
Zukunft der
Sozialen Demo-
kratie, Bonn.*

Dieter Dowe
dhe Kurt Klotz-
bach (botues)
(2004), *Pro-
grammatische
Dokumente der
Deutschen So-
zialdemokratie,
Botimi i 4-t i
përpunuar dhe
aktualizuar,
Bonn*

4. TEORIA E DEMOKRACISË SOCIALE E THOMAS MEYER-IT

Në këtë kapitull

- Do të paraqitet *Teoria e demokracisë sociale* e Thomas Meyer-it;
- Do të ndriçohet raporti i kapitalizmit të tregut dhe demokracisë, i cili nga njëra anë është i tensionuar, nga ana tjetër reciprokisht plotësues;
- Do të diskutohen dallimet qendrore të demokracisë liberale, libertariane dhe asaj sociale;
- Do të shpjegohet raporti i vlerave bazë, të drejtave themelore dhe instrumenteve;
- Do të përpunohet dallimi i të drejtave pozitive dhe negative të lirisë dhe do të diskutohen detyrimet e shtetit për veprim.

Diskutimi i vlerave bazë dhe vështrimi mbi modelet e ndryshme shoqërore në kapitujt e mësipërm kanë treguar se demokracia sociale ka një traditë mendimi. Nocioni shmanget nga modelet e tjera të mendimit dhe është aq i diferencuar, sa që për ta sqaruar atë nuk mjafton vetëm një referim i thjeshtë tek vlerat bazë të lirisë, barazisë dhe solidaritetit për realizimin e një shoqërie të drejtë, ashtu sikurse ndodh edhe me referimin tek liberalizmi, konservatorizmi dhe socializmi.

Në fillim të këtij prezantimi bëhej fjalë për një teori të demokracisë sociale. “Demokracia sociale” – ky ishte pretendimi - duhet të përkufizohet pastër, në qoftë se duam të diskutojmë për të dhe të argumentojmë me të.

Këtu janë cilësuar katër perspektiva mbi demokracinë sociale – tri prej tyre do të kujtohen edhe një herë shkurtimisht këtu:

“Demokracia sociale -a nuk është ky një koncept që shpjegohet automatikisht? Një koncept me premtimin se pjesë e një demokracie është, që ajo të jetë me vlerë për të gjithë në shoqëri dhe të kemi një ekuilibër social? A nuk është kjo e vetëkuptueshme? – thotë njëra palë.

*Çfarë është
demokracia
sociale?
Tri përgjigje*

“Demokracinë sociale – këtë e kemi praktikuar tashmë në Gjermani me ekonominë sociale të tregut në modelin e Gjermanisë, apo jo? – kështu pyesin disa të tjerë.

“Demokracia sociale” – kjo i përket SPD-së dhe ajo ka të bëjë vetëm me socialdemokratet dhe socialdemokratët, se ajo është teoria e tyre, kështu mendon një grup i tretë.

Këto pyetje – nisur nga këndvështrimi praktikopolitik mbi një teori - vendosen me të drejtë që në fillim. Pra, atyre u duhen dhënë përgjigje, kur duam ta bëjmë teorinë e demokracisë sociale politikisht të përdorshme.

Pyetjes së parë “Demokracia sociale – a nuk është ky një koncept, që shpjegohet automatikisht vetë?” - kësaj pyetjeje tashmë i kemi dhënë përgjigje më sipër: Është e domosdoshme të zhvillojmë një përfytyrim të saktë të konceptit “Demokraci sociale”, sepse ka shumë asociacione të ndryshme, të cilat mund të shpjegohen vetëm bashkërisht. Natyrisht koncepti përmban tashmë një bërthamë të qenësishme normative: Cilave rregulla dhe normave të përbashkëta duhet t’u referohemi, kur bëhet fjalë për realizimin e demokracisë sociale?

Një vështrim mbi vlerat bazë ka treguar se shumë argumente filozofike mund të kontribuojnë për sqarim, por që nuk mjaftojnë akoma si bazë normative – pikërisht sepse kemi të bëjmë akoma me përkufizime plurale dhe të debatueshme. Për një teori të demokracisë sociale duhet gjetur një bazë specifike normative si pikënisje.

Pyetja e dytë “Demokracia sociale – këtë e kemi praktikuar tashmë në Gjermani me ekonominë sociale të tregut në modelin e Gjermanisë, apo jo? diskutohet hollësisht, para së gjithash, në bazë të studimeve të vendeve (krahaso: faqe 107). Në “fushën e tensionit” tashmë kemi shënuar se nuk kemi të bëjmë me “një arritje të papërsëritshme të demokracisë sociale” (si në një vrapim 100m). Për këtë ekziston një variacion i gjerë i modeleve të ndryshme shoqërore, drejt të cilëve duan të “navigojnë” grupe të ndryshme interesash. Vetëm referimi mbi një model si “Modeli i Gjermanisë” apo mbi “ekonominë sociale të tregut” nuk mjafton, pasi ky referim harron aktorët e ndryshëm politikoshoqërorë.

Qëndrimi i tretë “Demokracia sociale – e po kjo i përket SPD-së dhe është punë vetëm e socialdemokrateve dhe socialdemokratëve, pra është teoria e tyre” - lë për të dyshuar.

Një referencë mbi “socialdemokracinë” si parti dhe rrymë politike, vërtet që është e kuptueshme, por nuk mund të jetë aspak një përgjigje shteruese:

“Demokracia sociale në përdorimin gjuhësor aktual i ka të dyja, pra është edhe një nocion bazë i teorisë së demokracisë dhe një emër për karakterizimin e një programi me drejtim politik. Edhe pse midis këtyre dy formave të përdorshme ekzistojnë marrëdhënie të ndërsjella të shumta, përsëri në to bëhet fjalë për dy qëndrime qartësisht të ndryshme me kërkesa vlerësimi të llojeve të ndryshme. Teoria e demokracisë sociale nuk mbështetet në aktorë të paracaktuar politikë as për sa i përket vendosjes së bazave normative të saj, as në lidhje me rolin e saj shpjegues dhe as në shpjegimin krahasues të rrugëve të ndryshme të realizimit të saj, edhe pse, natyrisht, çdo hap për realizimin e saj varet nga fakti që kryesisht aktorët politikë punojnë për programin e veprimit praktik të devijuar prej saj. Aktorë politikë të llojeve të ndryshme mund ta përdorin përsëri konceptin e demokracisë sociale si emërtim programi, aty ku e shohin këtë të favorshme, por në masë të gjerë pavarësisht nga fakti nëse dhe deri në çfarë mase përpjekjet e tyre politike mbulohen nga teoria e demokracisë sociale, dhe nëse kërkojnë apo jo lidhje me të.”
(Meyer 2005: 12)

*Demokracia
sociale
si model
mendimi*

Demokracia sociale si model mendimi dhe socialdemokracia si parti politike (ose rrymë) kanë pika takimi– por nuk janë identike. Si model mendimi demokracia sociale duhet të ketë pretendimin të analizojë dhe të paraqesë në mënyrë konsistente normat dhe vlerat e bazuara shkencërisht, kthimin e tyre në të drejta bazë dhe realizimin e tyre në vende të ndryshme. Nëse partitë politike e përvetësojnë këtë përfytyrim apo jo, kjo është një gjë tjetër.

Në faqet që vijojnë nuk bëhet fjalë për socialdemokracinë, por për një model mendimi, i cili është formuar në diskurs që nga vitet 1980-të dhe 1990-të.

Si pikënisje po marrim këtu për bazë teorinë e paraqitur nga Thomas Meyer, pra “Teorinë e Demokracisë Sociale”- në të lidhen shumë fije të ndryshme që kanë karakterizuar dhe karakterizojnë kuadrin e diskursit mbi demokracinë sociale.

4.1. Pikënisja

Pikënisje për teorinë e demokracisë sociale të Meyer-it është pyetja (tashmë e njohur më sipër), se në çfarë relacioni janë me njëri-tjetrin demokracia dhe kapitalizmi i tregut.

Të dyja – demokracia dhe kapitalizmi i tregut – kuptohen si dy aspekte esenciale të sistemit tonë shoqëror që zhvillohen ndërsjelltas në një raport tensioni.

*Pyetja fillestare:
si sillen me
njëri-tjetrin
demokracia
dhe kapitalizmi
i tregut?*




Fig. 7: Lidhja mes kapitalizmit të tregut dhe demokracisë

Pra Meyer-i pretendon se nga njëra anë kapitalizmi dhe demokracia plotësojnë njëri-tjetrin, se kapitalizmi i tregut ka qenë një premisë e lindjes dhe stabilitetit për demokracinë. Por nga ana tjetër, ai konstaton një “tension të veçantë”, pasi një treg i parregulluar kundërshton premisat e domosdoshme për pjesëmarrjen e të gjithëve.

*Premisat e
lindjes
dhe faktori i
pasigurisë?
Si është
pozicionuar
kapitalizmi i
tregut
ndaj
demokracisë?*

Pra, Meyer-i përshkruan raportin e sistemit ekonomik dhe demokracisë me dy teza: ai analizon nga njëra anë historikisht kushtet e lindjes së demokracive. Nga ana tjetër analizon në mënyrë empirike bashkëveprimin e demokracisë dhe ekonomisë së tregut për shoqëritë e sotme.

Këto dy teza fillimisht nuk janë të vetëkuptueshme. Ato janë krejt teorike, por edhe politikisht të diskutueshme, sikurse e kemi parë tashmë më sipër.

Pra çfarë e shtyn Meyer-in të përfaqësojë këtë tezë

Me gjithë kundërgargumentet me peshë?

*Si e
argumenton
Meyer-i tezën
e tij?*

4.1.1. Argumentimi historik

Fillimisht kemi të bëjmë me një argument historik: Për Meyer-in ka rëndësi të analizojë se demokracitë në histori, përgjithësisht, janë krijuar pas ose në një lidhje direkte me lindjen e tregjeve të lira – në Evropë kjo ka ndodhur me zhvendosje në kohë në vende të ndryshme si një „model i shoqërisë borgjeze“:

*Argumenti
historik*

„Shoqëria borgjeze mendonte një model të rendit ekonomik, social dhe politik, i cili gjatë kapërcimit të absolutizmit, privilegjeve të trashëguara nga lindja dhe tutelës klerikale realizon parimin e lirisë individuale të rregulluar juridikisht për të gjithë, që siguron bashkëjetesën e njerëzve në përputhje me arsyen, që organizon ekonominë në formë tregu mbi bazën e konkurrencës së rregulluar me ligj, që siguron shanse jetese në përputhje me arsyen, që kufizon pushtetin shtetëror në kuptimin e shtetit liberal të së drejtës dhe kushtetues nga njëra anë, dhe nga ana tjetër nëpërmjet publikut e lidh zgjedhjen e organeve përfaqësuese me vullnetin e qytetarëve të pjekur“. (Kocka 1995: 23)

Tregjet e lira, borgjezia ekonomike dhe një përfytyrim i të drejtave të lirisë si edhe garantimi i tyre nga shteti janë zhvilluar në varësi të ndërsjellë – historikisht ato nuk mund të ndahen nga njëra tjetra.

4.1.2. Argumentimi nga studimet krahasuese të demokracisë

Teza e Meyer-it mbështetet edhe nga shumë studime empirike, të cilat janë kryer në kuadrin e kërkimeve shkencore mbi stabilitetin e demokracive.

Edhe rezultatet empirike të punës kërkimore mbi transformacionin, që para së gjithash ka analizuar shtetet e ish Bashkimit Sovjetik, tregojnë se ekonomitë e tregut të lirë mund të qëndrojnë në një raport pozitiv stabilizues me demokracitë e reja që sapo krijohen. Por edhe në rastin e anasjelltë, rezultatet empirike tregojnë: aty ku pushteti ekonomik ndërhyr në lëmin politik, aty ku gërryhet pjesëmarrja demokratike në favor të monopoleve dhe lidhjeve të grupazheve, aty rruga të çon në një demokraci me defekte e gjithsesi formale.

Kjo tregon pretendimin e një teorie të demokracisë sociale, jo vetëm për të parë përbërjen formale të një shteti, por edhe për të provuar në mënyrë empirike, nëse strukturat demokratike dhe të drejtat bazë perceptohen faktikisht nga secili person i veçantë.

Panorama e përgjithshme – kështu argumenton Meyer-i –na lejon të tregojmë se një ekonomi e lirë e tregut mund të „favorizojë“ demokracinë (krahaso: Dahl 2000: 140; Meyer 2005: 581).

Natyrisht kjo nuk do të thotë se Meyer-i sheh një raport të „thjeshtë“ apo jokritik mes demokracisë dhe kapitalizmit – kjo në bazë të kontradiktave që janë përshkruar më sipër, as që nuk mund të supozohet. Pra, me sa duket, duhet të bëjmë dallimin mes diskutimit të sotëm dhe lindjes së tij historike.

*Argumentimi
nga kërkimi
shkencor i
stabilitetit
të demokracive*

*Tensioni i
veçantë i
demokracisë
dhe
kapitalizmit*

Ku e kundërshton kapitalizmi i tregut demokracinë:

- Kapitalizmi i tregut çon në pabarazinë (ekonomike) midis njerëzve.
- Resurset materiale të shpërndara në mënyrë të ndryshme të çojnë në mundësi të ndryshme për të marrë pjesë në shoqëri dhe demokraci.
- Kapitalizmi i tregut funksionon duke u rritur në mënyrë globale, kurse vendimmarrja e përbashkët demokratike bëhet natyrisht gjerësisht në rrafshin nacional. Në këtë mënyrë kapitalizmi i tregut rrezikon edhe strukturat demokratike në vendet e veçanta.

Ekuilibri midis kapitalizmit të tregut dhe demokracisë si marrëveshje midis aktorëve

Kapitalizmi i tregut përmban forca centrifuge që nxitin pabarazitë dhe pasiguritë, e për pasojë mund të rrezikojnë bazat e legjitimitetit dhe stabilitetit demokratik.

Liria e tregjeve dhe liria e të gjithë njerëzve kundërshtojnë njëra-tjetrën.

Kapitalizmi i tregut dhe demokracia – argumenton Meyer-i – qëndrojnë kundrejt njëri-tjetrit në një tension të veçantë.

Ky tension i veçantë nuk mund të largohet thjesht apo të mohohet, ai të lejon vetëm ta formatosh – kjo është kuintesenca nga studimi kërkimor historik dhe empirik që Meyer-i e sjell si argumentimin e tij.

Po t'u kthehemi pas modeleve të ndryshme të mendimit të liberalizmit dhe demokracisë sociale mund të konstatojmë: Të heqësh dorë nga pretendimi për lirinë, i cili historikisht lidhet me traditën e mendimit të liberalizmit, kjo do të ishte fatale, njëlloj si të bije në kurthin e ngushtimeve neoliberales. Ta vështrosh raportin e liberalizmit dhe demokracisë sociale në mënyrë të diferencuar, ky është një gur themeli esencial.

Meyer-i në teorinë e tij dallon lidhur me këtë dy “tipa idealë”, të cilët janë zhvilluar nga teoria liberale: nga njëra anë kemi tipin e “libertarianizmit”, nga ana tjetër tipin e “demokracisë sociale”.

Detyra për teorinë e demokracisë sociale: Të mos hiqet dorë nga pretendimi i lirisë i liberalizmit




Fig. 8: *Paradoksi i teorisë së demokracisë*

4.2. Libertarianizmi vs. demokracia sociale

Teoria e demokracisë sociale në aspektin normativ, teorik dhe empirik dallohet nga teoritë e demokracisë libertariane. Të dyja i kanë rrënjët në demokracinë liberale, ashtu si është zhvilluar ajo që nga iluminizmi në shekullin e 17-të dhe 18-të.

Konceptet e „demokracisë libertariane” dhe „liberale” pjesërisht në argumentimet e tjera shkencore konceptohen ndryshe. Prandaj, një përkufizimi pastër, i përbashkët është veçanërisht i rëndësishëm në këto diskutime.

Në libertarianizëm dhe demokracinë sociale kemi të bëjmë – kjo është theksuar shprehimisht – me tipa idealë, të cilët në formën e pastër sigurisht që nuk mund të gjenden askund. Për më tepër libertarianizmi

dhe demokracia sociale përkufizohen si pole midis të cilëve shoqëritë renditen duke mbajtur parasysh formën e tyre shoqërore.




Fig. 9: Demokracia liberale, libertariane dhe ajo sociale në krahasim

Reñnjët e përbashkëta të demokracisë liberale

- i referohen traditës evropiane të liberalizmit (krahaso: shumë më sipër, faqe 11)
- dhe ekzistojnë në një demokraci pluraliste të shtetit të së drejtës,
- e cila mbështetet në të drejtat e njeriut.

Demokracia²¹ libertariane karakterizohet si model mendimi i tipit ideal nga

- Prona e pa lidhur në aspektin social Një treg i vet rregulluar
- Kufizimi i demokracisë në fushën politike dhe nëpërmjet tij sigurimi

21. Shihet se „libertarianizmi“ apo tipi libertarian mbulohet gjerësisht nga ajo që tashmë është diskutuar më lartë nën cilësimin e pozicioneve neoliberalë. Meyer-i me futjen e konceptit të ri kërkon, në radhë të parë, të tregojë se përfytyrimet esenciale të liberalizmit historik nuk janë aspak identike me shkurtime të neoliberalë, pra, që edhe liberalizmi është i aftë për t'u lidhur me Teorinë e demokracisë sociale.

i të drejtave negative të lirisë (lidhur me konceptin shih më poshtë, faqe 102)

- Vlefshmëria formale e të drejtave të njeriut

Ndërsa demokracia sociale karakterizohet nga:

- Të drejtat bazë në fushën shoqërore dhe ekonomike
- Një kushtetutë e shoqërisë që respekton të drejtat themelore (si nga ana formale ashtu edhe në realitet) Të drejtat negative dhe pozitive të lirisë në vlefshmërinë formale dhe funksionimin real (për këtë do të lexoni më poshtë më shumë)

Pra Meyer-i midis dy tipave ideale të demokracisë libertariane dhe sociale ndërmerr një diferencim teorik, që lidhet me pozicione konkrete politike të rrymave dhe partive të veçanta, por që nuk ezaurohet plotësisht në to.

Tensioni midis demokracisë dhe kapitalizmit të tregut nuk i nënshtrohet asnjë rendi të përcaktuar, përkundrazi mbushet nga marrëveshjet dhe kompromiset midis aktorëve shoqërorë. Raporti i forcave midis tyre mund të zhvendoset vazhdimisht dhe të çojë në një raport të ri midis kapitalizmit të tregut dhe demokracisë në vende të ndryshme.

Si shembull për raportin plot tension, jo shumë të thjeshtë, midis kapitalizmit të tregut dhe demokracisë dhe për organizimin e tyre mund të shohim Ligjin Themeltar Gjerman (GG) krahasuar me paktet e OKB-së mbi të drejtat bazë politike, sociale, ekonomike dhe kulturore (Krahaso: më poshtë, faqe 99).

Ndërsa kushtetuta e vitit 1949 vërtet formulonte qartë të drejtat mbrojtëse të lirisë nisur nga sfondi i regjimit nazist, konstelacioni i forcave në Republikën Federale që po krijohet, midis forcave borgjeze nga njëra anë dhe të majtës politike nga ana tjetër, bëri që të drejtat mundësuese të lirisë në Ligjin Themeltar të mbeten të përcaktuara zbehtë. Edhe në diskutimin juridik shkencor ka, për pasojë, qasje të ndryshme interpretimi për Ligjin Themeltar: Njëra palë mendon se përcaktimi i të drejtave bazë në nenet e para është gjëja kryesore, ndërsa interpretime të tjera më kritike nisen nga fakti që para së gjithash çështja e pronës (private) ka qenë dhe është strumbullari vendimtar (krahaso rreth kësaj Haverkate 1992; shih për këtë edhe tabelën lidhur me të drejtat bazë në krahasimin midis Ligjit Themeltar Gjerman dhe pakteve të OKB-së në faqen 99).

*Demokracia
sociale*

*Pyetja rreth
aktorëve*

*Shembull:
negociatat e
kushtetutës*

Në paktet e OKB-së në vitet 1960-të është zhvilluar një formulim i të drejtave negative dhe pozitive të lirisë, i cili shkon shumë larg, nisur nga perspektiva ndërkombëtare, por edhe nga zhvillimi i atëhershëm shoqëror.

Teoritë shkencore – sikurse është përshkruar më sipër - japin përgjigje të ndryshme kur përshkruajnë raportin midis tregut dhe demokracisë.

Rymat teorike të të ashtuquajturit libertarianizëm dhe Teoria e demokracisë sociale ndryshojnë, para së gjithash, në përgjigjen e pyetjes se si sillen (duhet të sillen) ndaj njëri-tjetrit demokracia dhe tregu dhe si mund të jetë argumentimi respektiv i tyre.

Të dy rymat teorike këtu kanë të njëjtat rrënjë: liberalizmin, ashtu si është zhvilluar ai historikisht që nga shekulli i 17-të.

Pra strumbullari i kësaj çështje është se si do të realizohet liria e çdo njeriu në shoqëri. Për këtë, teoritë shkencore japin përgjigje shumë të ndryshme.

Që të mund të vlerësojmë përgjigjet e ndryshme, për këtë është e domosdoshme të përcaktojmë më nga afër konceptin e “të drejtave të lirisë”.

Por, përpara se të mund të vëzhgojmë përkufizimet e ndryshme të të drejtave të lirisë në libertarianizëm nga njëra anë dhe në demokracinë sociale nga ana tjetër, duhet bërë edhe një shpjegim koncepti: Pse bëhet fjalë për “të drejtat e lirisë”? Pse jo thjesht “liri” dhe “vlera bazë”?

*Pyetja
vendimtare:
si realizohet
liria në
shoqëri?*

4.3. Ekskurs: Trio e vlerave bazë, të drejtave themelore dhe instrumenteve

Në pjesën e parë kemi parë se teoritë politike dhe filozofët kanë koncepte shumë të ndryshme për tri vlerat bazë të lirisë, barazisë dhe solidaritetit. Pra kemi të bëjmë me një “pluralizëm argumentimi”, i cili përshkon modelet e mendimit politik dhe rrymat politike.

Për një teori gjithpërfshirëse ky pluralizëm argumentimi fsheh një problem: Në qoftë se teoria do t’u referohet aspekteve të veçanta apo linjave të argumentimit, atëherë ajo do të humbasë pretendimin e saj të përgjithshëm dhe e izolon potencialisht argumentimin e saj nga traditat e tjera filozofike, etnike dhe religjioze.

Një teori e demokracisë sociale për këtë arsye – kështu argumenton Thomas Meyer-i - duhet të zgjedhë një bazë mundësisht sa më të gjerë të argumentimit. Për këtë duhet gjetur një rrafsh argumentues, i cili të mos jetë i karakterizuar nga specifika kulturore, por që të lejon ta përshkruash nga një kuadër gjithpërfshirës dhe i legjitimuar demokratikisht.

Kështu rrafshi i vlerave bazë nuk mund të merret parasysht si bazë argumentimi – ato vërtet që formojnë një kontekst të rëndësishëm argumentativ, por janë variable dhe të lidhura ngushtë me kulturat specifike.

Argumentimi i drejtë për një arsyetim të demokracisë sociale duhet kërkuar në një rrafsh tjetër. Në vija të trasha mund të dallohen tri rrafsh:




Fig. 10: Prejardhja e vlerave bazë, të drejtave themelore dhe instrumentet

*Trio e vlerave
bazë,
të drejtave
themelore
dhe
instrumenteve*

*Cila është
baza
argumentuese
më e gjerë e
mundshme?*

Tri rrafshet

Në rrafshin e vlerave bazë të lirisë, barazisë dhe solidaritetit shpjegohet se në çfarë relacioni është personi i veçantë me shoqërinë dhe si duhet të zhvillohet jeta në shoqëri. Përfytyrimet mbi shoqërinë që përcaktojnë për vete vlerat bazë dhe i pretendojnë ato, rrjedhin – sikurse e kemi parë më sipër - nga qasje të ndryshme politiko-shoqërore dhe filozofike-shoqërore.

Në rrafshin e të drejtave themelore, vlerat bazë kthehen dhe transformohen në norma veprimi shoqërisht të detyrueshme, të legjitimuara demokratikisht. Ato nuk i nënshtrohen një pluralizmi të argumentimit (si vlerat bazë), por rregullojnë bashkëjetesën, pavarësisht nga argumentimet shoqërore.

Në rrafshin e instrumenteve përcaktohen institucionet shoqërore, me anë të të cilave shtetet dhe bashkësitë e shteteve duhet të garantojnë kërkesat e veprimit, të cilat rrjedhin nga siguri i të drejtave themelore. Ato dallohen pjesërisht qartë për vende dhe kultura të ndryshme, sikurse tregojnë studimet e vendeve.

Në qoftë se duam të zgjedhim një bazë sa më të gjerë që të jetë e mundur të argumentimit për teorinë e demokracisë sociale, për këtë duhet të marrim si pikënisje rrafshin e të drejtave themelore. Meyer-i zgjedh si bazë argumentimi dy paktet e OKB-së mbi të drejtat themelore politike, ekonomike dhe kulturore. Argumente të shumtë flasin për këtë zgjedhje:

- Paktet e OKB-së janë burimi botëror më i unifikuar dhe juridikisht i detyrueshëm për të drejtat themelore përtej kufijve kulturorë dhe të vendeve. Paktet e OKB-së janë ratifikuar dhe janë bërë kështu e drejtë e pranuar në më shumë se 140 vende të botës.
- Paktet e OKB-se mbështesin dhe janë për zhvillimin shoqëror dhe shpalosjen e të drejtave themelore në bashkëpunim ndërkombëtar. Shtetet obligohen për një përmirësim të vazhdueshëm për realizimin faktik të të drejtave themelore.
- Paktet e OKB-së përmbajnë, të shprehur qartë, formulime të gjera dhe të sakta mbi të drejtat që mund të pretendojnë të kenë individët e veçantë.

Argumenti i fundit na lejon ta ilustrojmë veçanërisht mirë, në bazë të një krahasimi midis të drejtave themelore në Ligjin Themeltar Gjerman dhe formulimeve në paktet e Kombeve të Bashkuara:

Fusha e rregullave	Ligji Themeltar	Paktet e OKB-së
E drejta e individit	„Dinjiteti i njeriut është i paprekshëm. Respektimi dhe mbrojtja e tij është obligim i të gjithë pushteteve shtetërore.” (Neni 1)	“Çdo njeri që në lindje ka të drejtën për të jetuar. Kjo e drejtë duhet mbrojtur me ligj. Asnjërit nuk lejohet t’i merret jeta në mënyrë arbitrare.” (Neni 6, paragrafi 1 Pakti i OKB-së PR)*
E drejta për punë	“(1) Të gjithë gjermanët kanë të drejtë të zgjedhin lirisht profesionin, vendin e punës dhe vendin e shkollimit. Ushtrimi i profesionit mund të rregullohet me ligj ose me anë të një ligji. (2) Asnjëri nuk lejohet të detyrohet për një punë të caktuar, përveçse në kuadrin e detyrimit të zakonshëm e të përgjithshëm të shërbimit publik, që është për të gjithë njësoj.” (Neni 12)	“(1) Shtetet që kanë nënshkruar kontratën, njohin të drejtën për punë, e cila përfshin të drejtën e çdo individi të veçantë mbi mundësinë për të jetuar nëpërmjet punës së tij të zgjedhur dhe të pranuar lirisht, dhe ndërmarrin hapat e duhur për mbrojtjen e kësaj të drejte. (2) Hapat e ndërmarrë nga secili shtet që ka nënshkruar kontratën për realizimin e plotë të kësaj të drejte përfshijnë konsulencë speciale dhe profesionale dhe programe kualifikimi si dhe vendosjen e parimeve dhe procedurave për arritjen e një zhvillimi të vazhdueshëm ekonomik, social dhe kulturor dhe të një punësimi të plotë produktiv në kushtet që mbrojnë liritë bazë politike dhe ekonomike të individit.” (Neni 6 Pakti i OKB-së WSKR)**

Paktet e OKB-së dhe Ligji Themeltar në krahasim

* Pakti ndërkombëtar mbi të drejtat qytetare dhe politike i 19 dhjetorit 1966 (cit. sipas Heide Meyer 1997: 235-244)

** Pakti ndërkombëtar mbi të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore i 19 dhjetorit 1966 (cit. sipas Heide Meyer 1997: 244-250)

Fusha e rregullave	Ligji Themeltar	Paktet e OKB-së
Prona/standardi i jetesës	"(1) Prona dhe e drejta e trashëgimisë sigurohen. Përmbajtja dhe kufizimet përcaktohen me ligj. (2) Prona ka detyrime. Përdorimi i saj duhet t'i shërbejë njëkohësisht mirëqenies së përgjithshme." (Neni 14)	"(1) Shtetet kontraktuese njohin të drejtën e çdo personi për një standard jetese të përshtatshëm, për vete dhe familjen e tij, duke përfshirë edhe ushqimin, veshjen dhe banesën e mjaftueshme, si edhe për një përmirësim të vazhdueshëm të kushteve të jetesës. Shtetet kontraktuese ndërmarrin hapat e duhura për të siguruar realizimin e kësaj të drejte dhe njohin për këtë qëllim rëndësinë vendimtare të një bashkëpunimi ndërkombëtar, të bazuar mbi aprovimin e lirë." (Neni 11 Pakti i OKB-së WSKR)**
Arsimimi	"(1) Secili ka të drejtë për shpалosjen e lirë të personalitetit të tij kur nuk cenon të drejtat e të tjerëve dhe kur nuk bie ndesh me rendin kushtetues apo ligjin zakonor." (Neni 2) "(1) I gjithë arsimi është nën kujdesin e shtetit. (2) Personat që kanë të drejtën e kujdestarisë kanë të drejtë të vendosin mbi pjesëmarrjen e fëmijës në mësimin e religjonit." (Neni 7).	"(1) Shtetet kontraktuese njohin të drejtën e çdo personi për arsimim. Ata bien dakord, se arsimimi duhet të drejtohet drejt shpалosjes së personalitetit njerëzor dhe vetëdijes së dinjitetit të tyre dhe se duhet të forcohet respektimi i të drejtave të njeriut dhe lirive bazë. Ata kanë rënë gjithashtu dakord, që arsimimi duhet t'i mundësohet çdo personi, që të luajë një rol të dobishëm në një shoqëri të lirë, që të nxisë mirëkuptimin, tolerancën dhe miqësinë midis të gjithë popujve dhe gjithë grupeve të racave, etnive dhe religjoneve dhe se duhet të mbështetet aktiviteti i Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes. (2) Shtetet kontraktuese njohin se në drejtim të realizimit të plotë të kësaj të drejte a) duhet që mësimi në shkollën bazë duhet të jetë detyrim për secilin dhe të jetë i mundur e pa pagesë për të gjithë. [...] c) Mësimi në shkollën e lartë duhet të mundësohet në çfarëdo mënyre të mundur, veçanërisht nëpërmjet futjes graduale të shkollimit pa pagesë, në mënyrë që çdo njeri, në mënyrë të barabartë, të ketë akses në përputhje me aftësitë e tij." (Neni 13 Pakti i OKB-së WSKR)**

Dy paktet e Kombeve të Bashkuara japin një panoramë të diferencuar se si duhet të realizohen të drejtat themelore hap pas hapi dhe nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar. Në paktin për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore thuhet:

“Çdo shtet kontraktues obligohet, vetëm ose nëpërmjet ndihmës dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, veçanërisht të llojit ekonomik dhe teknik, duke ezauruar të gjitha mundësitë e tij, të marrë masa për të arritur hap pas hapi, me të gjitha mjetet e nevojshme, në radhë të parë me masa ligjore, realizimin e të drejtave të njohura në këtë pakt.” (Neni 2 Paragrafi 1)

Paktet e OKB-së kanë shënuar një perspektivë zhvillimi, një detyrim veprimi për shtetet për të nxitur pa ndërprerje dhe me të gjitha mjetet e duhura realizimin e të drejtave themelore ekonomike, sociale dhe kulturore, bazuar mbi të drejtat politike të siguruara si bazë. Kjo e fundit përmban një kërkesë veprimi drejtuar shteteve si edhe portretin e një shteti aktiv.

Pikërisht një shtet që angazhohet në mënyrë aktive, duke garantuar jo vetëm të drejtat themelore, por edhe që i krijon ato nëpërmjet veprimit të tij aktiv, është një shtet që kundërshton demokracinë libertariane.

Por kujdes: Në shumë vende realizimi i të drejtave bazë ndesh në vështirësi madhore. Pretendimi i së drejtës dhe realizimi i së drejtës janë shumë larg nga njëra-tjetra. Dhe kështu pyetjet kritike se sa vlerë kanë paktet e OKB-së, janë të kuptueshme. Mungojnë institucionet e afta për të vepruar në rrafshin ndërkombëtar.

E megjithatë mbetet për t’u shënuar se në krahasim me Ligjin Themeltar Gjerman paktet e Kombeve të Bashkuara përmbajnë një formulim shumë më preciz të të drejtave themelore që mund të shërbejnë si bazë e pretendimeve për një demokraci sociale.

Vërtet që Ligji Themeltar në nenin 20 flet për Republikën Federale të Gjermanisë si një shtet federal demokratik dhe social. Obligimet e veprimit, ashtu sikurse i parashikojnë paktet e OKB-së, këtu përmenden në mënyrë shumë të kufizuar.

Që roli aktiv i shtetit në realizimin e tyre është i diskutueshëm, këtë e konstatojmë edhe në një diferencim tjetër të të drejtave themelore. Aty tregohet gjithashtu se edhe vetë një libertarianizëm konsekuent në mendime mund të kundërshtojë veten.

Perspektiva e zhvillimit të pakteve të OKB-së

Por: Në botë paktet e OKB-së shkelen, sepse mungojnë mundësitë e zbatimit të tyre

4.4. Të drejtat pozitive dhe negative të lirisë

*Përkufizimi:
të drejtat
pozitive dhe
negative
të lirisë*

Demokracia liberale përkufizohet në radhë të parë nëpërmjet të drejtave të lirisë, që i përkasin çdo njeriu në shoqëri. Në të drejtat e lirisë – sipas Isaiah Berlin-it – mund të dallojmë midis të drejtave të lirisë negative (formale, mbrojtëse) dhe pozitive (që mundësojnë në aspektin social).

Demokracia libertariane dhe ajo sociale dallohen dukshëm nga njëra-tjetra nga rëndësia që u kushtojnë të drejtave negative dhe pozitive të lirisë në raport me njëra tjetrën.

Në *Teorinë e demokracisë sociale* të Meyer-it kjo është një pikë esenciale qasjeje, që mund ta formulojë qartë dhe në mënyrë precize diskutimin mbi të drejtat e lirisë. Aty – sikurse është treguar tashmë më sipër - duhet nisur nga një diskutim filozofik mbi tipat idealë, përtej pyetjes nëse tipat idealë vërtet ekzistojnë në vendet e ndryshme (ata nuk ekzistojnë në formë të pastër).

Në këtë argumentim filozofik demokracia libertariane dallohet nga demokracia sociale si më poshtë:

Teza libertariane

Garantimi i të drejtave pozitive të lirisë cungon (dhe shkatërron) të drejtat negative të lirisë. Të drejtat negative të lirisë kanë prioritet absolut - kjo është (e shkurtuar) teza e Berlinit, e cila përfaqësohet sot edhe nga shumë neoliberalë.

Teza e Teorisë së Demokracisë Sociale

Të drejtat negative dhe pozitive të lirisë duhen mbajtur parasysht në nivel të barabartë, kur duam që ato të kenë vlefshmëri formale dhe të veprojnë për të gjithë.

Isaiah Berlin në librin e tij “Two Concepts of Liberty” të vitit 1958 dallon midis dy të drejtave të ndryshme të lirisë:

- Të drejtat negative të lirisë (për shembull, e drejta e pacenueshmërisë fizike) që sigurojnë mbrojtjen nga ndërhyrjet e shtetit dhe të shoqërisë
- Të drejtat pozitive të lirisë (për shembull, e drejta për arsimim), të cilat mundësojnë dhe duhet të nxitin lirinë e individit nëpërmjet masave të shtetit dhe të shoqërisë.

*Teza
libertariane*

*Teza e teorisë
së demokracisë
sociale*




Fig. 11: Të drejtat negative dhe pozitive të lirisë.

Ky dallim midis demokracisë libertariene dhe asaj sociale kërkon një vëzhgim më nga afër, se si sillen të drejtat negative dhe ato pozitive të lirisë me njëra-tjetrën.

Meyer-i këtu kundërshton logjikisht argumentimin libertarian:

Argumentimi libertarian u jep të drejtave negative të lirisë përparësi absolute ndaj të drejtave pozitive të lirisë, ndërsa Teoria e Demokracisë Sociale pretendon për një relacion plot tension dhe nivel të barabartë.

Teoria e Demokracisë Sociale kundërshton në këtë relacion tezën libertariene dhe provon lidhjen e të drejtave pozitive dhe negative të lirisë.

Premisa

Argumentimi i Meyer-it mbështetet mbi një katërhapësh argumentues. Fillimisht ai niset nga premisa se edhe në argumentimin libertarian të drejtat negative të lirisë janë me vlerë universale dhe duhet të veprojnë si të tilla – për argumentimin libertarian duhet të jenë dhënë vetëm të drejtat negative të lirisë me përparësinë e tyre absolute.

Kur quhet e kundërshtuar teza libertariene?

Teza libertariene do të ishte kundërprovuar në qoftë se do të kishte një konstelacion, në të cilin të drejtat negative të lirisë nuk do të mund të vlenin për një person, pasi nuk sigurohen të drejtat pozitive të lirisë.

Kundërshtimi me anë të një shembulli

Dhe ky konstelacion mund të imagjinohet lehtësisht: Një person që nuk ka asnjë të drejtë pozitive të lirisë, formalisht të vlefshme dhe realisht ndikuese, për arsimim, që nuk disponon një infrastrukturë mundësuese për një pjesëmarrje në jetën shoqërore dhe që vetë nuk mund të blejë dot oferta arsimimi me anë të kapitalit, atëherë e drejta e tij negative e lirisë nuk mund të përdoret për shprehjen e mendimit të lirë. E drejta negative e lirisë do të ishte një kartë pa vlerë.

Konkluzion: Bashkëveprimi i të drejtave pozitive dhe negative të lirisë

Në mënyrë që të drejtat negative të lirisë të mos jenë vetëm formale, por të mund të veprojnë për të gjithë njerëzit, duhen siguruar të drejtat pozitive të lirisë. Kjo do të thotë gjithashtu se pasuria në shoqëri duhet të marrë parasysh edhe rishpërndarjen. Kjo paraqet një ndërhyrje shumë të vogël në të drejtat negative të lirisë (mbi pronën).

Duke menduar në mënyrë konsekuente mund të themi, se përparësia absolute e të drejtave negative të lirisë nuk mund të funksionojë. Të drejtat negative të lirisë nuk mund të jenë të vlefshme dhe funksionale për të gjithë, kur ato nuk plotësohen nga të drejtat pozitive të lirisë.

Të drejtat negative të lirisë mund të funksionojnë për të gjithë vetëm atëherë kur garantohen edhe të drejtat pozitive, pra “mundësuese” të lirisë. Të drejtat e lirisë të siguruara formalisht nuk ndihmojnë më tej, kur ato nuk janë të batueshme si pretendim për çdo person përballë shtetit.

Pa një rishpërndarje shoqërore të të mirave, zakonisht të organizuar nga shteti, realizimi i të drejtave të lirisë nuk është i mundur për të gjithë. Përfundimi i Meyer-it është se vendosja e një ekuilibri midis të drejtave negative dhe pozitive të lirisë duhet biseduar dhe realizuar në rrugë shtetërore.

4.5. Detyrimet e shtetit për të vepruar

Realizimi i të drejtave pozitive dhe negative të lirisë për çdo njeri paraqet një detyrim të shtetit për të vepruar. Ndryshe nga sa ndodh në një shtet libertarian, këtu kërkohen jo vetëm të drejtat themelore, ndërkohë që realizimi i lihet tregut. Pretendimet për një funksionim real të të drejtave themelore të çdo individi, për më shumë duhen mbajtur përballë shtetit.

Kështu shteti merr një rol aktiv dhe ka detyrime për të vepruar, para së gjithash:

- Për t'u kujdesur për një infrastrukturë të lirë, të hapur, që të sigurojë akses si për shanse, ashtu edhe për kujdesin e ekzistencës jetësore.
- T'u krijojë njerëzve nëpërmjet rishpërndarjes shoqërore mundësitë që të marrin pjesë aktivisht dhe me vullnetin e tyre në shoqëri dhe demokraci.
- Ta integrojë ekonominë e tregut formalisht aq sa të ruhen dhe të mund të përfaqësohen lirisht strukturat demokratike dhe interesat e punëmarrëseve dhe punëmarrësve.

Instrumentet shtetërore, me të cilat realizohen këto pretendime të qytetareve dhe qytetarëve, në vende të ndryshme nuk janë njësoj. Këtë mund ta paraqesim me një shembull të thjeshtë:

Në Republikën Federale që nga vitet 1890-të është zhvilluar një sistem i sigurimeve shoqërore. Sistemi i sigurimeve shoqërore luan një rol thelbësor që njerëzit, si rregull, të mund të bëjnë një jetë të denjë njerëzore. Në të njëjtën kohë, ky sistem ka krijuar shtratin e tij nëpërmjet solidaritetit të punëtorëve dhe punëtorëve dhe i ka siguruar qeverisë – si organizatore – lojalitetin për shtetin e ngritur.

Vende të tjera – për shembull, ato skandinave – kanë një sistem social që mbështetet mbi taksat. Edhe këtu, sikurse mund të shihet në studimet krahasuese për vendet e ndryshme (krahasojmë poshtë, faqe 109), flitet për një kujdes të ekzistencës dhe për përmbushjen e një pretendimi të çdo individi ndaj shtetit. E megjithatë krahasimi midis sistemeve na lejon të shohim dallimet graduale në sukseset për të zbatuar të drejtat pozitive dhe negative të lirisë.

*Detyrimet
e shtetit për të
vepruar*

*Detyrimet
më të
rëndësishme*

*Instrumentet
që varen nga
rruga*

Por, detyrimi i veprimit nga të drejtat e lirisë mbahet (pak a shumë mirë) nga të dy format e organizimit.

Realizimi i të drejtave të lirisë nuk ezaurohet vetëm nga çështja e instrumenteve konkrete, por edhe nga fakti që këta të fundit mund e duhen kontrolluar.

Demokracia sociale është një model mendimi gjithëpërfshirës që nuk mbetet te vlefshmëria formale e të drejtave të njeriut. Aq më pak ajo është një karabina e ngritur filozofike. Shumë më tepër ajo duhet të na bindë si një model i hapur që të drejtojë busullën për veprime politike, nga të cilat pastaj të mund të realizohen, mundësisht sa më gjerësisht, të drejtat konkrete të lirisë me instrumente të ndryshme. Kështu që mund të arrihet të vihen në jetë vlerat bazë të lirisë, barazisë/drejtësisë dhe solidaritetit.

Demokracia sociale nuk është një luks teorik, por një sfidë dhe detyrë e përbashkët për praktikën.

5. MODELE VENDESH

Në këtë kapitull

- analizohen SHBA, Britania e Madhe, Gjermania, Japonia dhe Suedia lidhur me realizimin e demokracisë sociale
- bëhen dallimet mbi bazën e Teorisë së Demokracisë Sociale midis shteteve libertariane dhe demokracive sociale me përfshirje të ulët, të mesme dhe të lartë.

Shtetet mund t'i plotësojnë detyrimet për veprimet e tyre që rrjedhin nga të drejtat themelore, me instrumente të ndryshme.

Demokracia sociale nuk mund të përcaktohet si një shabllon i parapërgatitur. Ajo mund të ndryshojë në vendet e ndryshme në varësi nga rrugët që ndjekin. Por, meqenëse demokracia sociale nuk kënaqet me vlefshmërinë e thjeshtë formale të të drejtave të lirisë, ajo duhet provuar për çdo vend respektiv, nëse zhvillimi i varur nga rruga e ndjekur shkon në drejtimin e një demokracie sociale, nëse vendi respektiv e ka realizuar tashmë demokracinë sociale apo e tenton atë.

Thomas Meyer-i dhe bashkëpunëtorët dhe bashkëpunëtorët e tij për këtë qëllim kanë krahasuar të dhënat empirike të vendeve - shumë teori të demokracisë heqin dorë nga ky krahasim empirik.

Këtu janë prezantuar pesë shembuj të shkurtër që paraqesin shkallë të ndryshme realizimi të demokracisë sociale:

- SHBA-të si një vend i karakterizuar në linjat bazë pothuajse si libertarian me vetëm pak elementë që realizojnë demokracinë sociale
- Britania e Madhe si demokraci sociale me suport të ulët
- Gjermania si demokraci sociale me suport të mesëm
- Japonia, e cila edhe pse në shumë fusha nuk është e krahasueshme me botën perëndimore, mund të klasifikohet si demokraci sociale me suport të mesëm
- Suedia si demokraci sociale me suport të lartë.

Në mënyrë të pashmangshme studimet mbi vendet e ndryshme këtu janë kufizuar në një minimum. Kush dëshiron të merret më nga afër me një krahasim të vendeve të ndryshme duhet të shohë vëllimin e dytë të teorisë së Meyer-it (Meyer 2006).

*Kërkesa
veprimi
dhe zbatime
të ndryshme*

Pesë shembuj

5.1. SHBA

Nga Julia Bläsius

*SHBA:
Liria dhe
pabarazia
sociale*

SHBA për shumë njerëz janë vendi i mundësive dhe i lirisë. Njëkohësisht ato, në krahasim me Europën, janë të njohura për një pabarazi sociale më të madhe. Por çfarë fshihet pas kësaj pamje dhe nga se vjen kjo? E drejtë është se SHBA-të janë një vend, për popullsinë e të cilit liritë individuale në shumë fusha kanë prioritet, sa që shoqëria tradicionalisht e sheh me skepticizëm një shtet të fuqishëm. Arsyet për këtë janë një proces demokratizimi i vjetër dhe një kulturë politike e rritur, e cila ka lidhje me këtë. Kjo influencon aktorët, sistemin politik, trajtimin e të drejtave themelore si edhe karakterin e shtetit të mirëqenies.

SHBA-të ishin një nga demokracitë e para moderne të masave, çka ka krijuar një etos të fuqishëm republikan në shoqëri. Kushtetuta e vitit 1789 futi një të drejtë të përgjithshme për zgjedhjet. Ndërsa në Evropë demokracitë përgjithësisht zëvendësuan monarkitë dhe për pasojë gjetën struktura shtetërore centraliste të rritura për një kohë të gjatë, kurse në Amerikë demokracia lindi, si të thuash, në të njëjtën kohë me një shtet amerikan pasluftës së pavarësisë. Ky konstelacion ka karakterizuar deri sot kuptimin e shtetit dhe kulturën politike në SHBA. Shoqëria i jep vlerë të madhe lirisë individuale dhe dëshiron një shtet pasiv. Kjo çon në atë që pabarazitë sociale pranohen si rezultat i natyrshëm i bashkëjetesës njerëzore.

*Liria
si maksimumë
e lartë
e veprimt*

Përveç kësaj, kultura politike është e përcaktuar shumë fort nga liberalizmi, i cili e vendos lirinë individuale në plan të parë. Ndryshe nga Evropa, liberalizmi në SHBA nuk u vu kurrë në pikëpyetje nga rryma të tjera si konservatorizmi apo socializmi, kështu që ai u stabilizua si parim dominant pa alternativë. Madje akoma edhe sot liria është pasuria më e lartë e shoqërisë amerikane.

Për pasojë qeveria tradicionalisht nuk ka fare mundësi dhe para së gjithash ka pak ambicie për të influencuar ekonominë. Edhe kriza botërore financiare dhe ekonomike, e cila në SHBA ka jo vetëm prejardhjen e saj, por edhe pasojat më të gjera, shumë-shumë mund ta dobësojë këtë parim.

Bashkëpunimi i qeverisë amerikane me punëmarrëset dhe punëmarrësit karakterizohet nga një raport relativisht i dobët. Sindikatat janë shumë

pak të organizuara dhe nuk luajnë pothuajse asnjë rol, kështu që kontratat e punës dhe pagat diskutohen dhe vendosen në mënyrë të pavarur dhe individuale. Në këtë drejtim SHBA-të hasin një problem tipik të një demokracie pluraliste. Vërtet që interesat e ngushta kanë një influencë të lartë, por vetëm ato që janë të organizuara mirë e financiarisht të fuqishme. Interesat e gjera që janë organizuar dobët, gjejnë vetëm pak pasqyrim. Kjo duket në influencën e fortë të disa grupeve lobiste dhe shoqatave ekonomike si edhe në influencën e plogët të pakicave etnike.

Si shprehet kjo gjendje në sistemin politik dhe në arkitekturën e shtetit të mirëqenies amerikane? Dhe çfarë kuptimi i të drejtave themelore është në bazë të tij?

Sistemi politik

Në SHBA flitet për një sistem presidencial qeverisjeje me një strukturë dualiste, që përbëhet nga ekzekutivi dhe legjislativi. Ekzekutivi mbahet nga presidenti, i cili njëkohësisht është edhe kryetari i shtetit. Legjislativi përbëhet nga Dhoma e Përfaqësuesve dhe Senati, që të dy bashkë formojnë Kongresin. Legjislativi dhe Ekzekutivi janë të ndarë nga njëri-tjetri, e njëkohësisht janë të lidhur me njëri-tjetrin. Ky parim i “checks and balances” e ka prejardhjen nga filozofët e shtetit Montesquieu dhe John Locke dhe duhet të pengojë shpërdorimin e pushtetit. Qëllimi i këtij sistemi është mbrojtja e lirive individuale të qytetareve dhe qytetarëve nga pushteti i pajustificuar.

Partitë në SHBA tradicionalisht nuk kanë shumë influencë, kështu që konkurrenca e partive nuk ka ndonjë rol vendimtar. Ato përmbushin kryesisht funksionin e organizatave për fushatë zgjedhore, që organizojnë dhe zhvillojnë fushatën për kandidatët kryesorë të caktuar. Partitë, gjithashtu, nuk dalin me një program të fiksuar qeverisjeje dhe janë pak të orientuara nga ana programore. Në Kongres ato luajnë vetëm një rol të vogël, pasi së pari ato nuk janë të detyruara të mbështesin asnjë qeveri dhe së dyti i votojnë deputetët më tepër nisur nga gjendja e interesave personale se sa nga pikëpamjet ideologjike.

Kushtetuta dhe sistemi i të drejtave themelore

Kushtetuta amerikane e vitit 1789 hapet me formulën “Life, liberty and the pursuit of happiness” (Jetë, liri dhe përpjekje për lumturi). Ajo themelon një shtet federal me një sistem presidencial qeverisjeje. Ajo është një nga kushtetutat më të vjetra republikane që është akoma

*Çfarë do të
thotë kjo
konkretisht?*

*Sistemi
presidencial i
qeverisjes*

*Partitë
si organizata
për fushatë
zgjedhore*

*“Life, liberty
and
the pursuit of
happiness”*

edhe sot në fuqi. Qysh atëherë ajo futi një të drejtë të përgjithshme për zgjedhje – edhe pse ajo mund të shfrytëzohej vetëm nga burrat e bardhë me tokë në pronësi.

“Bill of Rights” që përfshin dhjetë shtojcat e para të kushtetutës, u garantojnë qytetareve dhe qytetarëve amerikanë përveç këtyre edhe disa të drejta të patjetërsueshme. Shpesh ato i cilësojnë si të drejta bazë. Ato janë projektuar dhe sanksionuar të gjitha për të mbrojtur individët nga ndërhyrjet e shtetit. Juridiksioni kushtetues në fuqi i bën këto të drejta për çdo individ të ekzekutueshme.

*Të drejtat
negative
të lirisë pa ato
pozitivat*

Kjo traditë e hershme e të ashtuquajturave të drejta politike bazë përcakton deri më sot kuptimin e të drejtave themelore të shoqërisë amerikane. Edhe pse këto të ashtuquajtura të drejta bazë qytetare apo të drejta negative të lirisë në kuadrin e masave antiterror pas 11 shtatorit 2001 janë kufizuar, ato luajnë në SHBA rol qendror. Ndërsa në të drejtat ekonomike dhe sociale ka deficite të gjera dhe për pasojë edhe në të drejtat pozitive të lirisë. Këto nuk përmenden as në kushtetutën amerikane, madje SHBA-të nuk kanë nënshkruar akoma ndonjë marrëveshje ndërkombëtare të kësaj natyre ku të jenë shkruar këto të drejta. Edhe shteti social nuk është institucionalizuar në kushtetutën amerikane. Për pasojë qytetarët dhe qytetarët kanë të drejtë të përfitojnë nga kujdesi social vetëm kur ata paguajnë siguracione ose e kanë të nevojshëm këtë shërbim. Por personave në nevojë nuk u janë garantuar këto të drejta, kështu që Kongresi mund të vendosë në çdo kohë të ndërpresë pagesat e transfertave.

Ekonomia politike

*Ekonomia
e pakoordinuar
e tregut*

SHBA-të përfshihen në tipin e ekonomisë liberale të tregut apo – e thënë ndryshe – të pakoordinuar. Kjo do të thotë se sipërmarrjet lëvizin në konkurrencë të lirë me njëra-tjetrën dhe nuk zhvillohet aspak kooperimi apo koordinimi me qeverinë apo me partnerët socialë. Aktiviteti ekonomik në SHBA mbështetet kryesisht në fitimin dhe rritjen e mirëqenies. (Disa sektorë, si për shembull, bujqësia dhe industria e armatimit, janë të përjashtuara nga ky mekanizëm i pastër i konkurrencës.)

Sindikatat dhe bashkimet e punëdhënësve, në vitet e fundit, kanë humbur gjithnjë e më shumë anëtarë dhe nuk kanë asnjë lloj influence në bisedimet tarifore apo në caktimin e kushteve të punës. Bisedimet mbi pagat në SHBA zhvillohen vetëm në nivel ndërmarrjeje dhe mbrojtja nga pushimet nga puna është shumë e dobët. Kjo i jep ekonomisë dhe

veçanërisht palës së punëdhënësve një masë të lartë fleksibiliteti, sa që mund ta marrësh një person shpejt në punë, por po kaq shpejt mund ta heqësh atë nga puna. Në përputhje me këtë është ngritur edhe sistemi i shkollimit dhe kualifikimit profesional, i cili u jep punëmarrësve aftësi profesionale dhe zanat të përgjithshëm.

Edhe sistemi financiar në SHBA është i drejtuar krejtësisht nga fleksibiliteti. Sipërmarrjet zakonisht financohen nëpërmjet tregut të kapitalit, ku rritja e Shareholder-Value, d.m.th. e fitimit të sipërmarrjeve brenda një afati të shkurtër, ka prioritetin më të lartë. Pleksje të sipërmarrjeve dhe bankave nuk ka fare në SHBA. Marrëdhëniet e sipërmarrjeve me njëra-tjetrën bazohen mbi marrëdhëniet e tregut apo në kontrata ligjërisht të detyrueshme. Sistemi financiar aspak i rregulluar i SHBA-ve dhe orientimi i thjeshtë drejt rritjes afatshkurtër të fitimit sipas tipit Shareholder-Value, për shkak të krizës financiare të nisur nga SHBA janë kritikuar ashpër.

Shteti social

Deri në shekullin e 20-të SHBA-të kishin vetëm një sistem sigurimi shumë rudimentar. Vetëm „Social Security Act” i vitit 1937 futi një sistem të sigurimit social në rrafsh kombëtar. Kjo përfshin një sistem pensionesh që mbështetet mbi kontributet, ndihmën sociale për familjet në nevojë, fëmijët dhe të moshuarit, një program federal për sigurimin e të papunëve. E megjithatë sot në SHBA flitet për një shtet liberal të mirëqenies, ku shërbimet shoqërore të vëna në dispozicion nga shteti nuk janë shumë përfshirëse dhe veprojnë pak në aspektin rishpërndarës. Ndërkohë një e treta e të gjitha shërbimeve sociale janë marrë nga privatët. Arsye për këtë, ndër të tjera, janë kultura politike e shoqërisë amerikane si edhe fakti që lidhet me të, pra që SHBA-të shumicën e kohës janë qeverisur nga republikanët ose demokratët e krahut të djathtë, të cilët shtetit social i kanë kushtuar pak prioritet. Prandaj shumica e sektorëve të shtetit social janë të orientuar shumë fuqishëm nga parimi i kontributit dhe sigurojnë vetëm në raste emergjence një minimum ekzistence për të penguar varfërinë. Një pyetje e hapur ka të bëjë me atë nëse kjo gjendje do të ndryshojë në vitet e ardhshme apo jo. Barack Obama gjatë fushatës së tij zgjedhore ka premtuar reforma për fushën sociale. Por sa e vështirë është të zbatosh këto reforma në Amerikën me formatim liberal, këtë po e tregojnë debatet për reformën shëndetësore.

*Orientimi sipas
Shareholder-
Value*

*Shteti social –
paraqitje
përmbledhëse
e vendosjes
së prioriteteve
në Amerikë*

Sigurimi i të papunëve: Edhe pse shtetet e veçanta federale përcaktojnë si nivelin e shërbimeve, ashtu edhe administrimin e programeve, sigurimi i të papunëve në SHBA financohet në mënyrë qendrore. Të papunët për gjashtë muaj kanë të drejtë të marrin mbështetje, e cila në situata të jashtëzakonshme mund të zgjatet edhe për disa javë. Pagesa e papunësisë është 30 deri 40% e rrogës së fundit.

Ndihma sociale: Ndihma sociale në SHBA është një masë kundër varfërisë, e cila me qëllim krejt të përcaktuar është e përqendruar vetëm te më të varfrit dhe shpesh çon në stigmatizimin e të prekurve. Përveç kësaj ka programe për grupe të caktuara, si për shembull, për fëmijët që janë në varësi, apo për familje në nevojë. Ata marrin përveç mjeteve financiare shpesh edhe mbështetje të veçantë, si bileta ushqimi.

Pensioni: Pensioni në SHBA funksionon nëpërmjet financimit të kontributeve. Qytetaret dhe qytetarët japin një të ashtuquajtur taksë nga rroga, e cila u siguron pastaj pretendimet për pension. Të drejtën për pension e kanë vetëm ata njerëz, të cilët më parë kanë bërë derdhjen e kontributit nga rroga e tyre dhe që kanë paguar taksën e rrogës, të tjerët janë në varësi të ndihmës sociale. Përveç kësaj ka edhe një kontribut tavan për taksën e rrogës, e cila i ngarkon relativisht pak ata që kanë të ardhura të larta.

Sistemi shëndetësor: Në SHBA nuk ka një sistem shëndetësor universal të financuar nga shteti. Vetëm tre grupe përfitojnë nga një shërbim shëndetësor shtetëror: ushtarakët, njerëzit mbi 65 vjeç dhe ata në nevojë, ku grupi i këtyre të fundit po rritet gjithnjë e më shpejt.

Pjesë të mëdha të shoqërisë në SHBA për një kohë të gjatë ose nuk ishin fare të siguruar, ose kishin vetëm siguracionin për rast sëmundjeje. Reforma e vendosur nga Presidenti Obama në sektorin e shëndetësisë është një drejtim i ri bazë i sistemit shëndetësor amerikan.

Sistemi arsimor

Sistemi shkollor ndryshon midis shkollave fetare dhe atyre publike, ku shkollat publike janë të organizuara dhe financuara në rrafsh lokal. Kjo, nisur nga pikëpamja e vetërregullimit dhe e pjesëmarrjes, është një avantazh, por çon në dallime të mëdha të cilësisë. Meqenëse shkollat financohen nga fondet e grumbulluara nga taksimi i të ardhurave, komunitat që kanë mirëqenie, pra që kanë mundësi të mbledhin më

SHBA		
Kuota e punësimit 2008	70,9% (65,5%)	Përqindja e personave të punësuar (gratë) në moshën 15-65 në raport me popullsinë e përgjithshme (Burimi: Eurostat)
Të ardhurat e grave, të matura me të ardhurat e burrave	62 %	Përqindja e të ardhurave që fitojnë gratë, krahasuar me burrat (Burimi: Human Development Index 2009, faqe 186)
Kuota e papunësisë 2008	5,8 %	Përqindja e papunësisë, matur me popullsinë aktive (Burimi: Eurostat)
Kuota e të papunëve për një kohë të gjatë 2008	0,6 %	Përqindja e të papunëve për një kohë të gjatë (12 muaj e më shumë) matur me popullsinë aktive (Burimi: Eurostat)
Pabarazia e të ardhurave/ koeficienti Gini 2009	40,8 %	Shifër matëse për shpërndarjen e pabarazisë të të ardhurave, sa më e lartë vlera, aq më e madhe pabarazia (Burimi: Human Development Report 2009, faqe 195)
Indeksi i varfërisë 2009	15,2 %	Indeksi i varfërisë del nga mbledhja e indikatorëve të ndryshëm (Jetëgjatësia, shkalla e alfabetizimit, aksesit në kujdesin shëndetësor...) 0 = varfëria minimale, 100 = varfëria maksimale (Burimi: Human Development Report 2009, faqe 180)
Arsimi: Varësia e suksesit të arsimit nga sfondi social-ekonomik 2006	17,9%	Përqindja në dallimet e produktivitetit midis nxënësve dhe nxënësve me sfond të ndryshëm social-ekonomik (Burimi: OECD 2007)
Shkalla e organizimit sindikalist 2007	11,6 %	Përqindja e popullsisë aktive për punë, e organizuar në sindikata (Burimi: OECD)

shumë fonde nga taksat, kanë edhe më shumë mundësi të investojnë shuma më të mëdha në sistemin arsimor, ndërsa komunat e varfra, shpesh herë, kanë mjete të pakta në dispozicion për arsimin. Prandaj, zona dhe mjedisi ku rritesh, shpesh vendosin mbi cilësinë e edukimit shkollor. E megjithatë sistemi amerikan i arsimit, përgjithësisht, nxjerr edhe përqindjen më të lartë të njerëzve që mbarojnë arsimin e mesëm.

Përfundimi

Sistemi politik si edhe shteti social në SHBA karakterizohen nga një shtet i dobët, pasiv, për të cilin ka rëndësi të garantojë për individët lirinë mundësisht sa më të madhe (negative). Të drejtat themelore politike kanë prioritet, ndërsa të drejtat sociale dhe ekonomike nuk luajnë asnjë rol. Pra, mund të themi se për të rregulluar gjendjen, shteti ose ndërhyrjet vetëm pak, ose aspak në treg dhe shoqëri.

Ky është rezultat i një sistemi politik të copëtuar, federativ dhe i një kulture liberale, fetare dhe republikane. Kjo çon në atë, që SHBA-të lidhur me indikatorët ekonomikë, si rritja ekonomike, vërtetë janë të pozicionuar relativisht mirë, por për sa u përket shifrave që tregojnë shkallën e përfshirjes sociale, kjo është akoma dobët.

Kështu SHBA-të, në krahasim me kombet e tjera industriale, kanë një nga kuotat më të larta të varfërisë. Edhe koeficienti Gini, i cili përkshkruan shkallën e pabarazisë, është relativisht i lartë. E matur me kriteret e demokracisë sociale, që presupozojnë garantimin si të lirive pozitive, ashtu edhe të atyre negative, SHBA-të janë të pozicionuara keq. Po të shohim të drejtat bazë, sistemin politik si edhe shtetin social, konstatojmë se kudo ka shumë elementë libertarianë. Është çështje e interpretimit, nëse SHBA-të do të cilësohen akoma si demokraci sociale me suport të ulët apo edhe si demokraci libertariane.

Por kjo e fundit ekziston në formën e saj të pastër vetëm në teori, sepse madje edhe SHBA-të disponojnë një sistem sigurimesh – edhe pse ky është akoma shumë rudimentar. Nëse planet e presidentit Obama për ta zgjeruar këtë sistem sigurimesh do të kenë sukses, kjo mbetet akoma e hapur. Pasojat e krizës financiare, e cila fillesën e kishte në SHBA dhe që aty ka goditur jashtëzakonisht fort ekonominë reale, edhe në SHBA kanë bërë që njerëzit për një farë kohe të ndryshojnë mënyrën e të menduarit. Nëse kjo situatë do të vazhdojë apo do të bëhen reforma institucionale, këtë do ta tregojë koha.

Literaturë plotësuese:

Lew Hinchman
(2006), *SHBA:
Residual Welfare
Society and
Libertarian De-
mocracy*, në
Thomas Meyer
(Botues),
*Praxis der So-
zialen Demo-
kratie*,
Wiesbaden,
Faqe 327-373

Winand Gelner
dhe Martin
Kleiber
(2007), *Das Re-
gierungssystem
der USA.
Eine Einführung*.
Baden-Baden.

5.2. BRITANIA E MADHE

Nga Christian Krell

Hyrje

Britania e Madhe, në kuadrin e Teorisë së Demokracisë Sociale, përshkruhet si “demokraci sociale me suport të ulët”. Kjo do të thotë se të drejtat bazë sociale dhe ekonomike – duke iu shtuar edhe atyre qytetare dhe politike – këtu janë të vlefshme. Ekziston edhe një shtet i mirëqenies, i mbështetur mbi të drejtat themelore në fushat esenciale. Natyrisht shërbimet e shtetit të mirëqenies këtu janë realizuar vetëm në nivel të ulët. Të drejtat bazë formalisht janë të vlefshme, por shpesh nuk funksionojnë realisht. Prandaj Britania e Madhe shënon kufirin e jashtëm të demokracisë sociale – kur mendojmë për kategoritë e demokracisë sociale dhe libertariane.

Fakti që shteti social në Britaninë e Madhe është zgjeruar vetëm relativisht pak, na habit, pasinë Britaninë e Madhe janë zhvilluar elementët e një shteti të mirëqenies më herët se në vendet e tjera evropiane. Me zgjerimin e tregtisë dhe inovacioneve teknike që nga shekulli i 18-të erdhën jo vetëm fitimet e mirëqenies, por bashkë me industrializimin u shtuan edhe problemet sociale të lidhura me të: varfëria, të ushqyerit dhe shëndetësia e keqe, puna e fëmijëve dhe sigurimi i dobët social.

Për të plotësuar këto mungesa sociale, në Britaninë e Madhe lindën relativisht herët elementët e parë të një shteti social. Natyrisht, në fillim nuk kishim një shtet gjithëpërfshirës të mirëqenies. Për këtë shkaqet duhen kërkuar para së gjithash në strukturat e ulëta politiko-kulturore të Britanisë së Madhe. Liberalizmi ka pasur dhe ka një rol të rëndësishëm në kulturën politike britanike. Këtu vërtet po zhvillohen tregtia e lirë dhe prosperiteti ekonomik, madje ka ndodhur edhe një zgjerim i kufizuar i të drejtave politike. Por është hequr dorë nga ndërhyrja shtetërore në çështjet sociale. Në shekujt e 18-të dhe 19-të ishte kredoja liberale e Laissez-faire “Government shall not interfere”, e cila përcaktonte formatimin dhe orientimin e politikës sociale dhe ekonomike.

Ky zgjerim i pakët i shërbimeve sociale shtetërore pjesërisht është balancuar nga angazhimi karitativ dhe filantropik. Shumë shoqata karitative “charities” dhe donacione private kanë çuar në një strukturë të përkujdesjes sociale jo shtetërore, që zhvillohet akoma edhe sot

*Një demokraci
sociale
me suport të
ulët*

*Zgjerimi i
hershëm
i shtetit social*

*Megjithatë
shteti social
ekziston i
zgjeruar pak*

në një mënyrë të tillë, që është tipike për Mbretërinë e Bashkuar. Por problematik ka qenë dhe mbetet akoma fakti që nga kjo përkujdesje ndaj të varfërve nuk përfitojnë të gjithë personat në nevojë.

Përveç “charities” në shekullin e 19-të në Britaninë e Madhe u zhvilluan edhe shumë sindikata, madje pjesërisht shumë të fuqishme. Në dallim nga Gjermania këtu nuk kemi të bëjmë me krijimin e sindikatave të unifikuara, kështu që peizazhi i sindikatave britanike edhe sot është akoma i copëtuar. Nisur nga lëvizja sindikaliste në vitin 1900 lindi Labour Party – socialdemokracia britanike. Partia Laburiste pas Luftës së Parë Botërore u zhvillua dhe u bë forca e dytë më e fuqishme në Britaninë e Madhe dhe në vitin 1945 mori për herë të parë qeverisjen. Nën udhëheqjen e saj pas lufte u bë i mundur zgjerimi i dukshëm i shtetit britanik të mirëqenies.

*Konsensusi i
pas luftës
dhe “social
contract”*

Ky shtet i përkujdesjes sociale u pranua nga Partia Konservatore dhe ajo Laburiste në vija të përgjithshme në të njëjtën masë. Prandaj edhe lidhur me të shpesh flitet për konsensusin britanik të pas luftës apo për një “social contract” – kontratë sociale – midis të gjitha shtresave të shoqërisë.

Era e Theçerit

Në fund të viteve 1970-të kryeministrja Margaret Theçer njoftoi në mënyrë ofensive fundin e “social contract” dhe kërkoi kthimin të “frontiers of the state”. Ndryshe nga mirëkuptimi politik i fazës së pas luftës ajo theksoi se shteti nuk është përgjegjës për punësimin e plotë. Sipas perspektivës së Theçerit duhej hequr dorë nga çdo intervenim shtetëror në lojën e lirë të forcave ekonomike. Veprimi shtetëror duhej të përqendrohej, në radhë të parë, në stabilizimin e kushteve kuadër për veprimin ekonomik – në mënyrë të veçantë për të stabilizuar sasinë e parave. Faza e qeverisjes së konservativëve (1979-1997) e karakterizuar nga Theçeri, mori masat respektive të privatizimit dhe të reduktimit të rregullimeve shtetërore në sektorë të shumtë të ekonomisë britanike.

Pasoja të politikës së Theçerit ishin një rritje e dukshme e kuotës së varfërisë dhe rritja e pabarazisë sociale në Britaninë e Madhe. Këta indikatorë dhe të tjerë tregojnë nga afër se Britania e Madhe, në fazën e fundit të erës së Theçerit, mund të përshkruhej si demokraci sociale akoma shumë e kufizuar.

Vetëm me zgjedhjen e Tony Blair dhe Partisë Laburiste në vitin 1997 Britania e Madhe u zhvillua përsëri fuqishëm në drejtim të një demokracie sociale. Qëllimi i deklaruar i laburistëve për të siguruar akses social për të gjithë, u mbështet nga një numër i madh masash të veçanta: zgjerimi masiv i shërbimeve publike, veçanërisht në sektorin e shëndetësisë dhe të arsimit, luftimi me objektiv të qartë i varfërisë dhe futja e një page minimale janë vetëm disa nga treguesit se Britania e Madhe po zhvillohej sërish fuqishëm në drejtim të demokracisë sociale. Kuota e ulët e papunësisë e ruajtur gjatë qeverisë Blair dhe një kuotë e varfërisë e ulur lehtë – në kohën kur nivelet e varfërisë në shumë shtete të OECD-së ishin rritur dukshëm - vërtetojnë suksesin e këtij modeli.

Ruajtja e tregut liberal të punës, sikurse ishte premtuar, dhe rendi liberal i ekonomisë i erës Theçer, mirëkuptimi autoritar i Blair-it dhe pa harruar edhe politikën e tij të Irakut si aleati i ngushtë i SHBA-ve, çuan në atë që varianti britanik i “rrugës së tretë” u bë i diskutueshëm.

Gordon Brown, pasuesi i Tony Blair-it në postin e kryeministrit, i qëndroi besnik kursit parimor të laburistëve, por në të njëjtën kohë vuri theks të reja. Në politikën e jashtme dhe të sigurisë u zhvillua më tej orientimi shumë i ngushtë ndaj SHBA-ve, në favor të një qëndrimi të baraspeshuar. U vazhduan investimet në sektorin e shërbimeve publike, natyrisht me peshë më të fortë në aspektet sociale.

Sistemi politik

Britania e Madhe cilësohet, me të drejtë, si një nga demokracitë më të vjetra të Evropës. Por njëkohësisht sistemi politik britanik përshkruhet edhe si “electivedictatorship”, pra si diktaturë e zgjedhur. Si mund të qëndrojnë bashkë këto?

Kjo kontradiktë e dyshuar zgjidhet po t’i hedhim një shikim të shkurtër historisë angleze. Që nga “Glorious Revolution” (1688/89) parlamenti britanik ka fituar vazhdimisht rëndësi. Në shekuj, për parlamentin britanik, të përbërë nga Dhoma e Ulët dhe Dhoma e Lordëve, u shtuan gjithnjë e më shumë të drejta, të cilat më parë i kishte Kurora. Në Britaninë e Madhe nuk u krye ndonjë transformim i thellë revolucionar, i cili në shumë shtete të Evropës çoi në një ndarje të pushteteve. Pushteti, i cili më parë ishte i përqendruar te Kurora, sot në pjesë të gjera i takon parlamentit.

Prej këtej parlamenti disponon një sovranitet pothuajse të pakufizuar dhe nuk mund të kufizohet as nga ndonjë gjykatë e lartë apo ndonjë kushtetutë. Ky sovranitet i lartë sot përqendrohet, në radhë të parë, tek lideri i grupit parlamentar të shumicës në Dhomën e Ulët, pra te kryeministri britanik.

Qeveri e fortë

Dy faktorë shtesë e fuqizojnë pushtetin e qeverisë respektive: Së pari ndërtimi centralist i shtetit të Britanisë së Madhe bën që asnjë rajon apo land federal i fortë të mund të influencojë legjislacionin e qeverisë qendrore.

Së dyti, e drejta zgjedhore maxhoritare e thjeshtë kontribuon që në zgjedhje zakonisht njëra parti del si fituese e qartë. Qeveritë e koalicionit – përveç rasteve në kohën e krizave kombëtare – në Britaninë e Madhe nuk janë as diçka e zakonshme, as edhe e domosdoshme. Konservatorët dhe Partia Laburiste formojnë qeverinë në mënyrë alternative, duke ndërruar njëra-tjetrën. Përveç këtyre dy partive dominante mund të përmenden edhe “Liberals” –liberalët janë forcë e tretë e rëndësishme në sistemin partiak britanik. Në vitin 2010 hynë në qeverinë e koalicionit si partneri i ri i konservatorëve, çka ishte një përjashtim nga rregulli. Parti të tjera, në bazë të ligjit zgjedhor maxhoritar, e kanë shumë të vështirë të pozicionohen në rrafshin kombëtar. Kohët e fundit po duken disa ndryshime në sjelljen e zgjedhësve dhe për pasojë edhe në peizazhin parlamentar. Parti më të vogla si Green Party (Partia e Gjelbër) dhe British National Party (Partia Kombëtare Britanike) e ekstremit të djathtë po fitojnë vota, ndërsa partitë popullore të stabilizuara po humbasin mbështetje. Por e drejta zgjedhore në rrafshin kombëtar çon në rezultate zgjedhore të qëndrueshme dhe të qarta. Ndërtimi centralist i shtetit, shumicat e qarta dhe një parlament sovran tregojnë se qeveria disponon një potencial të lartë zhvillimi. Prej këtej, ndërrimi i drejtimit politik themelor është i mundur të bëhet shpejt dhe të jetë gjithëpërfshirës. Prandaj, zhvillimi i demokracisë sociale në Britaninë e Madhe është më i hapur për të ardhmen se sa në shumë vende të tjera.

Sistemi i të drejtave themelore

Edhe lidhur me të drejtat themelore Britania e Madhe karakterizohet nga një kontradiktë e rreme: Nga njëra anë me Magna Charta (1215) ose me “Petition of Rights” (1628) u garantuan jashtëzakonisht herët të drejtat e para themelore – fillimisht vetëm për një pakicë të vogël. Këto të drejta drejtoheshin, para së gjithash, kundër arbitraritetit, pra ishin të drejta negative të lirisë. Nga ana tjetër në Britaninë e Madhe nuk ekziston asnjë kushtetutë e shkruar në ndonjë dokument. Pra, nuk ekziston një katalog i të drejtave themelore të sanksionuara në kushtetutë.

Të drejtat e hershme themelore

Natyrisht Britania e Madhe ka ratifikuar në vitin 1976 si paktin e OKB-së për të drejtat themelore qytetare dhe politike, ashtu edhe paktin për të drejtat bazë ekonomike, sociale dhe kulturore. Edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut në vitin 1998 u pranua në të drejtën britanike.

Me gjithë këtë vlefshmëri formale në shumë fusha në Britaninë e Madhe nuk mund të flitet për një funksionim real të të drejtave themelore. Kështu, për shembull, niveli tradicionalisht i lartë i varfërisë në Britaninë e Madhe vë në pikëpyetje nëse është realizuar e drejta për një standard të përshtatshëm jetese apo jo.

Që nga marrja e qeverisë nga Partia Laburiste u realizuan disa të drejta themelore në mënyrë gjithëpërfshirëse më shumë se më parë. Shembull për këtë janë paga minimale në rrafsh kombëtar e futur në fuqi që nga viti 1999 ose kërkesa ndaj punëdhënësve për t'u dhënë të punësuarve me kohë të pjesshme të njëjtën pagë dhe për t'u krijuar atyre të njëjtat kushte punësimi si të punësuarve me kohë të plotë.

Ekonomia politike

Britania e Madhe bën pjesë në tipin klasik të një ekonomie liberale të tregut. Në krahasim me ekonomitë e koordinuara të tregut këtu tregjet konkurruese intensive kanë një rol qendror.

Kjo rëndësi e madhe e tregut duket në bisedimet për pagat që zhvillohen midis punëdhënësve dhe punëmarrësve. Por meqenëse bashkimet e punëdhënësve dhe punëmarrësve janë tepër të dobëta dhe të përçara, prandaj edhe paga shpesh vendoset në bisedime individuale midis punëmarrësit dhe sipërmarrjes. Për pasojë paga orientohet direkt nga madhësia e të ardhurave të punëmarrësit të realizuara në treg: Një vendimmarrje e përbashkët, si për shembull në industrinë minerare gjermane, në Britaninë e Madhe, është krejt e panjohur.

Pushimet nga puna në Britaninë e Madhe mund të zbatohen lehtë për arsye se mbrojtja nga pushimet nga puna aty është shumë e vogël, por natyrisht punëmarrësit e kualifikuar zakonisht janë në gjendje të mirë të gjejnë një punë të re në tregun fleksibël të punës. Gjatë krizës së tregjeve financiare dhe ekonomike sensibiliteti i ekonomisë së pakoordinuar britanike tregoi qartësisht luhatje në tregun e punës. Numri i të papunëve është rritur më shpejt krahasuar me ekonominë e koordinuar të tregut si në rastin e Gjermanisë.

*A funksionojnë
të drejtat
themelore
edhe realisht*

*Rëndësia e
madhe
e tregut*

*Treg fleksibël
i punës*

Përgjithësisht koha e qëndrimit të punëmarrësve të veçantë në një sipërmarrje është relativisht e shkurtër. Për pasojë për punëdhënësit nuk ka ndonjë interes të madh të bëjnë kualifikime specifike për firmat apo sektorët. Pikërisht me këtë lidhet produktiviteti më i ulët në Britaninë e Madhe, krahasuar me nivelin ndërkombëtar.

Në bazë të këtij produktiviteti të ulët përqindja e industrisë në ekonominë e Britanisë së Madhe përgjithësisht është e dobët. Nga ana tjetër, jashtëzakonisht i fuqishëm është sektori i shërbimeve. Qyteti i Londrës është një nga zonat më të fuqishme financiare. Siguracat financiare dhe shoqëritë e sigurimit aty janë të përfaqësuara fort. Në sektorin e shërbimeve punojnë rreth 76% e britanikëve.

Sipërmarrjet në ekonominë liberale të tregut e tërheqin kapitalin për investimet kryesisht nga tregjet financiare dhe për pasojë janë të orientuara nga renditet e shpejta. Nuk janë të njohura programet apo skemat e financimit të vendosura për afate të gjata në bankat e vetë kompanive. Këtu ekonomia britanike u nënshtrohet më mirë orientimeve afatshkurtra dhe tenton drejt fitimit maksimal të shpejtë.

Shteti social

Në studimet kërkimore krahasuese të shtetit social, shtetit social britanik i vihet shpesh epiteti i "karakterit hibrid". Kjo do të thotë se në rastin britanik shtetin social e karakterizojnë logjika të ndryshme, të cilat zakonisht nuk janë të përfaqësuara njëkohësisht në një sistem. Kështu disa shërbime të shtetit social – për shembull, në sistemin e shëndetësisë - po sigurohen në mënyrë universale, kjo do të thotë që ato i vihen në dispozicion çdo banori të Britanisë së Madhe. Shërbime të tjera sigurohen sipas kontrollit të nevojave – pjesërisht të atyre që ndihen se u është nëpërkëmbur dinjiteti. Me gjithë këto tipare të ndryshme Britania e Madhe cilësohet si një shtet liberal i mirëqenies. Ndaj risqeve elementare sigurinë e garanton shteti social, ndërsa nevojat e mirëqenies që kalojnë përtej kësaj kornize kujdesi do të duhet të realizohen nëpërmjet tregut të lirë.

Sistemi shëndetësor

National Health Service (Shërbimi shëndetësor kombëtar-ShShK) është bërthama e shtetit social britanik. Ai financohet nga taksat dhe siguron kujdesin pa pagesë të popullsisë së Britanisë së Madhe me përkujdesje mjekësore dhe mjetet e domosdoshme të ndihmës dhe në ilaçe. Avantazhi i ShShK-së, përveç sigurimit universal të shërbimeve, është transparenca e tij

*Karakteri hibrid
i shtetit social*

*Sistemi
shëndetësor*

e lartë. Por ShShK-ja ka vuajtur për dekada nga financimi i ulët kronik. Prej këtej u shkaktuan mungesa në përkujdesjen shëndetësore, të cilat shprehen në rradhët e gjata të pritjes për operacione të caktuara. Prandaj, duke filluar nga viti 2000, janë shtuar shumë mjetet shtesë publike të investuara në shërbimin kombëtar shëndetësor ShShK.

Sigurimi social

Sigurimi social (National Insurance) siguron një sërë risqesh si kujdesin e pleqërisë, papunësinë, aksidentet në punë, invaliditetin etj. Sigurimi social financohet nga kontributet, të cilat paguhen proporcionalisht me të ardhurat. Natyrisht kontributet zakonisht bëhen në shuma të përgjithshme dhe lejojnë vetëm një siguracion bazë. Kush dëshiron të bëjë sigurime jashtë këtij sigurimi bazë, për këtë ai duhet të shfrytëzojë tregun e lirë.

Ndihma sociale

Ndihma sociale (National Assistance) siguron një sërë shërbimesh që mund të përdoren nga ata persona të cilët nuk kanë pretendim të marrin shërbimet që mbështeten në derdhjen e kontributeve dhe që nuk mund të shfrytëzojnë shërbimet e siguracioneve private. Këto shërbime financohen nga taksat dhe shpesh janë të orientuara fort sipas kategorive të personave në nevojë, kjo do të thotë se këto shërbime i marrin vetëm ata që faktikisht janë në nevojë dhe nuk kanë asnjë mundësi tjetër për të shfrytëzuar vetë-ndihmën.

Sistemi arsimor

Në Mbretërinë e Bashkuar peizazhi shkollor mund të ndryshojë sipas shkollave publike dhe me pagesë – private. Kjo ndarje në dy pjesët e sistemit arsimor britanik është bashkëpërgjegjëse për faktin që nga njëra anë vërtet është arritur të shkollohet një elitë e vogël me kualifikim të lartë, por njëkohësisht ekzistojnë deficite në shkollimin e përgjithshëm dhe në shkollimin profesional. Lidhja midis statusit social dhe suksesit shkollor është shumë e theksuar. Reforma dhe zhvillimi i mëtejshëm i sistemit arsimor ka qenë dhe mbetet një nga detyrat qendrore të qeverisë aktuale laburiste. Një nga masat më të rëndësishme të qeverisë Brown në këtë fushë të politikës ishte rritja shkallë-shkallë e shkollimit dhe kualifikimit të detyrueshëm nga 16 deri në moshën 18 vjeç. Pra duhet të kapërcehet situata që Britania e Madhe është vendi me më shumë 16 deri 18-vjeçarë, të cilët nuk kanë punë apo kualifikim. Ndërkohë po bëhen investime të konsiderueshme publike në sektorin e arsimit, por njëkohësisht po merren edhe masa të diskutueshme, si në rastin e futjes së taksave për studime.

Sigurimi social

Ndihma sociale

Sistemi arsimor

Britania e Madhe		
Kuota e punësimit 2008	71,5% (65,8)	Përqindja e personave të punësuar (gratë) në moshën nga 15 deri 64 vjeç në raport me popullsinë e përgjithshme (Burimi: Eurostat)
Të ardhurat e grave, të matura me të ardhurat e burrave	67 %	Përqindja e të ardhurave që fitojnë gratë në raport me burrat (Burimi: Human Development burrave Index 2009, faqe 186)
Kuota e papunësisë 2008	5,6 %	Përqindja e të papunëve në gjirin e popullsisë aktive për punë (Burimi: Eurostat)
Kuota e të papunëve për një kohë të gjatë 2008	1.4 %	Përqindja e të papunëve për një kohë të gjatë (12 muaj e më tepër) në gjirin e popullsisë aktive (Burimi: Eurostat)
Pabarazia e të ardhurave/ koeficienti Gini 2009	36%	Shifra e referencës për shpërndarjen e pabarabartë të të ardhurave, sa më e lartë vlera, aq më e madhe pabarazia (Burimi: Human Development Report, 2009, faqe 195)
Indeksi i varfërisë 2009	14.6%	Indeksi i varfërisë lidhet me indikatorë të ndryshëm (jetëgjatësia, shkalla e alfabetizimit, aksesit për kujdesin shëndetësor 0= varfëria minimale, 100 = varfëria maksimale (Burimi: Human Development Report 2009, faqe 180).
Arsimi: Varësia e suksesit të arsimit nga sfondi social-ekonomik 2006	13,9%	Përqindja në dallimet e arritjeve të nxënësve sipas sfondit social-ekonomik (Burimi: OECD 2007)
Shkalla e organizimit sindikalist 2007	28 %	Përqindja e popullsisë aktive për punë, e organizuar në sindikata (Burimi: OECD)

Përfundimi

Që nga fundi i viteve 1990-të Britania e Madhe po zhvillohet përsëri fuqishëm në drejtim të demokracisë sociale. Qëllimi i Partisë Laburiste ishte përfshirja e të gjithëve në shoqëri. Kjo lipset të realizohet në radhë të parë nëpërmjet pjesëmarrjes në jetën aktive të punës. Sigurimi social duhet të realizohet jo vetëm për sa më shumë njerëz që të jetë e mundur në nivel të lartë, por edhe njerëzit në nevojë të kenë mundësi faktike për ta shfrytëzuar këtë asistencë sociale. Njëkohësisht garantimi i shërbimeve sociale ka qenë i lidhur vazhdimisht edhe me pretendimin që marrësit e këtij shërbimi të përpiqen aktivisht për të ndihmuar veten. Një rritje e qëndrueshme e ekonomisë dhe aktivizimi i politikës së tregut të punës deri në vitin 2009 kanë çuar në kuota të larta punësimi dhe për pasojë edhe në uljen e varfërisë nga njëra anë dhe rritjen e pjesëmarrjes shoqërore nga ana tjetër.

Në bazë të nivelit të varfërisë akoma të lartë, të nivelit të ulët të shërbimeve sociale dhe të shanseve për arsimim të shpërndara në mënyrë të pabarabartë, Britania e Madhe deri në fund të mandatit të qeverisë së Partisë Laburiste vazhdon të cilësohet si demokraci sociale me suport të ulët dhe shënon kufirin e jashtëm të demokracisë sociale. Çfarë zhvillimi do të ketë nën qeverisjen e konservatorëve, kjo do të shihet në të ardhmen.

Literaturë plotësuese:

*Christian Krell
(2006), Laggard
or Leader –
der britische
Sozialstaat im
Spiegel der
Sozialen
Demokratie, në:
Thomas Meyer
(Botues), Praxis
der*

*Sozialen Demo-
kratie,
Wiesbaden, faqe
130-241.*

*Alexander Pe-
tring (2006),
Großbritannien,
në:
Wolfgang Mer-
kel e të tjerë
(Botues), Die
Reformfähigkeit
der Sozialen
Demokratie,
Wiesbaden, faqe
119-153*

5.3. GJERMANIA

Nga Christoph Egle

*Një histori
suksesi
e demokracisë
sociale?*

Në sfondin e situatës politike dhe ekonomike ku ndodhej Gjermania pas fundit të Luftës së Dytë Botërore, Republika Federale²² mund të quhet një “histori suksesi” e demokracisë sociale. Vërtet që pas fundit të sundimit nazist kishte akoma mëdyshje, nëse Gjermania do të mund të bëhej ndonjëherë (përsëri) një vend paqësor dhe demokratik, por këto dyshime sot janë davaritur krejt duke parë stabilitetin e demokracisë në Republikën Federale dhe sanksionimin e saj në një shoqëri civile vitale. Demokratizimi i shtetit dhe shoqërisë natyrisht ishin një proces që solli transformimin e plotë vetëm në fund të viteve 1960-të. Turpi nga sundimi nazist dhe dështimi i Republikës së Vajmarit karakterizojnë edhe sot kulturën politike të Gjermanisë. Ndër karakteristikat e saj numërohen, midis të tjerash, heqja dorë nga retorika nacionaliste dhe skepticizmi i ngulur thellë ndaj ekstremizmit të çdo lloji. Përballë tyre qëndrojnë kërkimi i kompromiseve dhe gjetja e “të mesmes” si virtyte të rëndësishme të Republikës Federale.

*“Modeli
Gjermani”*

Paralelisht me (ri)demokratizimin e arritur pas vitit 1945 edhe “mrekullia ekonomike” ka kontribuar që Gjermania, në bazë të një kombinimi pothuajse unik të aftësisë së zhvillimit ekonomik, stabilitetit politik dhe ekuilibrit social, për një kohë të gjatë është e mbetet si shembull për vendet e tjera industriale perëndimore. Edhe socialdemokracia gjermane është e identifikuar me rendin social dhe ekonomik të Republikës Federale dhe ka parë këtu realizimin e pikëpamjeve të vlerave të saj politike. Kështu SPD-ja në zgjedhjet për në Bundestag në vitin 1976 reklamoi “Modelin e Gjermanisë”. Pas ribashkimit u shtuan indicet se ky rol i shembullit të mirë nuk i shkonte më për shtat Republikës Federale, pasi ajo kishte bërë prapa në rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës. Për t’u vënë re është fakti se një pjesë e këtyre faktorëve që deri në vitet 1980-të kishin kontribuar për karakterizimin e “modelit gjerman” dhe suksesin e tij, në vitet 1990-të u identifikuan si shkak për “rënien” e Gjermanisë. Kjo prek në radhë të parë sistemin e qeverisjes, i cili hezitoi të bënte përshtatjen ndaj kushteve të ndryshuara ekonomike (globalizimi) dhe strukturave të caktuara të shtetit social, të cilat në disa sektorë ishin provuar si një pengesë e punësimit (para së gjithash për ata me kualifikim të ulët dhe për gratë). Por si një rast historik fatlum vlen Ligji Themeltar që fillimisht ishte parashikuar për një periudhë kalimtare.

22. Zhvillimi në RDGJ, për shkak vendi, fatkeqësisht nuk mund të trajtohet

Sistemi i të drejtave themelore në kushtetutë

Si një mësim nga dështimi i Republikës së Vajmarit, në Ligjin Themeltar (GG) janë sanksionuar të drejtat politike të njeriut dhe të lirisë si një e drejtë parashtetërore në 20 nenet e para. Aty bëjnë pjesë si të ashtuquajturat të drejta liberale të mbrojtjes nga ndërhyrja e shtetit në sferën private (“liria negative”), ashtu edhe të drejtat demokratike të vendimmarrjes së përbashkët (“liria pozitive”). Të drejtat për pretendime sociale, si për shembull për punë, banesë, arsim apo për të ardhura minimale nuk janë përmendur në Ligjin Themeltar, por në kushtetutat e disa landeve federale. Një sistem ekonomik konkret nuk është parashkruar në Ligjin Themeltar, por ai përmban disa barriera, si kundër një kapitalizmi të tregut të parregulluar, ashtu edhe kundër një ekonomie socialiste me plan. Kështu, në nenin 14 të Ligjit Themeltar, vërtet sigurohen prona dhe e drejta e trashëgimisë, por është quajtur e nevojshme që përdorimi i pronës “njëkohësisht duhet t’i shërbejë edhe të mirës së përgjithshme”. Ky postulat në konceptin e “ekonomisë sociale të tregut” gjeti një perceptim real politik.

Sistemi politik

Edhe sistemi qeverisës u ndërtua në atë mënyrë që të mos ishte më i mundur një dështim i demokracisë. Për këtë qëllim u instalua një masë e lartë e ndarjes së pushteteve dhe e kufizimit të tyre, ku pushteti i veprimtarisë së ekzekutivit është kufizuar aq shumë sa në asnjë demokraci tjetër të botës. Për t’u përmendur këtu janë federalizmi dhe pjesëmarrja e landeve federale në legjislacionin federal (nëpërmjet Këshillit Federal – Bundesrat), pozicioni i fuqishëm i Gjykatës Kushtetuese Federale, pavarësia e Bankës Federale (më vonë Banka Qendrore Evropiane), delegimi i detyrave shtetërore fiskale në adresë të bashkimeve shoqërore dhe, së fundi, pjesëmarrja e partnerëve socialë në administrimin e sistemit të sigurimeve sociale. Në bazë të kësaj “prangosjeje” të pushtetit shtetëror, politologu amerikan Peter Katzenstein (Kacenshtajn) dikur e ka cilësuar Republikën Federale si një shtet “gjysmësorran”, ku duhet theksuar fakti që Republika Federale deri në vitin 1990 edhe në politikën e jashtme nuk ishte plotësisht sovranë.

Detyrimi i sanksionuar institucionalisht për balancimin e interesave të ndryshme nuk e ka dëmtuar Republikën Federale, por i ka dhënë sistemit qeverisës një masë të lartë efëcence dhe përfaqësimi. Parlamentarizmi është provuar si mjaft i hapur për zhvillimet shoqërore (për shembull, lindja e partive të reja) dhe ka mundur njëkohësisht formimin e qeverive të qëndrueshme. Në legjislacion tërhiqet mendimi i ekspertëve të jashtëm profesionistë, pasi për këtë dëgjohen rregullisht përfaqësuesit e grupeve të prekura të interesit. Por

Të drejtat negative dhe pozitive të lirisë në kushtetutë

Masë e lartë e ndarjes së pushteteve dhe kufizimit të tyre

rolin qendror për vendimarrje e luajnë partitë politike – ashtu sikurse edhe për zënien e posteve publike. Ato përmbushin, në këtë mënyrë, një funksion të rëndësishëm ndërmjetësues midis shoqërisë dhe shtetit. Meqenëse partitë, përveç qeverisë federale, mund të marrin pjesë në të gjitha qeveritë e 16 landeve federale, prandaj edhe ato asnjëherë nuk janë vetëm parti qeverisëse apo parti opozitare. Kjo vlen në radhë të parë për dy partitë e mëdha popullore (SPD dhe CDU/SCU – Partia Socialdemokrate dhe Unioni Kristian Demokrat/Kristian Social), kështu që Republika Federale gjendet gjithmonë nën hijen e një “koalicioni të madh” formal ose informal. Ky detyrim për bashkëpunim ka çuar në atë që veçanërisht në politikën ekonomike dhe sociale, është ndjekur një “politikë e rrugës së mesme” (Manfred G. Schmidt), e cila përcillet e plotë në kulturën politike të vendit, sikurse është përmendur më sipër.

Loja e përbashkët e konkurrencës së partive dhe sistemi federativ i qeverisjes, natyrisht mund të çojnë në bllokimin e vendimeve të rëndësishme për motive partiake politiko-taktike ose mund të arrihen vetëm kompromise suboptimale. Shembujt për këtë janë shtuar shumë pas vitit 1990, kur pas realizimit të bashkimit gjerman u rrit numri i aktorëve federativë dhe, për arsye të globalizimit të përshpejtuar, nuk u realizuan me shpejtësinë e duhur përshtatjet e domosdoshme. Orientimi i sistemit politik drejt stabilitetit, për një kohë të gjatë një faktor suksesi, për shkak të tendencave ngurruese të tij u bë problematik. Në kuadrin e një reforme të federalizmit, prej shumë vitesh, po bëhen përpjekje për ta bërë këtë sistem përsëri pak „më miqësor ndaj vendimarrjeve“.

Ekonomia politike

Gjermania vlerësohet si përfaqësuese tipike e të ashtuquajturës ekonomi e tregut të koordinuar, ku sipërmarrjet financohen, jo si në një ekonomi liberale të tregut nëpërmjet tregut të kapitalit, por nëpërmjet kredive afatgjata të bankave me të cilat lidhen ekskluzivisht kompanitë. Kjo ndërthurje reciproke që rezulton midis industrisë dhe sektorit bankar, është një karakteristikë qendrore e „kapitalizmit të Rinit“. Mbi bazën e „kapitalit të duruar“ në këtë model janë të mundura vendimarrje të sipërmarrjeve me një horizont kohor më të gjatë sesa në rastin e orientimit afatshkurtër të modelit Shareholder-Value.

Tipike për „Gjermania sh.a.“, përveç kësaj është edhe një pjesëmarrje shumë e zgjeruar, në krahasim me rastet ndërkombëtare, e punëmarrësve dhe punëmarrësve në drejtimin e sipërmarrjes, qoftë kjo në vendimarrjen e përbashkët në rrafsh ndërmarrje (krijimi i vendeve të punës, oraret e punës,

punët e personelit) ashtu edhe në vendimarrjen e përbashkët në sipërmarrje (me anë të përfaqësuesve të punëmarrësve në këshillin mbikëqyrës të shoqërive aksionare apo shoqërive të tjera me kapital të madh). Të përshtatshme për këtë janë marrëdhëniet sociale, të karakterizuara parimisht nga një bashkëpunim partneriteti. Faktimi i pagave u lihet bisedimeve të lira që zhvillohen midis punëdhënësve dhe punëmarrësve (autonomia tarifore), bisedime që janë organizuar gjerësisht deri në bashkimet e epërme kombëtare. “Beteja” për punën, krahasuar me rastet e tjera ndërkombëtare, këtu zhvillohen relativisht pak dhe përgjithësisht me kohëzgjatje të shkurtër.

Por ky model i ekonomisë së tregut të koordinuar prej disa vitesh po i nënshtrohet një farë fenomeni të shpërbërjes. Kjo shpjegohet nga njëra anë me globalizimin apo me kërkesat në rritje të sipërmarrjeve gjermane për të marrë pjesë më fuqimisht në tregun financiar ndërkombëtar, nga ana tjetër me erozionin e marrëdhënieve tarifore dhe sociale, pasi, si sindikatat, ashtu edhe bashkimet e punëdhënësve kanë humbur forcën organizatore e për pasojë edhe aftësinë koordinuese.

Shteti social

Republika Federale është shembulli model për të ashtuquajturin shtet social konservativo-korporatist, i cili cilësohet edhe si “demokristian” ose si “tipi Bismark”. Kjo terminologji e bën të qartë se shteti social gjerman nuk u krijua fillimisht nga socialdemokratët, por se ai në lindjen e tij historike vjen në radhë të parë nga konservatorët dhe demokristianët. Pas Luftës së Dytë Botërore zgjerimi i shtetit social u çua përpara njësoj nga dy partitë e shtetit social (CDU/CSU dhe SPD).

Me gjithë volumin e tij të madh financiar shteti social gjerman karakterizohet nga një rishpërndarje e moderuar, ku dallimet ekzistuese sociale shpesh vazhdojnë më tej. Shembuj për këtë janë sistemet e ndryshme të sigurimeve sociale dhe ato të kujdesit për grupe të ndryshme profesionale. Detyrimi i përgjithshëm i sigurimit social vlen vetëm për punëmarrësit, ndërsa të vetëpunësuarit dhe nëpunësit e lartë të administratës mund të sigurohen privatisht ndaj risqeve sociale ose i nënshtrohen një sistemi të veçantë sigurimesh (për shembull, pensionet e nëpunësve të lartë).

Në qendër të shtetit social gjerman qëndrojnë sistemet e siguracioneve sociale kolektive të pavarura, që financohen sipas procedurave të fondeve të mbledhura nga kontributet e detyrueshme financiare të punëdhënësve dhe punëmarrësve. Sipas nevojës, por edhe herë pas here, jepen fonde

*Vendimarrja
e përbashkët
dhe autonomia
tarifore*

*Shteti social
konservativo-
korporatist
Kosto të larta
shitesë
krahas pagës*

shtesë (si në rastin e sigurimit të pensioneve) nga buxheti federal. Meqenëse shpenzimet e shtetit social, në radhë të parë, bien mbi pagat dhe për pasojë e shtrenjtojnë faktorin produktiv punë, prandaj edhe ky lloj financimi është provuar si një pengesë për krijimin e vendeve të punës, veçanërisht në sektorët e shërbimit me stafe intensive. Shërbimet e sigurimeve parimisht orientohen nga parimi i ekuivalencës, d.m.th. sa më gjatë që të ketë paguar kontribute një punëmarrës, apo sa më të larta të jenë të ardhurat e tij, aq më të larta janë kuotat që ai merr nga shërbimet e sigurimeve. Ky përqendrimi i shtetit social tek fitimet apo të ardhurat është problematik, në radhë të parë për personat me biografi pune pak të qëndrueshme. Pasi ata për pasojë mund të marrin vetëm një mbrojtje të kufizuar sociale.

Pensioni

Pensioni

Niveli i pensioneve standard të paguara nga sigurimet e detyrueshme ligjore të pensioneve është (pa siguracionin shtesë nga ndërmarrja) rreth 70% e pagës mesatare neto. Kjo vlerë, sipas reformave më të reja të pensioneve, në aspektin afatgjatë do të ulet deri në 50%. Si kompensim i kësaj rënije po nxitet përfundimi i reformës për një pension shtesë të mbuluar nga kapitali, i cili do të realizohet nga shtimi i fondeve shtetërore dhe lehtësimet fiskale. Kur pretendimet për pension janë nën nivelin e ndihmës sociale, atëherë në pleqëri hyn në fuqi siguri bazë.

Sigurimi i të papunëve

Sigurimi i të papunëve

Pagesa e të papunëve, e paguar nga siguri i të papunëve, është sipas nivelit familjar 60 deri 67% e pagës që merrte personi kohën e fundit që kishte qenë në punë. Kjo pagesë bëhet në varësi nga kohëzgjatja e kontributeve dhe mosha e marrësit të ndihmës për një kohë nga 6 deri në 24 muaj. Pas skadimit të këtyre afateve mund të tërhiqet paga e të papunit e shkallës II, e financuar nga taksat, e cila është në vlerën e ndihmës sociale. Por tërheqja e parave të të papunit e shkallës II apo e ndihmës sociale (për ata që nuk janë të aftë për punë) kërkon paraprakisht kontrollin e nevojave të tij, ku nga personat e aftë për punë, veç të tjerash, pritet dhe kontrollohet gatishmëria e tyre për të pranuar një punë. Nëpërmjet një pretendimi, si e drejtë për këtë asistencë përkujdesje, është garantuar një minimum social-kulturor jetese për të gjithë personat.

Sistemi shëndetësor

Sistemi shëndetësor

Shërbimet e sigurimit të detyrueshëm ligjor të të sëmurëve (SDLS), krahasuar me nivelin ndërkombëtar, vlerësohen si të mira, por natyrisht sistemi,

Gjermania		
Kuota e punësimit 2008	70,7% (65,4)	Përqindja e personave të punësuar (gratë) në moshën 15-65 në raport me popullsinë e përgjithshme (Burimi: Eurostat)
Të ardhurat e grave, të matura me të ardhurat e burrave	59 %	Përqindja e të ardhurave që fitojnë gratë në raport me burrat (Burimi: Human Development Index 2009, faqe 186)
Kuota e papunësisë 2008	7.3 %	Përqindja e të papunëve në gjirin e popullsisë aktive për punë (Burimi: Eurostat)
Kuota e të papunëve për një kohë të gjatë 2008	3.8 %	Përqindja e të papunëve për një kohë të gjatë (12 muaj e më shumë) matur me popullsinë aktive (Burimi: Eurostat)
Pabarazia e të ardhurave/ koeficienti Gini 2009	28,3 %	Shifra e referencës për shpërndarjen e pabarabartë të të ardhurave, sa më e lartë vlera, aq më e madhe pabarazia (Burimi: Human Development Report, 2009, faqe 195)
Indeksi i varfërisë 2009	10.1 %	Indeksi i varfërisë lidhet me indikatorë të ndryshëm (jetëgjatësia, shkalla e alfabetizmit, aksesit për kujdesin shëndetësor, 0= varfëria minimale, 100 = varfëria maksimale (Burimi: Human Development Report 2009, faqe 180).
Arsimi: Varësia e suksesit të arsimit nga sfondi social-ekonomik 2006	19%	Përqindja në dallimet e arritjeve të nxënësve sipas sfondit social-ekonomik (Burimi: OECD 2007)
Shkalla e organizimit sindikalist 2007	19.9 %	Përqindja e popullsisë aktive për punë e organizuar në sindikata (Burimi: OECD).

krahasuar me të tjerët, është i shtrenjtë. Fëmijët dhe partnerët familjarë të papunë janë të siguruar pa pagesë bashkë me prindërit e tyre ose një person i çiftit e përfiton këtë nga tjetri. Personat që marrin asistencë sociale janë automatikisht anëtarë të SDLS. Personat me aktivitet të pavarur, nëpunësit e lartë dhe punëmarrësit me të ardhura të larta janë të çliruar nga detyrimi i sigurimit dhe mund të sigurohen privatisht (shpesh me kushte të favorshme).

Sistemi arsimor

Sistemi arsimor është pothuajse përgjegjësi e vetë landeve federale dhe këtu ka diferenca të dukshme rajonale në strukturë dhe cilësi. Ndërsa disa lande janë në nivelin e grupit kryesues në rrafsh ndërkombëtar, kompetencat e nxënësve në lande të tjera federale janë nën mesataren e OECD-së. Nga krahasimi ndërkombëtar është bërë gjithashtu e qartë se në asnjë vend tjetër prejardhja sociale e nxënësve nuk e përcakton kaq shumë suksesin e arsimit si këtu, d.m.th. se oferta e barazisë së shanseve në Gjermani nuk realizohet aspak. Me gjithë mangësitë periodike në ofertën e vendeve të shkollimit, në krahasimin ndërkombëtar, vazhdon të merret akoma si shembull sistemi dual i arsimit profesional, i cili mundëson kualifikimin profesional pranë ndërmarrjeve dhe kjo është e lidhur me detyrimin shkollor për një arsimim të përgjithshëm.

Përfundimi

“Modeli i Gjermanisë” për një kohë të gjatë ka vlejtur si shembull dhe deri në vitet 1970-të ishte një demokraci sociale me suport të lartë. Në vazhdim të përshtatjes ndaj pasojave të ribashkimit të dy Gjermanive dhe të globalizimit ka humbur ky pozicionim kryesues. Që nga ajo kohë Gjermania cilësohet si një demokraci sociale me suport të mesëm. Arsye të rëndësishme për këtë gjenden në faktin që lloji i financimit të shtetit social në konkurrencën ndërkombëtare është parë si i disfavorshëm dhe se në bazë të sistemit politik të orientuar drejt stabilitetit, reformat e domosdoshme nuk janë aprovuar në kohën e duhur. Që nga mesi i viteve 1990-të janë përpjekur, fillimisht qeveria Kohl, pas disa hezitimeve edhe qeveria Schröder, nëpërmjet një restaurimi dhe demontimi të shtetit social të forcojnë aftësinë konkurruese të ekonomisë gjermane dhe ta përshtatin sistemin e sigurisë sociale me plakjen e shoqërisë dhe transformimin e strukturave të familjes. Kjo reformë pjesërisht u zbatua përkundër rezistencës së lartë në gjirin e popullsisë, por mendohet se ajo është kushti paraprak për të rritur përsëri nivelin e punësimit. Na mbetet të presim, nëse në të ardhmen Gjermania do të arrijë përsëri të lëvizë në drejtimin e një demokracie sociale me suport të lartë.

Sistemi arsimor

Literaturë plotësuese:

Christoph Egle
(2006),
*Deutschland:
der blockierte
Musterknaube,
në:
Thomas Meyer
(Botues),
Praxis der So-
zialen Demo-
katie,
Wiesbaden,
Faqe 273-326*

Peter Katzen-
stein
(1987): *Policy
and Politics in
West Germany.
The Growth of
a Semisovereign
State, Philadel-
phia.*

Manfred G.
Schmidt
(2007), *Das po-
litische System
Deutschlands,,
München.*

5.4. JAPONIA²³

Nga Eun-Jeung Lee

Në diskutimin akademik zor se mund të gjes një vend tjetër që të karakterizohet në mënyra kaq të ndryshme si Japonia. Veçanërisht në drejtim të shtetit të mirëqenies apo të shoqërisë së mirëqenies diapazoni i tablosë japoneze është i madh - nga regjimi i mirëqenies liberal-konservator me prerje të fortë "socialdemokrate" e deri në "shoqërinë pa klasa në kuptimin marksist".

Raportet në Japoni nuk të lejojnë t'i sjellësh lehtë në një emërues të zakonshëm. Aty partia konservative LDP (Partia Liberale Demokratike), me ndonjë ndërprerje të shkurtër 1993-1994, duke filluar që nga viti 1955 ka caktuar gjithnjë kryeministrin. Ndërsa për herë të parë në vitin 2009 Partia Demokratike e Japonisë, DPJ, e renditur në spektrin qendër/majtas, ka marrë shumicën.

Në shpenzimet sociale publike Japonia në krahasim me kombet industriale me zhvillim të lartë renditet keq. Japonia në vitin 2005 kishte me 22,9% një kuotë të shtetit social nën mesataren, e krahasuar me shtetet e OECD-së (Mesatarja 24,4%) dhe renditej kështu shumë më poshtë se Gjermania (31,1%) apo Suedia (33,6%). Kuota e shtetit social përshkruan raportin e shpenzimeve sociale me prodhimin e brendshëm bruto (PBB).

Japonia karakterizohet njëkohësisht nga jetëgjatësia më e lartë në botë, veçanërisht për gratë, nga një vdekshmëri foshnjore sipas statistikave jashtëzakonisht të ulët dhe nga një shpërndarje çuditërisht e balancuar e të ardhurave. E gjithë kjo flet për aftësinë produktive të sistemit të sigurimeve sociale në Japoni. Sipas anketimeve rreth 90% e japonezëve të shtresës së mesme këtu ndihen pjesëtarë të përfshirë.

Duke mbajtur parasysh situatën tejet të komplikuar, trajtimi i Japonisë kërkon kujdes veçanërisht të madh. Shpesh diskutimet mbi Japoninë reduktohen vetëm në alternativat: A është Japonia një rast unik apo jo? Përgjigja mund të jetë vetëm "pojo". Në Japoni, ashtu sikurse në të gjitha shoqëritë e tjera, gjenden si elementë unikë, ashtu edhe të krahasueshëm. Këtu nuk ka asnjë alternativë përjashtuese, por vetëm të tilla që qëndrojnë pranë e pranë.

23. Ky tekst bazohet te Eun-Jeung Lee (2006), Soziale Demokratie in Japan. Elemente Sozialer Demokratie im japanischen System, në: Thomas Meyer (bot.), Praxis der Sozialen Demokratie, Wiesbaden, faqe 374-444, dhe është ndryshuar vetëm në disa vende.

*Rasti i veçantë
Japoni*

*Kuota e ulët
e shtetit social*

*Aftësi e lartë
shërbimi
e sistemeve të
sigurimit social*

Sistemi politik

Sistemi politik i Japonisë, sipas natyrës së tij, është një demokraci parlamentare. Nga njëra anë të drejtat themelore të qytetarëve garantohen nga kushtetuta e vitit 1947, nga ana tjetër konkurrenca politike për pushtet dhe proceset e vendimmarrjes bazohen tek partitë politike.

Zhvillimi i sistemit politik i kohës së pas Luftës ndahet në përgjithësi në tri faza. Faza e parë (1945-1955) klasifikohet si faza e ndërtimit pas luftës. Faza e dytë (1955-1993) quhet në përgjithësi “sistemi i 55-ës”, ndërsa e treta (pas vitit 1993) cilësohet si faza e reformave politike.

Cilësimi “sistemi i 55-ës” luan me faktin që të dy shtyllat kryesore të sistemit, LDP-ja dhe SPJ-ja (Partia Socialiste e Japonisë), u themeluan në vitin 1955. Pra, më 1955 u shkrinë jo vetëm Jiyuto dhe Minshuto duke krijuar LDP-në konservatore, por edhe krahu i djathtë dhe ai i majtë i socialistëve japonezë, duke krijuar SPJ-në. Fillimisht pritej se prej këtej do të ngrihej një sistem dypartish sipas llojit anglez. Por gjatë viteve 1960-të u konstatua se kishte lindur një sistem i dominuar nga një parti e vetme, një sistem që mund të krahasohet me hegjemoninë e Partisë Socialdemokrate në Suedi, me Partinë Kristian-Demokrate në Itali dhe Partinë e Kongresit Kombëtar në Indi. Vetëm me një pushim dhjetëmujor, nga gushti 1993 deri në qershor 1994, LDP-ja ka dominuar në mënyrë të pandërprerë që nga viti 1955 zhvillimet në parlament dhe ka caktuar kryeministrin. Se çfarë ndryshimesh rezultojnë nga fitorja zgjedhore e DPJ-së në vitin 2009, këtë e tregon koha²⁴.

Kushtetuta dhe sistemi i të drejtave themelore

Kushtetuta e vitit 1947, e cila u fut nga autoriteti pushtues amerikan nën drejtimin e gjeneralit Douglas MacArthur, hyri në fuqi më 3 maj 1947. Vetë kjo kushtetutë është shumë progresive. Përveç nenit 9, i cili ndalon rimilitarizimin e Japonisë, ajo përmban edhe nenin 25, i cili thotë:

“Çdo qytetar ka të drejtë në një masë minimale për jetë të shëndetshme dhe të kulturuar. Në të gjitha fushat e jetës shteti duhet të përpiqet për zhvillimin dhe shtimin e mirëqenies sociale, të sigurisë sociale dhe të shëndetit të përgjithshëm.”

24. Krahazo: Andrew DeWit (2009), „Change” Comes to Japan?, Friedrich-Ebert-Stiftung (botues), Berlin.

Neni 27 i kushtetutës përveç kësaj përmban: “Çdo qytetar duhet të ketë një të drejtë për punë dhe një detyrim për punë.”

Gjykata e Lartësi instanca më e lartë e drejtësisë në Japoni ka vendosur në mënyrë të përsëritur që ky, pra neni 25, nuk përmban asnjë të drejtë zbatuese, por duhet kuptuar si bllok programor. Prej kësaj ky obligim i shtetit social përbën bazat për shtetin dhe legjislacionin.

Nga ky sanksionim i së drejtës për punë dhe të drejtave themelore sociale në kushtetutë shteti japonez është i detyruar të zhvillojë politikën e punësimit dhe të shtetit social. Prandaj, sigurimi dhe krijimi i vendeve të punës në sistemin e mirëqenies zënë një vend të rëndësishëm, ndërsa sistemet e sigurimeve sociale – sigurimi i pensioneve, të sëmurëve, kujdesi shëndetësor dhe sigurimi në punë - duhet të vendosen nga ana e shtetit mbi një bazë financiare solide.

Ekonomia politike

Japonia bën pjesë në të ashtuquajturat ekonomi të koordinuara të tregut. Natyrisht, koordinimi në Japoni zhvillohet brenda rrjeteve të sipërmarrjeve, të cilët përbëhen shpesh nga grupe multisektoriale ose familje sipërmarrjesh. Këto grupe firmash quhen “keiretsu”.

Edhe sistemi i kualifikimit dhe procedurat e transferimit të teknologjisë organizohen nga struktura “keiretsu”. Punëmarrëset dhe punëmarrësit inkurajohen të përvetësojnë aftësitë specifike për firmat e grupit dhe si shpërblim për këtë mund të radhiten në të punësuar për gjithë jetën. Edhe sindikatat janë organizuar sipas sipërmarrjeve, çka i jep kolektivit të drejtën e fjalës për punët e firmës.

Sipërmarrjet japoneze financohen nga kreditë afatgjata bankare, çka u lejon atyre një siguri relativisht të lartë planifikimi dhe bashkë me të edhe një përqendrim të zhvillimi afatgjatë i sipërmarrjes.

Për sa i përket shtetit, direkt pas Luftës së Dytë Botërore e deri në vitet 1960-të, politika e tregut të punës dhe e punësimit ishte në plan të parë. Në fund të viteve 1960-të dhe fillim të viteve 1970-të qeveria e LDP-së, e cila fillimisht ishte vënë nën presion nga aksionet politiko-sociale të kryetarëve të bashkive “progresivë”, pra ata komunistë ose socialdemokratë, filloi të zgjeronte në mënyrë gjithëpërfshirëse edhe sistemet sociale. Në vazhdim të krizës së naftës, pra që nga mesi i viteve 1970-të, u frenua politika sociale ekspansive e fortë, natyrisht pa u kthyer

*Obligimi
i shtetit social*

*Ekonomia
e koordinuar e
tregut
bazuar mbi
rrjetet
e sipërmarrjeve*

mbrapsht. Partnerët socialë dhe aktorët shtetërorë ishin të bashkuar në mendimin që politika shtetërore aktive e tregut të punës duhej zgjeruar, duke pasur parasysh ndërthurjen në rritje të ekonomisë botërore me rreziqet e saj.

Në kuadrin e politikës aktive të tregut të punës u aplikuan masa të ndryshme, si subvencionimi i pagave, kredi të menjëhershme, ndihma financiare për kualifikimin e mëtejshëm. Punësimi që ishte shpërthyes deri në gjysmën e dytë të viteve 1990-të dhe nivelet shumë të ulta të papunësisë provojnë suksesin e kësaj politike.

Shteti social

Edhe pse kushtetuta japoneze me nenin 25 përmban një klauzolë të shtetit social dhe për shkak të këtij neni në vitin 1947 në shumë fusha u reformuan ligjet, apo u aprovuan të reja, Japonia përsëri, ndryshe nga dinamika e saj ekonomike, për një kohë të gjatë kishte një zhvillim të vonë social. Për më tepër Japonia në krahasimet e përqindjes së kontributeve sociale shtetërore të matura me prodhimin social bruto me vendet e tjera të OECD-së gjithnjë radhitej në skajin e poshtëm të shkallës krahasuese.

Por natyrisht po të shohim sektorin social, konstatojmë se fondet e kontributeve sociale shtetërore mund të përfshijnë vetëm një pjesë të shtetit social në Japoni, pasi kontributet sociale operative që vijnë nga ndërmarrjet në Japoni janë të shumta. Këto përbëjnë të paktën 10% të prodhimit social bruto. Për çdo të punësuar dhe çdo muaj sipërmarrjet, për shembull, në vitin 2001, derdhnin mesatarisht një shumë të llogaritur 570 Euro për kontributet sociale ligjore dhe pothuajse 1000 Euro për shërbimet sociale operative.

Për këtë sistemi japonez i mirëqenies përpiqet të mundësojë ekuilibrin social apo integrimin social, jo në mënyrë dytësore nëpërmjet shërbimeve sociale shtetërore të transferimit të individët, por me prioritet nëpërmjet masave politike të punësimit dhe të tregut të punës.

Pensioni

Me reformën e vitit 1973 pagesat e pensioneve për të ashtuquajturin pensionist ekstrem në sigurimin e punëmarrësve u rritën deri në 45% të pagës mesatare dhe u lidhën me indeksin e kostos së jetesës. Por, nga reforma e pensioneve në vitin 1985 kontributet u rritën hap pas hapi

dhe përfitimi i pensionit u ul, në mënyrë që të përballoheshin ndikimet e procesit të shpejtë të plakjes së shoqërisë japoneze deri në vitin 2025. I ashtuquajturi sigurim i pensionit popullor u fut si sigurim i detyrueshëm i varur nga kontributet për të gjithë qytetarët dhe qytetarët. Ai duhet të garantojë një sigurim bazë.

Pensioni mesatar i pleqërisë në sistemin e pensioneve popullore në vitin 2007 ishte rreth 405 Euro në muaj. Në vitin 2007 morën një pension popullor 96% e të gjithë qytetareve dhe qytetarëve mbi 60 vjeç. Në shumicën e rasteve shtohet edhe një pension i ndërmarrjes, i cili në vitin 2004 ishte mesatarisht rreth 1300 Euro, shumë kjo që përbën rreth 53,4% të pagës mesatare, ose një kompensim deri në 64 paga mujore me arritjen e moshës së pleqërisë, të caktuar nga ndërmarrjet.

Sistemi shëndetësor

Sistemi shëndetësor mbështetet mbi parimin e universalitetit dhe shteti e garanton këtë nëpërmjet programit të kujdesit të pacientit, duke u ofruar mbrojtje ndaj sëmundjeve edhe personave në nevojë të pasiguruar. Në sigurimet e punëmarrësve ndaj sëmundjeve, me reformën e vitit 1984, është futur edhe një pjesëmarrje vetjake prej 10%, e cila aktualisht është rritur nga 20 deri 30%. Në këtë mënyrë në vitin 1984 u bë një balancim me sigurimin kombëtar ndaj sëmundjeve, ku janë siguruar ata persona të cilët nuk janë, ose nuk janë më anëtarë të një siguracioni të punëmarrësve, për shembull, ata me aktivitet të pavarur, fshatarët, punonjësit e firmave të vogla dhe pjesëtarët e familjeve të tyre. Në sigurimin kombëtar ndaj sëmundjeve pjesëmarrja vetjake prej shumë kohësh është 30%.

Sistemi arsimor

Arsimi në sistemin e mirëqenies në Japoni ka një vlerë të lartë. Në vitin 2007, 93% e popullsisë japoneze pas mbarimit të shkollimit të detyrueshëm prej nëntë vjetësh, kaluan në shkollën gjimnaziale trevjeçare. Po të llogariten edhe shkollat në distancë dhe shkollat e mbrëmjes, kjo përqindje shkon në 97,3%. Megjithatë shpenzimet shtetërore për arsimin në krahasimin ndërkombëtar janë shumë të pakta. Në raport me BIP në vitin 2006 ato ishin vetëm 3,5%. Ministria Japoneze e Arsimit e shpjegon këtë me përqindjen relativisht të lartë të institucioneve private të arsimit. Kështu, 77,5% e universiteteve japoneze janë private.

*Sistemi
shëndetësor*

Sistemi arsimor

Përfundimi

Në Japoni ekzistojnë të gjithë elementët e një demokracie sociale. E megjithatë kjo demokraci sociale ka lindur ndryshe nga vendet e tjera që janë marrë në analizë, pa një parti të fuqishme socialdemokrate dhe pa bazament ideologjik socialdemokrat. Për më tepër elitat burokratike, akademike dhe politike të Japonisë karakterizohen nga gatishmëria e tyre, pavarësisht nga ideologjia ose dogmatika shkencore, të kërkojnë zgjidhje të zbatueshme dhe për këtë të mbledhin kudo në botë informacione, ide dhe koncepte dhe pastaj i përpunojnë ato.

Një dobësi e sistemit japonez është se ai mbetet i lidhur thellësisht me nënshtetësinë japoneze. Vendi deri tani nuk disponon fare koncepte dhe shtysa praktike për integrimin e pakicave të huaja. Por lëvizja e forcave të punës ka kohë që ka filluar dhe parashikohet të intensifikohet në të ardhmen. Edhe lidhur me barazinë gjinore ka akoma shumë për t'u përmirësuar.

Këto probleme të hapura hedhin një hije mbi demokracinë sociale në Japoni, me sistemet e saj të sigurimit social gjithëpërfshirës dhe me aftësi paguese. Pas reformave social-politike të viteve 1980-të këto u krijuan në diskursin politik, jo më si pengesë për internacionalizimin dhe globalizimin e ekonomisë japoneze. Vërtetë që bashkimet e sipërmarrjeve në vitet 1990-të kërkonin bashkë me rirregullimin e ekonomisë edhe fleksibilizimin e strukturave të punësimit dhe një zvogëlim të kolektivave bazë, në mënyrë që të mund të ekzistojnë edhe në kohët e recesionit dhe të ashpërsimit të konkurrencës globale. Në fakt kjo nuk mund të realizohej me kërkesat e lidhura me tregun e punës në diskursin politik. Ndërkohë janë vetë bashkimet e sipërmarrjeve që janë tërhequr nga kërkesa të tilla dhe kërkojnë nga sipërmarrjet anëtare të tyre dhe nga shteti, që të angazhohen më tepër në fushën e punësimit dhe kualifikimit. Në bazë të sistemeve të siguracioneve të zgjeruara dhe me aftësi paguese nga njëra anë, dhe të anëve të errëta shkaktuar nga problemet e lartpërmendura nga ana tjetër, Japonia mund të karakterizohet si demokraci sociale me suport të mesëm. Interesant është fakti se organizimi i shtetit, i modelit të mirëqenies dhe ekonomisë këtu dallon kryekëput nga Gjermania, e cila gjithashtu klasifikohet si demokraci sociale me suport të mesëm.

Literaturë plotësuese:

Eun-Jeung Lee
(2006),
*Soziale Demo-
kratie in Japan.*
*Elemente Sozi-
aler Demokratie*
im japanischen
System, në:
Thomas Meyer
(Bot.),
*Praxis der So-
zialen Demo-
kratie,*
Wiesbaden,
Faqe 374-444

Japonia		
Kuota e punësimit 2008	70,7% (59,7)	Përqindja e personave të punësuar (gratë) në moshën nga 15 deri 64 vjeç në raport me popullsinë e përgjithshme
Të ardhurat e grave, të matura me të ardhurat e burrave	45 %	Përqindja e të ardhurave që fitojnë gratë në raport me burrat (Burimi: Human Development Index 2009, faqe 186)
Kuota e papunësisë 2008	4 %	Përqindja e të papunëve në gjirin e popullsisë aktive për punë (Burimi: Eurostat)
Kuota e të papunëve për një kohë të gjatë 2008	1.3 %	Përqindja e të papunëve për një kohë të gjatë (12 muaj e më tepër) në gjirin e popullsisë aktive (Burimi: Eurostat)
Pabarazia e të ardhurave/ koeficienti Gini 2009	24,5 %	Shifra e referencës për shpërndarjen e pabarabartë të të ardhurave, sa më e lartë vlera, aq më e madhe pabarazia (Burimi: Human Development Report, 2009, faqe 195)
Indeksi i varfërisë 2009	11,6%	Indeksi i varfërisë lidhet me indikatorë të ndryshëm (jetëgjatësia, shkalla e alfabetizimit, aksesit për kujdesin shëndetësor, 0= varfëria minimale, 100 = varfëria maksimale (Burimi: Human Development Report 2009, faqe 180).
Arsimi: Varësia e suksesit të arsimit nga sfondi social-ekonomik 2006	7,4%	Përqindja në dallimet e arritjeve të nxënësve sipas sfondit social-ekonomik (Burimi: OECD 2007)
Shkalla e organizimit sindikalist 2007	18,3 %	Përqindja e popullsisë aktive për punë e organizuar në sindikata (Burimi: OECD).

5.5. SUEIDIA

Nga Erik Gurgsdies

*Ruajtja
e shtetit
tradicional
të mirëqenies
sociale*

Suedia deri më sot ia ka arritur të ruajë edhe në kohën e globalizmit shtetin tradicional të mirëqenies sociale me shërbime sigurimesh (para publike gjithëpërfshirëse si edhe një sektor të zgjeruar të shërbimeve publike: Kështu suedezët aktualisht kanë një arsim pa pagesë që nga sistemi parashkollor e deri në nivelin e universitetit, shërbimi shëndetësor deri në një farë tarife (hyrjeje) është i lirë për të gjithë suedezët, në rastin e papunësisë paguhen me 80% të pagës së mëparshme deri në një kufi maksimal, dhe në pleqëri kujdeset një sistem pensionesh publike i orientuar nga të ardhurat, përfshirë edhe një pension të garantuar, të financuar nga taksat për sigurimin ndaj varfërisë dhe në pleqëri edhe për njerëzit pa të ardhura të mjaftueshme.

Po të shohim faktet se në sektorin publik të Suedisë janë punësuar një e treta e personave të aftë për punë, çka i çon kuotat e taksave në krye të renditjeve ndërkombëtare, dhe se Suedia në fillim të viteve 1990-të u zhyt në krizën e saj më të rëndë ekonomike që nga depresioni i madh, lind pyetja se si ka mundur që shteti i mirëqenies sociale në Suedi edhe në kohën e globalizmit mund të mbrohet ndryshe nga pothuajse në të gjitha vendet e tjera.

*Homogjeniteti
social-kulturor
karakterizon
kulturën
politike*

Interesant në këtë sfond janë kultura politike dhe mentaliteti i suedezëve, të cilët që nga kohët e vjetra e deri tani janë karakterizuar nga idetë e barazisë. Ato vijnë tashmë që nga format e jetesës së lashtë gjermanike, të cilat nuk arriti t'i trondiste as edhe feudalizmi i dobët. Edhe homogjeniteti social-kulturor, deri para pak kohësh i veçantë, mund të vlejë si një shpjegim për këtë. Komunitatet relativisht autonome luajnë këtu një rol vendimtar për jetën në vend. Në një vend ku raportet e shpërndarjes gjeografike vazhdojnë të ruajnë akoma elementë të ciklit të mbyllur, vetadministrimi lokal tregon një rrënjosje të thellë në ndërgjegjen e popullit. E për këtë kujdesen ligjet kuadër centraliste shtetërore dhe fondet financiare qendrore të orientuara nga objektivat, për një unifikim të lartë të kushteve të jetës në vend.

Sistemi politik

Në sistemin politik të Suedisë konsensusi, bisedimet dhe integrimi luajnë një rol të rëndësishëm. Në përputhje me këtë procesi suedez i ligjvënies karakterizohet nga një pjesëmarrje e lartë e institucionalizuar e shoqërisë civile.

Në fillim merret vendimi i qeverisë për ngritjen e një komiteti për analizimin e gjendjes. Vërtet që iniciativa përgjithësisht vjen nga qeveria, por iniciatorë mund të jenë edhe Rajhstagu (parlamenti), autoritetet shtetërore ose dhe grupe shoqërore (!). Komiteti, sipas ligjit të aprovuar, përbëhet nga politikanë, ekspertë dhe përfaqësues të grupeve të prekura shoqërore, ai aprovon një tematikë problemore, e cila përbën edhe bazën e diskutimit. Mbi këtë procedurë të ashtuquajtur Remiss bazohet ideja e një shoqërie të orientuar nga kompromisi dhe konsensusi.

*Konsensusi
dhe integrimi
karakterizojnë
sistemin politik*

Në peizazhin partiak të Suedisë socialdemokracia që nga fillimi i viteve 1930-të ka zënë një pozicion dominant. Atëherë, pra në depresionin e madh, ajo u pozicionua kundër rrymës ekonomike tradicionale me një program punësimi publik, të financuar me kredi për përmirësimin e infrastrukturës, por edhe të situatës së banimit të familjeve me shumë fëmijë. “Në Evropën Qendrore u ndërtuan barrikada nëpër rrugë. Në Suedi kërkohej që në kryqëzimet e lira nga shinat të ecëj përpara”, theksonte kryeministri shumëvjeçar Tage Erlander në orientimin politik të programit të punësimit. Suksemi i programit të punësimit rriti jo vetëm rezultatet zgjedhore të Partisë Socialdemokrate të Punës së Suedisë (SAP), por edhe numrin e anëtarëve të socialdemokracisë, si edhe të sindikatës punëtore LO (organizata vendore), të lidhur ngushtë ideologjikisht me të. Pozicioni dominues i socialdemokracisë u favorizua edhe nga fragmentarizimi i opozitës borgjeze. Kështu, përballë të ashtuquajturit bllok socialist të socialdemokratëve, të gjelbërve dhe të majtëve dhe të ish-eurokomunistëve qëndron i ashtuquajturi bllok borgjez me konservatorët, liberalët, qendrën fshatare dhe demokristianët, të cilët së bashku që nga viti 2006, përbëjnë qeverinë. Edhe pas fitores zgjedhore të bllokut borgjez në 2006-ën një shumicë solide e partive mban pozicion dashamirës ndaj shtetit të mirëqenies sociale.

*Pozicioni
dominant i
socialdemokra-
cisë*

Kushtetuta dhe sistemi i të drejtave themelore

Kushtetuta suedeze përmban jo vetëm të drejta negative të lirisë, por edhe shumë të drejta pozitive. Edhe pse të drejtat themelore sociale, ekonomike dhe kulturore, pra të drejtat pozitive të lirisë juridikisht nuk janë të detyrueshme si të drejtat politike bazë, përsëri ato japin objektiva që duhen arritur në aspektin politiko-shoqëror. Kështu në kushtetutë thuhet: “Mirëqenia personale, ekonomike dhe kulturore e individit duhet të jetë qëllimi bazë i aktiviteteve publike. Është detyrë e shoqërisë të sigurojë veçanërisht të drejtën për punë, banesë dhe

*Të drejtat
negative
dhe pozitive të
lirisë
në kushtetutë*

arsim, të garantojë sigurinë sociale në kushte të mira jetese” (përkthim i autorit). Të detyrueshme juridikisht apo jo, vetëm fakti që këto qëllime politiko-shoqërore kanë zënë një vend të veçantë në kushtetutë, tregon se ato janë ngulitur thellë në ndërgjegjen publike. Kjo pasqyrohet edhe në konstruksionin e shtetit suedez të mirëqenies sociale dhe të ekonomisë së tij të tregut/ekonomisë së tij politike.

Ekonomia politike

Politika ekonomike suedeze mbështetet në të ashtuquajturin model Rehn-Meidner. Ai ka marrë emrin e dy ekonomistëve sindikalistë, Gösta Rehn dhe Rudolf Meidner. Të dy zhvilluan në vitin 1951 një model të përgjithshëm ekonomik, i cili duhet të mbante të bashkuar punësimin e plotë me një “politikë page solidare”, pa shkaktuar procese inflacioniste.

Idėja bazë ishte që punësimi i plotë i vazhdueshëm nuk mund të arrihet nëpërmjet një kërkesë përgjithësisht të lartë të mbarë ekonomisë, edhe sikur kjo të krijohej nga një zhvillim i favorshëm i ekonomisë botërore apo nga programet e konjunkturës kombëtare. Meqenëse degët e veçanta të ekonomisë rriten vazhdimisht me një ritëm të ndryshëm, atëherë një kërkesë qëndrueshmërisht e lartë e gjithë ekonomisë çon shpejt në krijimin e sektorëve me mangësi. E megjithatë, për ta vazhduar rritjen, sektorët me mungesa kërkojnë të marrin forca pune nga degët e tjera.

Politika e pagës solidare

Në mënyrë rënduese erdhi këtu fakti që sindikata punëtore suedeze, që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore, ndiqte një të ashtuquajtur “politikë page solidare”. Kjo ka dy qëllime esenciale: Nga njëra anë ajo ka pretendimin të zbatojë parimin “pagë të barabartë për punë të barabartë” dhe orientohet drejt zhvillimit të produktivitetit mesatar të punës. Nga ana tjetër diferenca e pagave midis punëve të ndryshme, në përgjithësi, duhet zvogëluar. Premisë për arritjen e këtyre qëllimeve është prioriteti i bisedimeve qendrore për pagat, përpara niveleve që vijnë më pas. Për të penguar që rezultatet e një “politike të pagës solidare” të humbasin përsëri nga inflacioni, në modelin Rehn-Meidner u sugjerua një politikë financiare publike rixhide, e cila nëpërmjet tepricave buxhetore mban nën kontroll gjithë kërkesën ekonomike.

Një koncept i tillë politiko-ekonomik i shtyn sipërmarrjet me produktivitet të ulët drejt një mbrojtjeje dyfishe. Nga njëra anë në bazë të strukturës së keqe të çmimeve dhe koston së tyre dhe me një kërkesë të moderuar, ato gjenden

përballë problemeve të tregut. Nga ana tjetër “politika solidare e pagës” ashpëson situatën tashmë problematike të konkurrencës dhe kostos, duke zbatuar kërkesat për paga në të gjithë sektorët dhe të gjitha sipërmarrjet, duke mbajtur ritmin me zhvillimin e produktivitetit mesatar të punës. Këtu sipërmarrjet me produktivitet të lartë favorizohen në mënyrë të dyfishtë: Nga njëra anë në bazë të situatës së tyre të mirë të kostos dhe për pasojë edhe të rregullimit të favorshëm të çmimeve ato përballen me një kërkesë adekuate. Nga ana tjetër kontratat tarifore të orientuara nga produktiviteti mesatar nuk shtrin hapësirën shumë produktive të shpërndarjes. Kështu, këto sipërmarrje, për pasojë furnizohen sërish me kapital për krijimin e vendeve të reja të punës shumë produktive.

Pra të humburit nga kombinimi i politikës fiskale restriktive dhe i “politikës solidare të pagave” janë sipërmarrjet me produktivitet të ulët si edhe të punësuarit në to. Papunësia që rezulton prej kësaj, është kuptuar jo si një problem publik defensiv, por si një detyrë publike ofensive e përshtatjes, e cila duhet të përballojë një politikë aktive të tregut të zgjeruar të punës: Nëpërmjet një sistemi gjithëpërfshirës të aktiviteteve të kualifikimit dhe ndihmave të mobilitetit kërkohen njerëz të papunë për t’i kualifikuar pastaj për punë produktive, pra të paguara mirë. E parë kështu, politika restriktive fiskale, “politika solidare e pagave” dhe politika aktive e tregut të punës veprojnë në drejtim të një rinovimi të vazhdueshëm dhe një përshtatjeje të strukturave të ekonomisë suedeze ndaj kërkesave të tregut botëror.

Ky është gjithashtu edhe një shpjegim esencial i rrugës së shpejtë suedeze të daljes nga kriza e viteve 1990-të: Meqenëse ky ishte një sistem i shtrirë mirë i politikës aktive të tregut të punës dhe meqenëse palët pjesëmarrëse në bisedimet tarifore tradicionalisht parapëlqejnë punësime me produktivitet të lartë për të mbrojtur vendet ekzistuese të punës me produktivitet të ulët, prandaj edhe inovacionet realizohen shpejt me veprim drejt punësimit: Suedia – e pozicionuar në një konjunkturë të mirë ndërkombëtare – e ka rritur volumin e eksportit të saj vetëm brenda pesë vjetësh nga 33 në 45%, d.m.th. me një të tretën.

Shteti social

Në kuadrin e procesit të rritjes ekonomike të pasluftës, Suedia u gjend në një ristrukturim të shpejtë nga një shoqëri e varfër e punëtorëve dhe fshatarëve në një shoqëri të nëpunësve me rritje të shpejtë të mirëqenies private. Duke mbajtur parasysh këto zhvillime social-kulturore, politika e sigurimit bazë (p.sh. pension të barabartë popullor për mbretin dhe

*Papunësia
si detyrë publike
e përshtatjes*

*Zhvillimet
social-
strukturore
kërkojnë
riorientim
të politikës
sociale*

lypësin) u zëvendësua strategjikisht nga sigurimi i standardit të jetesës (p.sh. një pension shtesë, i orientuar nga madhësia e të ardhurave) për të arritur mobilizimin e zgjedhësve, të cilët siguronin ruajtjen e pushtetit politik.

Shteti suedez i mirëqenies sociale i mbron qytetarët e vet jo vetëm nëpërmjet performancës monetare publike gjatë shfaqjes së risqeve elementare të jetës. Për këtë ekziston një sektor i zgjeruar i shërbimeve, i cili kujdeset për kujdesin falas ose pothuajse falas të fëmijëve dhe të moshuarve, për shërbime shëndetësore dhe arsimore, si edhe për kualifikimin politik të tregut të punës. "Secili paguan taksat sipas të ardhurave të tij dhe mirëqenia që ofron shoqëria, mbështetet më tepër mbi nivelin e jetesës së njerëzve se sa te kuotat që personi ka paguar vetë. Shërbimet nuk janë rezultat i vendimeve që merren në treg, por të lidhura me procesin politik." (Meidner/Hedborg 1984: 56)

Ekspansioni i sektorit publik të shërbimeve

Ekspansioni i shpejtë i sektorit të shërbimeve publike në kohën e punësimit të plotë të vazhdueshëm, në përgjithësi mund të menaxhohej vetëm nga aktivizimi i grave. Në periudhën nga viti 1960 deri në vitin 1990 shkalla e punësimit të suedezeve të afta për punë u rrit nga mesatarja evropiane 50% në nivelin rekord botëror prej 83%.

Shtyllat e shtetit të mirëqenies sociale veç e veç janë organizuar si më poshtë:

Pensioni

Pensioni

Sistemi i vjetër i pensioneve (pensioni popullor për të gjithë plus pensioni i varur nga të ardhurat e siguruara nëpërmjet punës) në vitet 1990-të u reformua "sipas ndryshimeve demografike". Pretendimet për pension mund të merren duke filluar nga moshë 61 deri në 67 vjeç. Pensioni i garantuar, i financuar nga taksat, shkon te çdo person pa ose me të ardhura të pamjaftueshme, i realizuar nga aktiviteti i tij i punës, ku pasuria private nuk llogaritet. Të punësuarit paguajnë një kontribut fiks prej 16% për pensionin e tyre nga të ardhurat dhe investojnë edhe 2,5% individualisht në fondet e pasurisë, nga të cilat pastaj paguhet një pension kuotash kapitalist-privat.

Sigurimi i të papunëve

Sigurimi i të papunëve

Sigurimi i të papunëve deri tani bazohet mbi vullnetarizmin: Arkat administrohen nga sindikatat, çka shihet edhe si një arsye e rëndësishme

për shkallën tepër të lartë të organizimit sindikalist. Kontributet deri tani kanë qenë të ulëta, shërbimet e paguara në pjesën më të madhe të financuara nga taksat. Në kontributet, koalicioni borgjez që qeveris që nga 2006-a, ka shënuar përkeqësime të dukshme, aq sa shumë njerëz janë larguar nga këto kasa dhe nga sindikatat. Niveli i organizimit sindikalist për pasojë ka rënë aq fort sa asnjëherë tjetër në 100 vjet. Për anëtarët e arkave shuma monetare e të papunëve aktualisht është 80% e të ardhurave me një mbulesë nga kontributet mbi të ardhurat. 80% paguhen duke filluar nga dita e tetë e papunësisë për 200 ditë, pastaj kjo jepet e pakufizuar në masën 70%. Për ata që nuk janë anëtarë, ka një asistencë bazë shtetërore më të ulët.

Ndihma sociale

Të gjithë banorët e Suedisë kanë pretendimin për të përfituar shpenzimet për kujdesin shëndetësor. Kjo organizohet nga parlamentet e provincave dhe përgjithësisht financohet nga taksimi direkt i të ardhurave. Pjesërisht shtohet edhe tatimi i pacientëve, i cili mund të ndryshojë nga provinca në provincë. Përveç kësaj të gjithë ata, të ardhurat vjetore të të cilëve janë më të larta se 6.000 Kronen, kanë pretendimin për dëmshpërblim gjatë humbjes së të ardhurave. Ky sigurim ndaj sëmundjeve financohet nga përqindja e detyrueshme që duhet të derdhin punëdhënësit dhe nga kontributet e siguracioneve që mblidhen bashkë me taksat.

Edhe pse Suedia aktualisht ka kuotën më të lartë tatimore ndër vendet e OECD-së, kjo nuk do të thotë aspak se shteti i mirëqenies sociale na qenka jashtëzakonisht i kushtueshëm. Sepse për sigurimin nga rreziqet elementare të jetës (papunësia, sëmundja, pleqëria) amerikanet dhe amerikanët, privatisht, nuk paguajnë më pak se sa duhet të japin suedezët nëpërmjet taksave dhe tatimeve sociale. Dallimi vendimtar qëndron në faktin se në Suedi e gjithë popullsia është e siguruar, ndërsa në SHBA mbeten jashtë sistemit të sigurimit privat të gjithë ata që nuk kanë fuqi pagese.

Në qoftë se gjatë procesit të globalizimit kemi hapjen e kufijve ekonomikë, atëherë konkurrenca e importit vë nën presion grupet e të punësuarve me produktivitet të ulët brenda vendit. Në qoftë se arrihet, që nëpërmjet sigurimeve bujare të të ardhurave dhe ofertave për kualifikim të zvogëlohet frika e punonjësve nga humbja e vendit të punës dhe e statusit që kanë, atëherë rritet hapësira e zhvillimit politik-ekonomik dhe ulen kostot e politikës së brendshme ndaj një hapeje

Ndihma sociale

*Parimi
universalist*

ekonomike me jashtë. Duke pasur parasysh marrëdhëniet e globalizuara ekonomike, një politikë e mirëqenies sociale e drejtuar drejt kualifikimit dhe sigurimit të statusit është një instrument superior politiko-ekonomik ndaj një politike sociale të drejtuar vetëm nga mbrojtja e humbësve ekonomikë.

Sistemi arsimor

Sistemi arsimor

Meqenëse “lënda e parë” e vërtetë e shoqërive moderne industriale dhe atyre të shërbimeve konsiston në potencialin e dijes si edhe në trajtimin krijues të këtyre njohurive, prandaj edhe sistemi arsimor merr një rëndësi strategjike për zhvillimin e mëtejshëm shoqëror në një ekonomi botërore të globalizuar. Aktualisht Suedia ka një ofertë të gjerë për kopshte fëmijësh, edhe pse kjo akoma nuk është falas. Duke filluar nga parashkollimi deri në universitet institucionet arsimore mund të ndiqen falas.

Shkolla e përgjithshme e integruar ndjek parimin “Të gjithë pranohen”. Pothuajse të gjithë ata që mbarojnë shkollën e përgjithshme kalojnë vullnetarisht në gjimnaz. Shkolla e lartë në fund të viteve 1970-të u hap për të gjithë: të gjithë ata që janë në gjendje të marrin pjesë në kurset e dëshiruara të shkollimit mund të studiojnë kur ka vende studimi, përndryshe ekziston lista e pritjes e përpiluar sipas kriterëve të ndryshme. Përveç këtyre ekziston edhe shkollimi për të rritur që tashmë ka një shtrirje të gjerë.

Përfundimisht: rëndësia strategjike e shtresës së mesme

Shteti skandinav i mirëqenies sociale do të ekzistojë aq gjatë sa shtresa e mesme të vlerësojë kontributet e saj. Ajo paguan pjesën e luanit për taksat publike dhe pret për këtë shërbime cilësisht të larta. Në qoftë se shërbimet e sigurisë publike bien nën përfytyrimin e shtresës së mesme, atëherë ajo do të kërkojë oferta në treg, të cilat duhen paguar privatisht. Por meqenëse asnjëri nuk ka dëshirë të paguajë dyfish, atëherë kjo, në një periudhë afatmesme, do të precipitojë në votat e dukshme të zgjedhësve kundër shtetit të mirëqenies me taksa të larta. Nuk janë për t’u siguruar publikisht vetëm të varfërit dhe humbësit ndaj kufirit minimal të ekzistencës (shih shembullin Pagesa e Papunësisë II në Gjermani), por e gjithë shoqëria nëpërmjet kontributeve cilësisht me vlerë të lartë – kjo është përgjigja skandinave ndaj çështjes së shtetit të mirëqenies sociale.

Literaturë plotësuese:

Erik Gurgsdies
(2006), *Schwe-
den:
Zivilgesellschaft
im universal-
istischen Sozial-
staat*, në:
Thomas Meyer
(Bot.),
*Praxis der So-
zialen Demo-
kratie,
Wiesbaden*
Faqe 47-129

Suedia		
Kuota e punësimit 2008	74,3% (71,8)	Përqindja e personave të punësuar (gratë) në moshën nga 15 deri 64 vjeç në raport me popullsinë e përgjithshme (Burimi: Eurostat)
Të ardhurat e grave, të matura me të ardhurat e burrave	67 %	Përqindja e të ardhurave që fitojnë gratë në raport me burrat (Burimi: Human Development Index 2009, faqe 186)
Kuota e papunësisë 2008	6,2 %	Përqindja e të papunëve në gjirin e popullsisë aktive për punë (Burimi: Eurostat)
Kuota e të papunëve për një kohë të gjatë 2008	0,8 %	Përqindja e të papunëve për një kohë të gjatë (12 muaj e më tepër) në gjirin e popullsisë aktive (Burimi: Eurostat)
Pabarazia e të ardhurave/ koeficienti Gini 2009	25%	Shifra e referencës për shpërndarjen e pabarabartë të të ardhurave, sa më e lartë vlera, aq më e madhe pabarazia (Burimi: Human Development Report, 2009, faqe 195)
Indeksi i varfërisë 2009	6 %	Indeksi i varfërisë lidhet me indikatorë të ndryshëm (jetëgjatësia, shkalla e alfabetizimit, aksesit për kujdesin shëndetësor, 0= varfëria minimale, 100 = varfëria maksimale (Burimi: Human Development Report 2009, faqe 180).
Arsimi: Varësia e suksesit të arsimit nga sfondi social-ekonomik 2006	10,6%	Përqindja në dallimet e arritjeve të nxënësve sipas sfondit social-ekonomik (Burimi: OECD 2007)
Shkalla e organizimit sindikalist 2007	70,8 %	Përqindja e popullsisë aktive për punë e organizuar në sindikata (Burimi: OECD).

Në bazë të sanksionimit kushtetues të të drejtave pozitive dhe negative të lirisë në Suedi janë garantuar gjerësisht jo vetëm vlefshmëria formale, por edhe funksionimi real i të drejtave themelore. Prandaj, Suedia klasifikohet si demokraci sociale me suport të lartë.

6. NJË FILLIM NË FUND

Si mund ta mbyllësh një udhërrëfyes për bazat e demokracisë sociale? Të përmbledhësh përfundimet, të përmendësh rëndësinë e tyre dhe kështu ta përfundosh vëllimin – ky do të ishte njëri variant. Por do të ishte njëkohësisht edhe varianti i gabuar, pasi ky vëllim ka treguar se demokracia sociale nuk mund të përfundohet kaq thjesht, as si një model mendimi, as si një detyrë politike. Përkundrazi: Rruga e demokracisë sociale – si ide dhe si veprim politik – duhet provuar vazhdimisht, duhet përshtatur dhe menduar sërish, kur duam që këtë rrugë ta ndjekim me sukses.

Diskutimi mbi demokracinë sociale ka treguar se nuk duhet të mbetemi në vend, por ta hedhim vështrimin drejt zhvillimeve shoqërore, të kuptojmë shanset dhe rreziqet dhe t'i përdorim pastaj për navigimin politik. Kjo e dallon demokracinë sociale nga modelet e tjera politike. Ajo nuk mbërthehet as pas trashëgimisë, por as mbyll sytë para realiteteve të ndryshuara dhe sfidave të reja.

Një nga sfidat qendrore të viteve dhe dekadave të ardhshme do të jetë trajtimi i globalizimit. Ai mbart shanse dhe rreziqe njëkohësisht. Partia Socialdemokrate e Gjermanisë në “Programin e saj të Hamburgut” i ka pranuar këto sfida. Ajo ka emërtuar detyrat për çështjet esenciale të globalizimit, parë nga perspektiva e demokracisë sociale:

Mirëqenie, drejtësi dhe demokraci

“Shekulli i 21-të është shekulli i parë vërtet global. Kurrë më parë njerëzit në botë nuk kanë pasur kaq shumë nevojë për njëri-tjetrin. [...] Ky shekull do të jetë ose një shekull i përparimit social, ekologjik dhe ekonomik, i cili do t’u krijojë të gjithë njerëzve më tepër mirëqenie, drejtësi dhe demokraci, ose ai do të jetë shekulli i luftërave pezmatuese të shpërbërjes dhe të dhunës së shfrenuar. Mënyra e sotme e jetesës e shoqërive tona industriale e stërmundon ngarkesën ekologjike të tokës [...] Në lojë janë një jetë e denjë njerëzore, paqja e botës dhe jo më pak banueshmëria e planetit tonë.” (Programi i Hamburgut 2007: 6)

Tregje funksionuese financiare dhe kapitali

“Një ekonomi popullore moderne, e ndërthurur globalisht, ka nevojë për një treg funksionues kapitali dhe financash. Ne duam t’i shfrytëzojmë potencialet e tregjeve të kapitalit për rritje cilësore. [...] Atje ku tregjet financiare tentojnë vetëm fitime afatshkurtra, rrezikojnë strategjitë afatgjata të rritjes ekonomike të sipërmarrjeve dhe asgjësojnë vende pune. Ne duam që edhe me ndihmën e së drejtës fiskale dhe të aksioneve të forcojmë investitorët, të cilët në vend të fitimit të shpejtë mbajnë parasysh një angazhim afatgjatë.[...] Me rrjetëzimin ndërkombëtar në rritje të tregjeve të mallrave dhe tregjeve financiare rregullimi i tyre ndërkombëtar do të bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm.” (Programi i Hamburgut 2007: 47)

Punë e mirë

“Vetëm kush ka perspektiva të besueshme në jetën e tij, ai mund të shpalojë plotësisht talentin e tij dhe aftësinë e tij krijuese. Puna e mirë lidh fleksibilitetin dhe sigurinë. Tempi i përparimit shkencor, ndryshimet gjithnjë e më të shpejta në botën e punës dhe konkurrenca e ashpërsuar kërkojnë më tepër fleksibilitet. Njëkohësisht puna e mirë ofron më shumë shanse për zhvillimin individual të jetës.[...] Për të lidhur sigurinë me fleksibilitetin dhe për të garantuar sigurinë gjatë transformimeve, ne duam të zhvillojmë një politikë moderne të kohës së punës dhe t’i kthejmë sigurimet e të papunëve në një garanci të punës.

Aq sa kërkohet dhe sa i dëshirueshëm është fleksibiliteti, aq më pak duhet keqpërdorur. Ne duam të forcojmë marrëdhëniet e punës pa afat dhe të siguruara nga ana sociale. Ne duam të kapërcejmë punën e paqëndrueshme, në mënyrë që punëmarrësit të mos jenë të pambrojtur.” (Programi i Hamburgut 2007: f. 54)

Këto pika tregojnë se demokracia sociale duhet zhvilluar vazhdimisht më tej dhe duhet të ballafaqohet me sfida të reja - në ndërgjegjen e themeleve të saj dhe me shikim të qartë për realitetin.

Ne dëshirojmë t'u ftojmë të merrni pjesë në diskutimin e demokracisë sociale. Akademia për Demokraci Sociale e Fondacionit Friedrich Ebert ju ofron për këtë hapësirën e duhur. Tetë module seminaresh merren me vlerat themelore dhe fushat e praktikës së demokracisë sociale:

Bazat e demokracisë sociale

Ekonomia dhe demokracia sociale

Shteti social dhe demokracia sociale

Globalizimi dhe demokracia sociale

Evropa dhe demokracia sociale

Integrimi, imigrimi dhe demokracia sociale

Shteti, shoqëria civile dhe demokracia sociale

Paqja dhe demokracia sociale

BIBLIOGRAFIA

Max Adler (1926), *Neue Menschen. Gedanken über sozialistische Erziehung*, 2., vermehrte Aufl., Berlin.

Michel Aglietta (2000), *Ein neues Akkumulationsregime. Die Regulationstheorie auf dem Prüfstand*, übersetzt von Marion Fisch, Hamburg.

Detlev Albers dheAndrea Nahles (2007), *Linke Programmbausteine. Denkanstöße zum Hamburger Programm der SPD*, Berlin.

Elmar Altvater (2006), *Das Ende des Kapitalismus, wie wir ihn kennen. Eine radikale Kapitalismuskritik*, 4. Aufl., Münster.

17. BAföG-Bericht (2007), Siebzehnter Bericht nach § 35 des Bundesausbildungsförderungsgesetzes zur Überprüfung der Bedarfssätze, Freibeträge sowie Vomhundertsätze und Höchstbeträge nach § 21 Abs. 2, Drucksache 16/4123, Berlin.

Kurt Beck dheHubertus Heil (Botues) (2007), *Soziale Demokratie im 21. Jahrhundert. Lesebuch zur Programmdebatte der SPD*, Berlin.

Dietrich Benner dheFriedhelm Brüggen (1996), *Das Konzept der Perfectibilité bei Jean-Jacques Rousseau. Ein Versuch, Rousseaus Programm theoretischer und praktischer Urteilsbildung problemgeschichtlich und systematisch zu lesen*, nê: Otto Hansmann (Botues), Seminar: Der pädagogische Rousseau, Bd. II: Kommentare, Interpretationen, Wirkungsgeschichte, Weinheim, f. 12–48.

Isaiah Berlin (1958), *Two Concepts of Liberty*, Oxford (u. a.).

Eduard Bernstein (1899), *Die Voraussetzungen des Sozialismus und die Aufgaben der Sozialdemokratie*, Stuttgart.

Hans-Jürgen Bieling, Klaus Dörre e të tjerë (2001), *Flexibler Kapitalismus. Analysen, Kritik, politische Praxis*, Hamburg.

Pierre Bourdieu e të tjerë (1997), *Das Elend der Welt. Zeugnisse und Diagnosen alltäglichen Leidens an der Gesellschaft*, Konstanz.

Ulrich Brinkmann, Karoline Krenn dheSebastian Schief (Botues) (2006), *Endspiel des Kooperativen Kapitalismus. Institutioneller Wandel unter den Bedingungen des marktzentrierten Paradigmas*, Wiesbaden.

Ulrich Brinkmann, Klaus Dörre e të tjerë. (2006), *Prekäre Arbeit. Ursachen, Ausmaß, soziale Folgen und subjektive Verarbeitungsformen unsicherer Beschäftigungsverhältnisse*, Botuar nga Fondazione "Friedrich-Ebert-Stiftung", Bonn.

Hubertus Buchstein, Michael Hein dheDirk Jörke (2007), *Politische Theorien*, Wochenschau für poli-

tische Erziehung, Sozial- und Gemeinschaftskunde, Frankfurt am Main.

Erwin Carigiet (2001), *Gesellschaftliche Solidarität. Prinzipien, Perspektiven und Weiterentwicklung der sozialen Sicherheit*, Basel / Genf / München.

Robert Castel (2000), *Die Metamorphose der sozialen Frage. Eine Chronik der Lohnarbeit*, aus dem Französischen von Andreas Pfeuffer, Konstanz.

Manuel Castells (2003), *Das Informationszeitalter, Völlimi 1: Der Aufstieg der Netzwerkgesellschaft; Völlimi 2: Die Macht der Identität; Völlimi 3: Jahrtausendwende*, Wiesbaden.

Robert A. Dahl (2000), *Polyarchy: Participation and Opposition*, New Haven.

Alex Demirovic (2007), *Demokratie in der Wirtschaft. Positionen, Probleme, Perspektiven*, Münster.

Andrew DeWit (2009), *„Change“ Comes to Japan?*, Friedrich-Ebert-Stiftung (Botues), Berlin.

Die Linke (2007), *Programmatische Eckpunkte der Partei Die Linke*, nê: www.die-linke.de, Stand: 14.10.2007.

Klaus Dörre (2005), *Prekarität – eine arbeitspolitische Herausforderung*, nê: WSI-Mitteilungen 5 / 2005, f. 250–258.

Dieter Dowe dheKurt Klotzbach (Botues) (2004), *Programmatische Dokumente der Deutschen Sozialdemokratie*, 4., überarbeitete und aktualisierte Aufl., Bonn.

Hermann Duncker (1931), *Einleitung*, nê: Max Beer, *Allgemeine Geschichte des Sozialismus und der sozialen Kämpfe*, mit Ergänzungen von Dr. Hermann Duncker, 7. Aufl., Berlin, f. 9.

Fritz Erler (1947), *Sozialismus als Gegenwartsaufgabe*, Schwenningen.

Walter Euchner, Helga Grebing e të tjerë (2005), *Geschichte der sozialen Ideen in Deutschland. Sozialismus – Katholische Soziallehre – Protestantische Sozialethik*. Ein Handbuch, 3. Aufl., Wiesbaden.

Nancy Fraser dheAxel Honneth (2003), *Umverteilung oder Anerkennung? Eine politisch-philosophische Kontroverse*, Frankfurt am Main.

Eurostat, *Statistische Datenbank der Europäischen Kommission*, http://epp.eurostat.ec.europa.eu/portal/page/portal/statistics/search_database.

Helga Grebing (2007), *Geschichte der deutschen Arbeiterbewegung. Von der Revolution 1848 bis ins 21. Jahrhundert*, Berlin.

Görg Haverkate (1992), *Verfassungslehre. Verfassung als Gegenseitigkeitsordnung*, München.

Hamburger Programm (2007), *Grundsatzprogramm der Sozialdemokratischen Partei Deutschlands*, be-

schlossen auf dem Hamburger Bundesparteitag der SPD am 28. Oktober 2007.

Wolfgang Heide Meyer (Botues) (1997), Die Menschenrechte. Erklärungen, Verfassungsartikel, internationale Abkommen, 4., erneuerte und erweiterte Aufl., Paderborn / München / Wien / Zürich.

Christoph Heine / Heiko Quast (2009), Studien- und Ausbildungswahl ein halbes Jahr nach Schulabgang. Ergebnisse einer Vorabauswertung (vorläufige Fassung). HIS: Projektbericht November 2009. Hannover.

Thomas Heinrichs (2002), Freiheit und Gerechtigkeit. Philosophieren für eine neue linke Politik, 1. Aufl., Münster.

Karl Otto Hondrich dhe Claudia Koch-Arzberger (1994), Solidarität in der modernen Gesellschaft, Frankfurt am Main.

Wolfgang Iserstedt (2007), Die wirtschaftliche und soziale Lage der Studierenden in der Bundesrepublik Deutschland 2006. 18. Sozialerhebung des Deutschen Studentenwerks, durchgeführt durch HIS Hochschul- Informations-System, Botues: Bundesministerium für Bildung und Forschung, Bonn/ Berlin 2007.

Immanuel Kant (1963), Grundlegung zur Metaphysik der Sitten, nê: Kants Werke in sechs Bänden, botuar nga W. Weischedel, Bd. IV, Darmstadt.

Wolfgang Kersting (Hg.) (2000), Politische Philosophie des Sozialstaats, Weilerswist.

Jürgen Kocka (1995) (Botues), Bürgertum im 19. Jahrhundert, Völlimi 1: Einheit und Vielfalt Europas, Göttingen.

Ferdinand Lassalle (1987), Reden und Schriften, botuar nga Jürgen Friederici, 1. Aufl., Leipzig.

Detlef Lehnert (1983), Sozialdemokratie zwischen Protestbewegung und Regierungspartei 1848–1983, 1. Aufl., Frankfurt am Main.

John Locke (1977), Zwei Abhandlungen über die Regierung, botuar nga Walter Euchner, 1. Aufl., Frankfurt am Main.

Rosa Luxemburg (1899), Sozialreform oder Revolution? Mit einem Anhang Miliz und Militarismus, Leipzig, nê: Rosa Luxemburg, Gesammelte Werke, Bd. 1: 1893–1905, Erster Halbband, 7. Aufl., Berlin 1990, f. 367–466.

Karl Marx (1998), Kritik der politischen Ökonomie (= MEW 23), Berlin.

Rudolf Meidner dhe Anna Hedborg (1984), Modell Schweden. Erfahrungen einer Wohlfahrtsgesellschaft, Frankfurt/New York.

Charles de Secondat Montesquieu (1992), Vom Geist der Gesetze, botuar nga Ernst Forsthoff, Bd. 1, Tübingen.

Wolfgang Merkel e të tjerë (2006), Die Reformfähigkeit der Sozialdemokratie. Herausforderungen und Bilanz der Regierungspolitik in Westeuropa, 1. Aufl., Wiesbaden.

Thomas Meyer dhe Nicole Breyer (Mitarbeit) (2005), Die Zukunft der Sozialen Demokratie, Bonn.

Thomas Meyer (2005) (Botues), Theorie der Sozialen Demokratie, 1. Aufl., Wiesbaden.

Thomas Meyer (2006), Praxis der Sozialen Demokratie, 1. Aufl., Wiesbaden.

Gero Neugebauer (2007), Politische Milieus in Deutschland. Die Studie der Friedrich-Ebert-Stiftung, Bonn.

Matthias Platzeck, Frank-Walter Steinmeier und Peer Steinbrück (Hg.) (2007), Auf der Höhe der Zeit. Soziale Demokratie und Fortschritt im 21. Jahrhundert, Berlin.

Julian Nida-Rümelin dhe Wolfgang Thierse (Botues) (1997), Philosophie und Politik, 1. Aufl., Essen.

OECD (2007), PISA-2006-Datenband, Tabelle 4.4c, Relationship between student performance in science and the PISA index of economic, social and cultural status (ESCS) for PISA 2000, PISA 2003 and PISA 2006, <http://www.oecd.org/dataoecd/30/62/39704344.xls> (zuletzt abgerufen am 20. Dezember 2009).

OCED, Organisation für wirtschaftliche Zusammenarbeit und Entwicklung, OECD.Stat Extracts, <http://stats.oecd.org>.

Dieter Plehwe und Bernhard Walpen (2001), Gedanken zu einer Soziologie der Intellektuellen des Neoliberalismus, nê: Hans-Jürgen Bieling, Klaus Dörre e të tjerë (2001), Flexibler Kapitalismus. Analysen, Kritik, politische Praxis, Hamburg, f. 225–239.

John Rawls (1979), Eine Theorie der Gerechtigkeit, Frankfurt am Main.

Jürgen Ritsert (1997), Gerechtigkeit und Gleichheit, 1. Aufl., Münster.

Jean-Jacques Rousseau (1997), Diskurs über die Ungleichheit. Kritische Ausgabe des integralen Textes, übersetzt und kommentiert von Heinrich Meier, 4. Aufl., Paderborn / München / Wien / Zürich.

Franz Schultheis und Kristina Schulz (Botues) (2005), Gesellschaft mit begrenzter Haftung. Zumutungen und Leiden im deutschen Alltag, Konstanz.

Amartya Sen (1985), Commodities and Capabilities, Amsterdam.

Michael Walzer (1997), Pluralismus und Demokratie, nê: Julian Nida-Rümelin dhe Wolfgang Thierse (1997), Philosophie und Politik, 1. Aufl., Essen, f. 24–40.

**Modul "Demokracia Sociale"
e Akademisë Online**

Cilat janë rrënjët dhe vlerat e Demokracisë Sociale? Nga se ka qenë dhe është e karakterizuar ajo? Si është politika praktike për ta zbatuar atë, duke pasur parasysh sfidat e reja si globalizimin dhe ndryshimet demografike? Këto janë pyetjet me të cilat merret moduli "Demokracia Sociale" i akademisë online të Fondacionit Friedrich Ebert. Përveç artikujve të larmishëm ndër të tjera mbi bazat, fushat e veprimit dhe aktorët e demokracisë sociale, do të gjeni edhe një fjalor të pasur dhe materiale mësimi.

www.fes-online-akademie.de

LITERATURË E SUGJERUAR

Literatura e sugjeruar më poshtë është për të gjithë ata që përtej këtij libri duan të merren më shumë me bazat e demokracisë sociale:

Udhërrëfyes të demokracisë sociale



Vaut, Simon

Udhërrëfyes 2: Ekonomia dhe Demokracia Sociale. 2009

Akademia Politike e Fondacionit Friedrich Ebert
(ISBN: 978-386872-154-6)

Si mund të realizohet një politikë ekonomike moderne, e lidhur me vlerat e demokracisë sociale? Mbi cilat teori mund të mbështetet një teori ekonomike, e cila bazohet në vlerat liri, drejtësi dhe solidaritet? Cilat parime qëndrojnë në themelet e saj? Dhe para së gjithash: si mund të realizohet në praktikë? Libri "Ekonomia dhe Demokracia Sociale" u jep përgjigje këtyre pyetjeve. Një rol të rëndësishëm këtu luan doktrina e ekonomistit britanik John Maynard Keynes. Në kohët e turbullta ekonomike, ku shumë vetë duan të shmangin rreziqet, është akoma më e rëndësishme të sigurohesh për kursin tënd politiko-(ekonomik).



Petring, Alexander

Udhërrëfyes 3: Shteti Social dhe Demokracia Sociale. 2009

Akademia Politike e Fondacionit Friedrich Ebert.
(ISBN: 978-386872-128-7)

Lidhja mes demokracisë dhe shtetit social, modelet e shtetit social të vendeve të ndryshme, programatika social-politike e partive, kritika populiste dhe sfida faktike: këto janë temat e librit "Shteti Social dhe Demokracia Sociale". Në qendër është pyetja: Me çfarë busulle duhet të pajiset demokracia sociale për taksat, sigurimin e të papunëve, pensionet, shëndetësinë dhe arsimin? Kontekste fundamentale që shpjegohen teorikisht dhe praktikisht, të bazuara, precize dhe të kuptueshme.

Historia e ideve politike

Euchner, Walter/Grebing, Helga:

Historia e ideve sociale në Gjermani. Socializmi – doktrina katolike sociale – etika sociale protestante. Një manual. 2005

Shtëpia botuese: VS Verlag für Sozialwissenschaften.

(ISBN: 978-3-531-14752-9)

Ky manual i përgjithshëm ofron një vështrim të gjerë mbi lidhjet mes lëvizjeve sociale dhe zhvillimeve historike të ideve. Në qendër janë socializmi, doktrina sociale katolike dhe etika sociale protestante.

Langewiesche, Dieter:

Liberalizmi dhe socializmi. Artikuj të zgjedhur. 2003.

Shtëpia botuese J.H. W. Dietz Nachf.

(ISBN: 978-3-8012-4132-2).

Në 17 referate historiani i njohur nga Tübingen-i, Dieter Langewiesche hedh dritë mbi historinë shumë tërheqëse dhe me veprim të ndërsjellë të ideologjive të mëdha shoqërore të shekujve të 19-të dhe 20-të, të liberalizmit dhe socializmit, parë në këndvështrimin e aspekteve kulturore, sociale dhe politike.

Bazat

Meyer, Thomas:

Teoria e demokracisë sociale. 2005.

Shtëpia botuese VS Verlag für Sozialwissenschaften.

(ISBN: 978-3-5311-4612-6)

Dy forca ndeshen në botën e globalizuar të kohës së sotme për influencë: demokracia libertariane dhe demokracia sociale. Thomas Meyer shpalos këtu bazat teorike për një politikë të demokracisë sociale, ku përveç të drejtave themelore qytetare dhe politike duhen marrë seriozisht edhe të drejtat themelore sociale dhe ekonomike të çdo njeriu.

Meyer, Thomas (Bashkëpunim: Nicole Breyer):

E ardhmja e demokracisë sociale. 2005.

Akademia Politike e Fondacionit Friedrich Ebert.

(ISBN: 3-89892-315-0).

Në këtë botim janë përfshirë dëshmitë më të rëndësishme nga Teoria e Demokracisë Sociale dhe Praktika e Demokracisë sociale.

Eppler, Erhard

Një parti për dekadën e dytë: SPD? 2008.

Shtëpia botuese: Vorwärts buch Verlag.

(ISBN: 978-3-86602-175-4)

Erhard Eppler, mendimtari pararendës i SPD-së boton një libër, ku merret posaçërisht me partinë e tij, detyrat e saj dhe shanset e saj: Ai përshkruan në mënyrë mbresëlënëse si ka ndryshuar mendimi radikal i tregut gjatë një çerek shekulli në Evropë dhe Gjermani. Çfarë mbetet, është një shoqëri gjermane, ndjeshmëria e së cilës ndaj drejtësisë është prekur apo lënduar thellë, dhe ku hendeku midis të varfërve dhe të pasurve është thelluar deri në atë masë, sa kërcënon përçarjen e shoqërisë.

Gabriel Sigmar

Të mendojmë sërish majtas. Politikë për shumicën. 2008.

(ISBN: 978-3-492-05212-2)

Sigmar Gabrieli paraqet një draft politike, i cili e mendon rishtas “të qenurit i majtë” dhe e çliron atë nga një kurth fatal: ose të shpëlash trurin deri në mosnjohje, ose të kthehemi e të biem në shabllonin tashmë të kapërcyer të së majtës së vjetër. Shumicat për të rezultojnë nga përmbajtjet politike dhe jo nga aritmetika e pastër e pushtetit dhe debatet pa fund të koalicioneve. Ai kërkon jo më pak se rikthimin në politikë.

Beck, Kurt/Heil, Hubertus (Bot.):

Demokracia sociale në shekullin e 21-të.

Udhërrëfyes për debatin programor të SPD-së. 2007.

Shtëpia botuese: Vorwärts Buch Verlag.

(ISBN: 978-3-86602-525-7)

Edhe botuesit e këtij botimi, bashkë me autore dhe autorë të tjerë, prezantojnë në kuadrin e debatit programor detyrat e së ardhmes: Si dhe me kë e zhvillojmë globalizmin? Ku po shkon Evropa? Si e gjallërojmë ne demokracinë? Si mund të rritet ekonomia jonë dhe si zgjidhen këtu problemet sociale dhe ekologjike të së ardhmes? Ku lind puna e re dhe çfarë mund të realizojë shteti social përkujdesës? A do të kemi sukses me kthesën energjetike? Si duket aleanca politike për demokracinë sociale në kohën tonë?

Mayer, Thomas (Bot.)

Praktika e demokracisë sociale. 2005.

Shtëpia botuese: VS Verlag für Sozialwissenschaften.

(ISBN: 978-3-531-15179-3)

Ky titull prezanton studimet aktuale cilësore mbi vende të ndryshme, realizuar nga ekspertë lider të kësaj fushe nën dritën e Teorisë së Demokracisë sociale të Thomas Meyer-it. Këtu analizohen Suedia, Japonia, Gjermania, Britania e Madhe, Vendet e Ulëta dhe SHBA. Këtu paraqitet edhe një indeks për matjen e demokracisë sociale.

Krell, Christian

Socialdemokracia dhe Evropa. Politika për Evropën e SPD-së, e "Labour Party" dhe e "Partisë Socialiste". 2009.

Shtëpia botuese: VS Verlag für Sozialwissenschaften.

(ISBN: 978-3-531-16498-4)

Kush dhe çfarë e përcakton politikën evropiane të një partie? Kjo pyetje është në themel të analizës së Christian Krell-it. Këtu ai krahason politikën evropiane të tri partive kombëtare në kohën midis 1979-ës dhe 2002-it: të Partisë Socialdemokrate të Gjermanisë, të Partisë Laburiste Britanike dhe të Partisë Socialiste Franceze. Ai tregon ngjashmëritë, por edhe dallime të dukshme, veçanërisht lidhur me strategjitë e integritit të tri partive lidhur me Europën.

Merkel, Wolfgang/Egle, Chistoph/Henkes, Christian/Ostheim, Tobias/Petring, Alexander:

Aftësia reformuese e socialdemokracisë. Sfidat dhe bilanci i politikës qeverisëse në Evropën Perëndimore. 2005.

Shtëpia botuese: VS Verlag für Sozialwissenschaften:

(ISBN: 978-3-531-14750-5)

Në fund të viteve 1990-të partitë socialdemokrate, në shumicën e vendeve të Bashkimit Evropian, kanë qenë pjesëmarrëse në qeverisje. Sa të suksesshme ishin partitë e ndryshme në politikën e tyre reformuese? A kanë ndjekur ato në mënyrë unike "rrugën e tretë"? Mbi bazën e studimeve të hollësishme të vendeve janë analizuar dhe vlerësuar politikatat socialdemokrate në Gjermani, Francë, Britaninë e Madhe, në Vendet e Ulëta, Suedi dhe Danimarkë.

Dowe, Dieter:

Nga Parti Punëtore në Parti Popullore. Zhvillimi programatik i socialdemokracisë gjermane që nga shekulli i 19-të. Seria e rrethit të diskutimeve mbi historinë, 2007, fletore 71 (<http://library.fes.de/pdf-files/historiker/04803.pdf>).

Dieter Dowe dizenjon historinë e socialdemokracisë që nga revolucioni i vitit 1848 në aspektin programatik dhe atë praktik si një pjesë e rëndësishme e betejave të gjata dhe që nuk mbarojnë kurrë, mbi rendin e lirë, demokratik dhe të drejtë të shtetit dhe shoqërisë.

Grebing, Helga:

Historia e lëvizjes punëtore gjermane.

Nga revolucioni i 1848-ës deri në shekullin e 21-të. 2002.

Shtëpia botuese: Vorwärts Verlag.

ISBN: 978-86602-288-1)

Prej vitesh suksesi politik është i lidhur dhe varet nga aftësia e partive për të zgjuar besimin në konceptet e tyre mbi tregun e punës. Ajo çka mungon deri tani, është një model i aftë për t'u zbatuar për një shoqëri të së ardhmes përtej punësimit klasik. Sepse njeriu duhet të jetë "aktiv", pra të merret me punë për të realizuar një jetë dinjitoze. Si mund të jetë një Gjermani pasindustrial me punë të mjaftueshme për të gjithë? Dhe cila është detyra që u bie në këtë rrugë lëvizjes punëtore dhe partisë së saj, SPD-së?

Miller, Susanne/Potthoff, Heinrich:

Histori e shkurtër e SPD-së 1848-2002. 2002

Shtëpia botuese: Verlag J.H.W.Dietz Nachf.

(ISBN: 978-3-8012-0320-7)

Historia e shkurtër e SPD-së ndërkohë është kthyer në një vepër standarde dhe tregon historinë e partisë më të vjetër gjermane, nga fillimet e saj deri në kohën e qeverisë Gerhard Schröder. Një tabelë periodike të ofron orientim të shpejtë.

Schneider, Michael:

Histori e shkurtër e sindikatave. Zhvillimi i tyre në Gjermani nga fillimet deri më sot. 2000.

Shtëpia botuese: Verlag J.H.W.Dietz Nachf.

(ISBN: 978-3-8012-0294-1)

Në mënyrë të detajuar dhe plot njohuri Michael Schneider përshkruan historinë e sindikatave nga fillimet e tyre gjatë industrializimit deri në sfidat aktuale të punës sindikaliste në kohët e globalizmit.

20 fjalët kyçe të rëndësishme:

1. Lëvizja punëtore
(fq. 70; 80)
2. Berlin, Isaiah
(fq. 102)
3. Socializmi demokratik
(fq. 74; 81-83)
4. Fraser, Nancy
(fq. 30-33)
5. Liria
(fq. 11-20; 26; 28; 38; 42-47;
54; 59-60; 65; 69-71; 76;
82-85; 94; 98; 110; 127)
6. Të drejtat e lirisë
(fq. 104-108)
7. Drejtësi
(fq. 11-12; 17; 21-39; 42-47;
51-60; 60; 82; 84; 108; 135;
149)
8. Barazi
(fq. 10-14; 21-30; 36-40; 99-
100; 108; 132; 138; 140)
9. Kant, Immanuel
(fq. 18-19, 26)
10. Kapitalizëm
(fq. 61-66; 70-71; 78-94; 97;
127; -128)
11. Konservatorizëm
(fq. 68; 72-73; 88; 110)
12. Demokraci liberale
(fq. 86; 95-96, 104)
13. Liberalizëm
(fq. 10; 14; 43; 68-70; 75, 86;
88; 88; 94; 96; 98; 110; 117)
14. Demokraci libertariane
(fq. 94-97; 103-105; 116)
15. Locke, John
(fq. 13-17; 25; 43, 69-70,
111; 113)
16. Rawls, John
(fq. 23-29; 32)
17. Rousseau, Jean-Jacques
(fq. 13; 16-17)
18. Solidaritet
(fq. 10-12; 21; 39-60; 69;
82-88; 99-100; 107; 108)
19. Demokraci sociale
(fq. 8; 45; 56; 89; 109;
116-118; 125; 132; 138; 148)
20. Teoria e demokracisë sociale
(Thomas Meyer)
(fq. 88-91; 95; 98; 104-105,
109)

OPINIONE MBI KËTË SERI

„Udhërrëfyesit e Demokracisë Sociale ndriçojnë shpejt dhe në mënyrë të kapshme faktet e komplikuar. Kush, çfarë, si dhe në radhë të parë për çfarë arsye: një vështrim kompakt, i cili në jetën e përditshme dhe të vullshme politike ka vlerë floriri.”

Dianne Käster, sekretare e sindikatës

“Udhërrëfyesi Bazat e Demokracisë Sociale është një inkurajim. Në kohërat, në të cilat duket sikur dallimet politike mjegullohen, ai të inkurajon të sigurohesh për bazat e veprimit tënd politik. Libri nuk ofron zgjidhje të thjeshta. Lexuesit dhe lexueses i kërkohet të ndeshet e të debatohet me aspektet e ndryshme të demokracisë sociale, teorisë dhe praktikës së saj. Kjo mpreh forcën politike të gjykimit. Me gjithë materialin e pasur lexuesja/lexuesi nuk e humbet asnjëherë fillin e leximit. Një strukturë e qartë, një organizim i mirë e i qartë i lëndës bëjnë të mundur që ta lexosh me ëndje librin. Përgjithësisht: orientim i qartë pa thjeshtëzim të palejueshëm”.

Ulrike Witt, PES Activist Group Göttingen

“Në mënyrë të përmbledhur duhet theksuar se autorët kanë arritur me këtë ndërmarrje të tyren, jo të lehtë, të përpilojnë një traktat të përpiktë të bazave teorike të një demokracie sociale në formën e një udhërrëfyesi për një target-grup thellësisht heterogjen. Vëllimi [Bazat e Demokracisë Sociale] të impresionon veçanërisht me përpunimin e përmbajtjeve me orientim praktik. Një trajtim transparent i bazave të literaturës, një bibliografi e gjerë, grafikë dhe tabela të shumta, raportim i hapave të ndërmjetëm, shënime biografike për teoricienët e veçantë dhe në mënyrë të veçantë kontroversat programatike të dhëna me shembuj sa më afër praktikës, të marrë nga diskursat aktuale, të gjitha këto të ofrojnë guidën e parë orientuese për mendim dhe veprim politik, si për të ndjekur seminarët e Akademisë për Demokraci Sociale, ashtu edhe për studimin e pavarur prej tyre.”

Michael Reschke, Universiteti Kassel

(Recensioni i hollësishëm në “Politika dhe Shoqëria Ndërkombëtare” 2/2009)

"Udhërrëfyesi" "Ekonomia dhe Demokracia Sociale" është një ndihmesë shumë e mirë, e arrirë, për njerëzit të cilët pyesin veten, nëse ajo që përfshijet në 'jetën e tyre ekonomike' në profesion, apo edhe si konsumatorë, vërtetë përputhet me atë çka Ligji Themeltar e mendon si 'ofertë të shtetit social'."

Josef Vogt, anëtar i vjetër i SPD-së, i IG-Metall-it dhe AWO-s.

"Në sfondin e zhvillimit ekonomik aktual dramatik shtrohet pyetja për një politikë bashkëkohore socialdemokrate për ekonominë dhe financat edhe përtej menaxhimit aktual të krizave në sektorin financiar. Nga punët dhe aktivitetet e seminareve të Akademisë për Demokracinë Sociale të Fondacionit "Friedrich Ebert" ka dalë një libër i mirë mësimi dhe leximi [Ekonomia dhe Demokracia Sociale] për praktikuesin politik, i cili në një mënyrë mbresëlënëse i përçjell edhe një amatori të ekonomisë një pasqyrë të kuptueshme për historinë dhe praktikën e ideve politiko-ekonomike."

Ulrich Hörning, referent në Ministrinë Federale të Financave, korrik 2009

(Recension i hollësishëm në "Shoqëria e re/Fletoret e Frankfurtit" 7 + 8/2009)

"Për politikën sociale diskutohet në mënyrë pasionante. Nuk ka vend tjetër, ku botëkuptimet e partive të përplasen kaq fort me njëra tjetrën. Me udhërrëfyesin nr. 3 "Shteti Social dhe Demokracia Sociale" mund të armatosen për këtë debat. Ai diskuton koncepte të ndryshme të drejtësisë. Ai tregon, kush do cilin lloj të shtetit social dhe qartëson se çfarë mund të mësojmë ne nga shtetet sociale skandinave. Aty bëhet e qartë, se kush flet për politikë sociale, flet për çështje të shpërndarjes. Puna, pensioni, shëndetësia dhe arsimi duhen organizuar në mënyrë të drejtë dhe – sot më e rëndësishme se kurrë – duhen financuar në mënyrë solidare. Edhe kësaj çështjeje i kushtohet udhërrëfyesi 3: në thellësi dhe në mënyrë të kuptueshme."

Sascha Vogt, zëvendëskryetar federal i Juso-s

MBI AUTORET DHE AUTORËT

Julia Bläsius (*1981) është referente në sektorin për dialogun ndërkombëtar pranë Fondacionit Friedrich Ebert. Ajo ka studiuar gjuhësi, ka kryer studime për ekonominë dhe kulturën në Universitetin e Pasaut. Më pas ka kryer një Master shkencor në degën European Political Economy pranë London School of Economics.

Frederike Boll (*1983) është studente e universitetit "Westfälische Wilhelms-Universität" në Münster. Ajo studion shkenca politike si degë kryesore dhe shkenca komunikimi dhe psikologji si degë të dyta.

Jochen Dahm (*1981) është referent në Akademinë Politike të Fondacionit Friedrich Ebert. Ai ka studiuar në Münster dhe Malaga shkenca politike, shkenca komunikimi dhe të drejtën publike.

Dr. Christoph Egle (*1974) është asistent shkencor në Universitetin "Ludwig-Maximilians-Universität" në Mynih. Ai ka studiuar shkenca politike, sociologji dhe filozofi dhe ka kryer doktoraturën për reformat politiko-ekonomike dhe politiko-sociale në Gjermani dhe Francë. Nga viti 2001 deri më 2004 ka qenë bashkëpunëtor në një projekt kërkimor për politikën e reformave socialdemokrate krahasuar në rrafshin evropiano-perëndimor pranë Universitetit "Ruprechts-Karls-Universität" në Heidelberg.

Tobias Gombert (*1975) punon në organizimin e seminareve për këshilltarët e ndërmarrjeve. Ai punon gjithashtu si trajnues për seminare dhe workshop-e për teorinë dhe komunikimin. Në vitet 2003-2005 ka qenë zëvendëskryetar federal i Juso-s, 2005-2007 anëtar i kryesisë federale të Juso-s. Në këtë kohë ka marrë pjesë në ngritjen e shkollës së mbrëmjes të Juso-s. Që nga viti 2007 ai është trajner i Akademisë për Demokraci Sociale. Deri tani ka kryer punime shkencore mbi Jean-Jacques Rousseau, teorinë marksiste dhe filozofinë moraliste.

Dr. Erik Gurgsdies (*1944) nga 1993 deri 2009 ka qenë drejtor i zyrës së Fondacionit Friedrich Ebert për landin Mecklenburg-Vorpommern. Ka studiuar ekonomi dhe sociologji. Më pas ka punuar si docent për ekonominë në shkollat e larta në Bergneustadt dhe Ahrensburg si edhe në shkollën e lartë për ekonomi dhe politikë në Hamburg.

Marc Herter (*1974) është kryetar i grupit parlamentar i PSD-së në Hamm (Vestfali). Studion shkencë juridike në Universitetin "Westfälische Wilhelms-Universität" në Münster. Që nga viti 2002 është anëtar i kryesisë së SPD-së në landin federal Vestfalia e Rinit Verior, që nga 2006 edhe anëtar i presidiumit të kësaj partie për këtë land.

Dr. Christian Krell (*1977) është bashkëpunëtor i Fondacionit Friedrich Ebert dhe këtu përgjegjës për Akademinë për Demokracinë Sociale. Ka studiuar shkencë politike, histori, shkencë ekonomike dhe sociologji në universitetin e Siegen-it dhe universitetin "University of York". Në vitin 2007 ka kryer doktoraturën për shkencë politike mbi politikën evropiane të SPD-së, të Partisë Laburiste dhe Partisë Socialiste Franceze.

Dr. Eun-Jeung Lee (*1963) që nga viti 2008 është drejtore e studimeve për Korenë pranë Universitetit të Lirë të Berlinit. Ka studiuar në Universitetin Ehwa në Seul dhe në Universitetin Georg-August në Göttingen, ku edhe ka kryer doktoraturën. Në vitin 2001 ka mbaruar habilitacionin në Universitetin "Martin Luther" në Halle-Wittenberg dhe ka punuar aty si docente private. Ka qenë bursiste për punë kërkimore e Fondacionit Alexander von Humboldt, bursiste e Japan Foundation dhe Visiting Research Fellow në Universitetin Chuo në Tokio.

Matthias Neis (*1976) ka studiuar gjermanistikë, shkencë politike dhe shkencë komunikimi në Universitetin "Westfälische Wilhelms-Universität" në Münster. Nga viti 2004 deri më 2006 ka qenë bashkëpunëtor shkencor në Institutin e Kërkimeve "Punë-Arsim-Pjesëmarrje" në Recklinghausen. Që nga viti 2006 është bashkëpunëtor shkencor në Universitetin "Friedrich Schiller" në Jena në projektin HBS "Faktori ekonomik nxitje për shkencën".

Christina Rentzsch (*1982) është studente për shkencë komunikimi, shkencë politike dhe psikologji në Universitetin "Westfälische Wilhelms-Universität" në Münster. Para studimeve ka mbaruar një kualifikim shitje reklamash në Köln.

Martin Timpe (*1978) është menaxher federal i grupeve të shkollave të larta për Juso-n dhe që nga viti 2007 punon si drejtues seminaresh në Akademinë për Demokraci Sociale. Ka studiuar shkencë politike në Institutin "Otto Suhr" pranë Universitetit të Lirë të Berlinit.

Politika ka nevojë për orientim të qartë. Vetëm ai që mund t'u vërë emrin e qartë qëllimeve të veprimit të tij, mund t'i arrijë ato dhe të entuziazmojë të tjerët me këtë. Prandaj edhe ky udhërrëfyes për bazat e demokracisë sociale shtron pyetjen se çfarë do të thotë demokraci sociale në shekullin e 21-të. Cilat vlera janë në themelet e saj? Cilat objektiva ndjek ajo? Si mund të zbatohet në praktikë?

Temat e udhërrëfyesve mbi demokracinë sociale të orientojnë në seminarët e Akademisë për Demokraci Sociale. Akademia për Demokraci Sociale është një ofertë për kualifikim pranë Fondacionit Friedrich Ebert për personat e angazhuar politikisht dhe të interesuarit.

Informacione të mëtejshme rreth akademisë:

www.fes-soziale-demokratie.de

"Udhërrëfyesi Bazat e Demokracisë Sociale është një inkurajim. Në kohërat, në të cilat duket sikur dallimet politike mjegullohen, ai të inkurajon të sigurohesh për bazat e veprimit tënd politik."

Ulrike Witt, PES Activist Group Göttingen

"Si për të ndjekur seminarët e Akademisë për Demokraci Sociale, ashtu edhe pavarësisht prej tyre, ky libër është e para guidë orientuese për mendimin dhe veprimin politik."

Michael Reschke, Universiteti Kassel



Zyra e Tiranës
Rruga "Abdi Toptani", Torre Drin, kati 3
P.O. Box 1418
Tirana, Albania

Telefon: 00355 (0) 4 2250986
00355 (0) 4 2273306

Homepage: <http://www.fes-tirana.org>